Ilaz Kadolli
Syri i Shqiponjës,
Kujtime e përjetime

PUBLICISTIKË

Ilaz KADOLLI
Syri i Shqiponjës,
Kujtime e përjetime

Botues
Shoqëria LËVIZJA

Redaktor
Abdyl KADOLLI

Recensues
Emrush XHEMAJLI

Shtypshkronja
BLENDI,
Prizren, 2017

ILAZ KADOLLI

Syri i Shqiponjës

Kujtime e përjetime

SHOQËRIA
LËVIZJA
Faqja zyrtare | www.levizja.org

Prishtinë, 2017

Lufta e UÇK-së dhe fitorja mbi pushtuesin serb do të mbeten përjetimi më i bukur në jetën time.

Autori

Hyrje

Rrëfimi im në këtë libër është vetëm një fragment i luftës sonë të lavdishme. Lufta e UÇK-së 1994 - 1999 dhe çlirimi i Kosovës përbëjnë periudhën më të lavdishme të historisë sonë të re kombëtare.

Rrëfimin e fillova në qytetin e bukur Besanson të Francës, në janar 2015. Deri atëherë nuk kam pasur mundësi të shkruaj, ngase gati gjithë jeta ime ishte angazhim e veprim konkret.

Këtu erdha për t'i shëruar plagët e luftës dhe të burgut, kur në gusht 1993 qenë burgosur shumë veprimtarë të Lëvizjes Popullore të Kosovës.

Më me dëshirë do ta vizitoja Francën për t'u njohur me gjithë ato mrekulli kulturore dhe me bukuritë e saj natyrore. Parisi është edhe djep i kulturës europiane.

Thuhet se origjina e francezëve të lashtë, ajo e pararomanizimit të popullsisë së galëve, i përket substratit të moçëm europian kelto-pellazgo- ilir.

Viteve të fundit janë botuar dhjetëra shkrime të autorëve të ndryshëm, si i historianit francez Roberto d'Angelo, që vërtetojnë se edhe Napoelon Bonaparti vinte nga një familje arbëreshe e Korzikës.

Francezët janë një popull i qytetëruar, që çmon lirinë.

Franca ishte edhe aleate e UÇK-së, që me Aleancën e NATO-s ndihmoi popullin e Kosovës për t'u çliruar nga pushtimi i gjatë serbosllav.

Disa ngjarje të përjetuara dhe të papërsëritshme, kur nuk shkruhen, edhe mund të harrohen fare.

Së këndejmi porosis bashkëluftëtarët e mi, që për-

jetimet e tyre nga lufta e UÇK- së, si periudhë më e ndritshme e historisë sonë të re, t'i shkruajnë ashtu siç dinë dhe siç i kanë përjetuar vetë. Ne jemi fitues të luftës çlirimtare dhe na takon ta shkruajmë historinë tonë të re.

Duke kujtuar historinë tonë, ne freskojmë mendjen e shpirtin dhe u tregojmë të tjerëve se kush ishim, çka kemi bërë si brez për vendin dhe çka ka mbetur për t'u bërë nga brezat e ardhshëm.

Shkrimet tona për Luftën tonë çlirimtare, të dëshmuara me vepra e flijime sublime, do t'u shërbejnë artistëve, shkrimtarëve, historianëve e kineastëve të krijojnë vepra të denja të artit, të shkencës e kulturës.

Brezat e ardhshëm duhet ta njohin e vlerësojnë historinë tonë dhe të mësojnë sa e shtrenjtë është liria dhe si duhet të ruhet e mbrohet atdheu.

Përpjekjet për liri dhe ribashkim kombëtar nuk janë ndalur e nuk do të ndalen kurrë derisa atdheu ynë Shqipëria të jetë Një dhe e ribashkuar.

Tani, kur po shkruaj këtë rrëfim, Kosova është e pavarur e sovrane, falë luftës së lavdishme të UÇK- së dhe flijimeve sublime të popullit tonë për liri.

Ky moment historik më bën krenar dhe më jep forcë për ta përballuar edhe këtë betejë të vogël me shëndetin.

Falë përkrahjes morale e materiale të bashkëveprimtarëve të Lëvizjes Popullore të Kosovës, bashkëluftëtarëve të UÇK- së, miqve e familjes sime, si dhe mjekëve të mrekullueshëm francezë, më 20 janar 2016 bëra me sukses transplantin e veshkës në Klinikën e nefrologjisë në qytetin Besancon të

Francës. Kjo ishte edhe një betejë e fituar në jetën time.

Besancon, janar 2016

FËMIJËRIA E RINIA

Gjyshi im

Gjyshi im Hasan Sahit Kadolli më donte shumë, ndoshta pse isha nipi i tij i parë, apo ndoshta pse gjyshi më kishte edhe nip, edhe djalë. Fati kishte dashur që babai im Ilaz Hasan Kadolli kishte vdekur shumë i ri, 24-vjeçar. Në korrik 1959 atë e kishte goditur rrufeja, kur ishte strehuar nën një arrë për t'u mbrojtur nga rrebeshi i shiut. Qëkur kam mësuar për fatin e tim et, gjithherë kam urryer rrufenë e zjarrtë. Unë kisha lindur tre muaj pas vdekjes së babait dhe më kishin pagëzuar me emrin e tij. Shumë vonë mësova për babanë tim, ngase gjyshin e dashur e konsideroja edhe baba. Thuhet se fëmijët që mbesin pa prindër kanë edhe fat në jetë. Edhe pse pa një prind, unë isha fëmija më i perkëdhelur në familje.

Me gjyshin tim kalova kohën me të bukur të fëmijërisë dhe rinisë.

Edhe pse nuk dinte shkrim- lexim, gjyshi më rrëfente fill e për pe edhe historinë tonë kombëtare. Në familjen tonë dhe në oda burrash flitej gjithherë me adhurim për Shqipërinë si atdhe yni dhe për fatin tonë nën pushtimin e sllavëve të jugut. Para njëqind vjetësh edhe Kosova ishte Shqipëri. Më 1912 kishte ndodhur Kryengritja e madhe dhe Kosova ishte çliruar nga pushtimi pesëshekullor turk. Mirëpo, shpejt ishte pushtuar nga Serbia e Greqia, bashkë me viset shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi e Çamëri. Gjyshi kujtonte masakrat e tmerrshme serbe e greke, djegiet

e venbanimeve të tëra dhe shpërnguljet masive të shqiptarëve. Ai fliste me dashuri për Kosovën, duke e quajtur krahina më e bukur e Shqipërisë. Ajo ishte e begatë me shumë tokë buke, bjeshkë, ujëra dhe xehe të ndryshme. Kishte të gjitha të mirat, por nuk e kishte lirinë, sepse ishte e pushtuar gati një shekull nga Serbia.

Gjyshi gjithashtu më rrëfente edhe për historikun e familjes sonë Kadolli. Ajo ishte fis Krasniqe, e ngulitur në Bukosh para 300 vjetësh. Mbiemri Kadolli vinte nga zonja e parë Kadë, që kishte mbetur e ve me tre djemtë. Prapashtesa –*olli* erdhi nga turqishtja dhe tregonte prejardhjen.

Gjyshi tregonte se familja jonë e madhe gjithmonë ishte në shënjestër të regjimit serb, madje përndiqej e quhej reaksionare, sepse askush nga familja jonë nuk bëhej argat i shkaut.

Ai rrëfente për vrasjet e shumta dhe masakrën e Tivarit pas Luftës së Dytë Botërore, kur u ripushtua Kosova nga partizanët çetnikë. Rrëfente me trishtim për zinë e bukës, *otkupin* (grumbullimin e drithit), menjëherë pas luftës, kur serbët grabitnin edhe miellin nëpër magjet shqiptare. Kujtonte me tmerr edhe aksionin famëkeq të armëve në dimrin e egër 1955-1956 dhe torturat mizore nga policia serbe. Një ditë e kishin marrë edhe atë , duke e dërguar në stacionin e policisë në Mushtisht. E kishin rrahur gjithë natën, duke e hedhur në borë në mëngjes. Kështu kishin vepruar edhe me tre anëtarë të tjerë të familjes sonë të madhe. Kishte dalë dikush nga Mushtishti, i kishte ngarkuar në një qerre dhe i kishte sjellë të alivanosur në Bukosh.

Në lëkurë dashi kemi ndenjur me javë dhe me kripë e qepë kemi mjekuar plagët e trupit të bërë pleh! - ofshante gjyshi. Po atë vit ishte hapur edhe udha për shpërngulje në Turqi. Shumë familje të tmerruara nga torturat serbe kishin marrë udhën për në Anadoll.

Kështu rrëfente gjyshi, duke ofsharë: shkitë janë mizorë, erdhën si magjupë me strajcë në krah dhe tash po na sundojnë!

Bjeshka e Bukoshit

Kur isha fëmijë, gjithë verën e kaloja në Bjeshkë të Bukoshit, nja tri orë rrugë me kalë larg fshatit. Ndodhet në kurrizin e Sharrit, përballë majës së Lepetenit, në lartësi mbidetare rreth 1.500 metra.

Nuk besoj të ketë vend më të bukur se Bjeshka e Bukoshit. Ka një rudinë të gjerë, plot bar e lule shumëngjyrëshe, ahishta e kroje të cemta. Ka zogj të bukur që këndojnë e qëndrojnë me orë të tëra në ajër, pothuaj pa lëvizur flatrat. Atje fryn një fllad i lehtë ahishte që të çel sytë e mendjen. Që nga koha e Turqisë aty del verës gjithë katundi për të kullotur bagëtinë, sidomos dhentë e lopët, dhe për të nxënë bulmet. Stanet janë me gardhe të lyera me bajgë dhe të mbuluara me kashtë thekre, ndërsa bagëtia ngujohet në torishta. Midis stanit është vatra e zjarrit, në anën e sipërme shtrati me fier, ndërsa në anën e poshtme bulmeti. Gjyshja ime Fatë, që unë e thërrisja Nana Plakë, ishte baçicë e stanit. Ajo milte bagëtinë, nxinte bulmetin, gatuante bukë dhe i piqte në prush. Gati të gjitha ushqimet ishin nga qumështi. Ishin të shijshëm përpeqet me gjizë e krelanat e kalla-

mojta, ndërsa të enjteve qiteshin edhe flia. Petulla, mazë e zier dhe djathë në tëlyen bëheshin vetëm për ndonjë mysafir të rrallë. Në bjeshkë i kalonin pushimet verore shumë fëmijë. Barinjtë luanin pikardhia, shtagapela, gurapesh, guxhas etj. Mali kryesisht është ahishtë, por ka edhe ndonjë pishë, panjë, lajthi e mështekën. Nëpër mal ka shumë dredhëza, hartyta , metra(mjedra) e mana (manaferra), ndërsa boronica (qershiza) nëpër rudina. Tek Hurdhat dalin mjaft lërthe, një lloj hudhre e egër. Mali ka shumë bisha, sidomos ujq e arusha, por edhe kaproj të bukur. Arushat e ujqit sulmonin natën bagëtinë, që e ruanin qentë e mëdhënj të Sharrit. Ata ishin shumë të dashur për fëmijët, por të tmerrshëm për bishat. Arushat trembeshin natën me urë zjarri.

Në bjeshkë, kur binin shira, madje edhe kokrrizë, bëhej ftohtë e binin edhe mjegulla.

Të gjitha emërvendet e bjeshkës janë shqip: Guri i Brumullakët, Gurët e Bardhë, Skrepi i Burizanit, Gropat e Pareve, Rrasat, Lugjet, Lkeni, Kurrizi, Kodra e Hanës, Kodra e Madhe, Çuki i Bllushtrave, Shpati i Karaxhës, Kolibat e Taljanëve, Roga e Pelave, Udha e Shpisë, Hurdha, Kroni i Madh, Kroni i Kukës, Kroni i Vjetave, Kroni i Love, Kroni i Stanit, Kroni i Ahishtës, Mali i Shpesh, Koshtorishta, Lisat e Turrave, Kërrshi, Stani i Qarrit etj. Për emërvendet në bjeshkë kishte edhe legjenda: Gurët e Bardhë thuhej se janë meteorë të pikur nga qielli, nga Skrepi i Burizanit vinte zëri i borisë për luftë kundër armikut dhe për Gropat e Pareve se aty fshihej ndonjë thesar përrallor nga lashtësia!

Në kurriz të bjeshkës janë edhe dy gërmadha. Njëra

quhet Stanica e Shqipnisë, ndërsa tjetra Stanica e Bugarit. Kureshtjen fëmijërore e grishnin sidomos këto dy emërvende të fundit, si kishin pikur aty? Gjyshi më tregonte se përgjatë atij kurrizi kishte qenë edhe kufiri mes Shqipërisë e Bullgarisë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Nga Bjeshka e Bukoshit shihen si në pëllëmbë tërë Rrafshi i Dukagjinit, Pashtriku, Koretniku e maja e Shkëlzenit. Shihen Drini i Bardhë si pasqyrë dhe pullazet e kuqe të fshatrave në gjelbërim. - Drini i Bardhë e Drini i Zi janë vëllezër, që burojnë e udhëtojnë nëpër tokën tonë, takohen në Lumë dhe vazhdojnë për në detin tonë! – më thoshte gjyshi. Atdheu ynë ka fusha, male, lumenj, liqene e dete të bukura!- tregonte gjyshi. Njëherë e pata pyetur me kureshtje:
- A ke qenë ndonjëherë në Shqipëri, a ke parë detin?
- Jo, bir, më tha, nuk kam qenë kurrnjëherë, por Shqipëria është këtu, ishte edhe gjatë LDB-së. Atëherë unë kam luftuar deri në Karadak kundër hordhive çetnike. Kufiri është shumë afër nesh, një vrap kali e del në Lumë!- tregonte ai me dorë nga jugu majat e maleve dhe nga udhëtonte Drini. Tash na ndan ai kufi i zi. Kufiri ynë ishte shumë më sipër në verilindje, deri te Molla e Kuqe e Nishit, por na përzunë shkitë. Këtupari kanë shkelur shumë ushtri të huaja. Ato ikën një ditë, veç këta shkitë nuk po çohen lehtë ,– ofshante gjyshi.

Guri i Brumullakët

Guri i Brumullakët është një monument i rrallë i natyrës. Quhet edhe Guri i Madh. Majë gurit është nje mbishkrim shumë i lashtë, ndoshta i kohës ilire. Shumë veta janë munduar ta deshifrojnë, por më kot. Në atë shkëmb ka dy-tri pisha, ndërsa majë tij shumë lule dhe bar veshi. Guri i Brumullakët vizitohet shumë si gur i shenjtë e shërues. Aty ndihesh lehtë dhe hareshëm. Thonë se një qëndrim ditor majë gurit i bënë të lumtur e të plleshëm çiftët. Sa më shumë t'i afrohesh atij guri, ai duket më madhështor. Nuk është as lehtë të ngjitesh majë tij, për shkak të pjerrtësisë së madhe. Rrëzë gurit është një shpellë, në cilën nuk ka hyrë ende askush. Kur ngjitesh majë gurit, sheh si fluturojnë shqiponjat përreth tij, sikur të ishin roja.

E sheh shqiponjën si qëndron në ajer, e lirë e krenare, dhe përnjëherësh hidhet nga lartësitë si një meteor.

Që atëherë pata mësuar se shqiponja është simboli ynë kombëtar. Shqiponja është një mrekulli e natyrës, me sytë e saj të mprehtë e vigjilentë. Me sqepin e kthetrat e mprehta godet prenë gjithmonë në kokë. Që atëherë adhuroja shqiponjën dhe lakmoja flatrat e saj. Gjyshi ma vizatone shpeshherë shqiponjën dykrenore në letër dhe këndonte për flamurin kuqezi.

Guri i Brumullakët në Bjeshkë të Bukoshit

Më vonë gjyshin e pati kapluar pleqëria dhe ankohej shpesh për dhimbje trupi. Një ditë derisa ia ngjishja këmbët e shpinën, sytë më shkuan tek qosteku i orës së tij të xhepit. Nga lakmia fëmijërore i thashë gjyshit të ma dhuronte orën mua. Gjyshi vetëm qeshi, duke ma premtuar orën. Edhe ai orën *Serkisuf* e kishte trashëguar nga i zoti i shtëpisë, plaku i mençur Sejdi Bali Kadolli. Pas vdekjes së gjyshit, orën e tij e pata varur si kujtim në murin e dhomës sime të fjetjes. Kur u ktheva nga lufta në qershor 1999, fshati im ishte bërë shkrumb e hi dy- tri herë dhe kishin mbetur vetëm oxhaqet e shtëpive. Në murin e dhomës sime kishte mbetur vetëm qosteku i orës si kujtim i vetëm nga gjyshi. Mirëpo, me shumë se orën

me qostek, gjyshi më la trashëgim ndjenjën e atdhedashurisë për lirinë e diturinë, për të cilën i jam mirënjohës përjetë.

Jeta shkollore

Ruaj shumë kujtime të bukura nga shkolla fillore. Asnjëherë nuk më hiqet nga kujtesa kur përjashtuan shokun tonë Besim Baraliu, ndër nxënësit më të mirë. E kishin përjashtuar se kishte shfaqur hapur simpati e dashuri për Shqipërinë. Kur po festonim Ditën e Flamurit në shtëpinë e kulturës në Bukosh, Besimi pati recituar një poezi për Shqipërinë. Aty erdhën papritmas disa policë. Besimi hetoi situatën, hipi mbi tavolinë dhe edhe një herë recitoi:

Telegramet venë e vinë
nga Belgradi në Athinë,
po na tundin Shqipërinë…

Kujtime të mira ruaj edhe nga shkolla e mesme në Therandë (*Suharekë*). Rrugën nga Bukoshi deri në Therandë e bënim këmbë, nja 15 km në ditë. Verës ishte kënaqësi udhëtimi, ndersa dimrit rruga ishte me baltë dhe bënte ftohtë.

Ka ndodhur shpesh t'i hiqnim çorapët e lagura dhe hynim të pastër në klasë. Rrallë hasnim ndonjë automjet a qerre gjatë rrugës.

Një ditë pranvere, derisa po ktheheshim për në shtëpi, takuam rrugës një bashkëfshatar, që ishte me qerre kuajsh. Ishte mixha Dan, Ramadan Baraliu. I thamë të na hipte në qerre. Pasi na këqyri një herë, pranoi me kënaqësi plaku i mirë. - Edhe pse jeni shumë, do t'ju bëj vend , por me një kusht. Të bëheni

rresht për një dhe të bërtitni fort me një zë: *Nishi është yni!* Në fillim nuk e kuptuam se ç' kërkonte plaku dhe sikur me një zë iu përgjigjëm: ne jemi nxënës të mirë dhe nuk kemi njisha!

Plaku qeshi dhe këmbënguli në kushtin e tij. Për të hipur në qerre, ne u rreshtuam dhe bërtitëm përnjëherësh: *Nishi është yni!*

Plaku u shkri në gaz dhe na bëri vend të gjithëve në qerre. Pastaj filloi të tregonte historinë e kushtit. Ky nuk është ai njëshi i shkollës suaj, është qyteti ynë Nishi, tash nën Serbi. Është emër ilir, dikur i banuar me shqiptarë, nja 700 fshatra, sa një Kosovë e sotme. Së andejmi janë shpërngulur me dhunë nga Serbia muhaxhirët tanë, në prag të Kongresit të Berlinit. Plaku fliste me vështirësi, sepse i kishte dhëmbët e thyer nga OZNA serbe, kur ishte rreshtuar në LNDSH për të kundërshtuar ripushtimin jugosllav të Kosovës në fund të vitit 1944. Na tregonte për torturat e OZNA- së dhe shprehte mllefin ndaj hafijeve shqiptare, që kishin zbuluar edhe Ibrahim Lutfiun, jurist e prefekt i Mitrovicës gjatë luftës. Ai ishte strehuar në Budakovë e Bukosh. Zenun Kepa i Buzhalës e kishte strehuar një kohë dhe nuk e kishte treguar kurrë. Zenuni qe pushkatuar nga OZNA në Brinesh të Buzhalës. Gjatë dimrit 1947 Ibrahim Lutfiu ishte rrethuar në Budakovë nga Mehmet Cikuli. Ai kishte bërë vetëvrasje dhe nuk ishte dorëzuar gjallë. Trupin e tij e kishin sjellë me tokme në Bukosh, ku ishte komuna atëherë. Nuk e lanë të varrosej as në varrezat e fshatit, por e hodhën në verrishtë, bri përroit ku ujë gurgullon gjithnjë.

Gjatë udhëtimit mixha Dan na tregoi edhe shumë histori. Konferenca e Bujanit kishte vendosur, që Kosova me shumicë shqiptare , si gjithherë, ka qenë dhe dëshiron t'i bashkohet shtetit amë Shqipërisë. Mirëpo, e tradhtuan komunistët kur në fund të luftës futën katër divizione sllave. Plaku i mirë recitonte edhe disa poezi të bukura për Nënë Shqipërinë, që i kishte mësuar nga ushtria shqiptare gjatë luftës. Neve na quante zogjtë e shqipes, që nesër do t'i dalim zot Shqipërisë.

Dikur mixha Dan na bëri edhe një pyetje joshëse: Ç'është më e shtrenjtë në këtë botë? Dikush tha vetë jeta, tjetri përmendi arin, të tjerët rrudhën krahët. Dikur foli vetë plaku:

Gjëja më e shtrenjtë në këtë botë është Liria!

Pa liri nuk mund të jetosh, nuk mund të marrësh frymë… Mirëpo, ne ishim të rinj shtalb, nuk kishim përjetuar lirinë, andaj nuk ia dinim as vlerën asaj. Më vonë kam mësuar se mixha Dan bënte lidhjet e Ibrahim Lutfiut me LNDSH- në, duke i dërguar edhe gazeta. Ato rrëfime historike të mixhës Dan u bënë frymëzim për ne nxënësit e rinj dhe një testament për rrugën tonë të lirisë. Kam edhe shumë kujtime të bukura nga gjimnazi "Jeta e re" në Therandë, për shokët e klasës: Agimin, Emriun, Shaipin (*Gjonin*, siç e quanin atëherë), Tahirin, Dashen, Naxhijen etj. Respekt të veçantë kam edhe për kujdestarin e klasës Behajdin Skeja nga Prizreni, i cili ishte edhe shok i mirë. Të paharruara kanë mbetur mësimet e gjeografisë nga profesori Bajram Kurti, i cili ligjëronte me emocione për Shqipërinë, atëherë kur shumë profesorë të tjerë nuk guxonin t'ia përmend-

nin as emrin, madje e merrnin si shembull të keq, vetëm për t'i hyrë në hatër pushtuesit. Atëherë në gjimnazin e Therandës ndodhën edhe përpjekjet e para për kundërshtimin e pushtuesit serb. Në vitet 1979- 1980 filloi shkrimi i parullave *Kosova- Republikë*. Më 1981 u burgosën aktivistët e Grupit të të Rinjve të Therandës: Muharrem e Bislim Elshani, Sadik Halitjaha, Sejdi Gega, Afrim Morina, Besim Baraliu etj.

Në prag të maturës u njoha me Xhevahire Elshanin nga Theranda, tani bashkëshorte ime, me të cilën kemi dy djem e një vajzë. Ajo me qëndroi pranë gjatë gjithë jetës: veprimtarisë sime ilegale, demonstratave, burgosjes më 1993, gjatë luftës dhe sëmurjes sime.

PRANVERA STUDENTORE '81

*M*ë 1979 u regjistrova në Fakultetin Juridik të Prishtinës, ku u njoha me shokët Gafurr Elshani, Haki Gashi, Naim Bajraktari, Ismet Syla, Ramadan Kuqi, Ferat Gashi, Liman Gashi, Bali Gashi etj. Jeta studentore ishte mjaft dinamike, herë- herë e vështirë, por shumë e këndshme dhe e organizuar. Në fillim banonim nëpër shtëpi private, në dhoma zakonisht të errëta e me lagështi. Që nga mëngjesi deri në mbrëmje mësonim me Gafurr Elshanin në bibliotekën e Fakultetit Juridik. Ushqimi ynë më i pëlqyer në mëngjes ishte bureku me mish ose me gjizë, ndonjëherë edhe me ajran. I shijshëm na vinte edhe samuni me djathë e çaj mali.

Kohën e lirë zakonisht e kalonim në shëtitje nëpër korzon e qytetit. Aty takonim njerëz të njohur dhe soditnim edhe vajzat e veshura bukur.

Të privilegjuar ishin studentët që banonin në konvikte. Në Qendrën studentore jeta ishte më e organizuar. Dhomat ishin më të mira, ndërsa ushqimi dy herë në ditë në mensën e studentëve. Kur koha ishte e bukur, studentët qëndronin deri vonë mbrëmjeve në grupe në oborrin e konvikteve, duke biseduar e dëgjuar muzikë të lehtë. Më vonë muzika më e preferuar u bënë këngët patriotike, që vinin nga shoqëria "Afërdita" e Mushtishtit të Therandës. Aty dëgjonim me ëndje edhe Radio- Tiranën dhe Zërin e Amerikës. Edhe atëherë emisionet e Radio- Televizionit të Tiranës vëzhgoheshin nga sytë e UDB- së.

Në konviktet e studentëve në Prishtine në vitin 1981 depërtonte në forma të ndryshme literaturë nga Republika e Shqipërisë dhe vendet e Perëndimit, që lexohej me ëndje dhe shpërndahej fshehurazi dorë më dorë. Romani i ndaluar " Gjarpërinjtë e gjakut" i Adem Demaçit kërkohej nga studentët, por ishte vështirë të gjendej. Në mesin e studentëve komentoheshin Demonstratat '68 dhe flitej me admirim për simbolin e lirisë Adem Demaçi, i cili vuante dënimin e rëndë politik në burgjet jugosllave.

Në ato biseda studentore komentohej diskriminimi ndaj shqiptarëve nën Jugosllavi. Nuk mund të arsyetohej në asnjë mënyrë që shqiptarët, kombi i tretë në Jugosllavi, të mos kishin republikën e tyre si kombet e tjera.

Demonsratat e marsit

Mbrëmjen e 11 marsit 1981, derisa po ktheheshim nga mensa e studentëve, u dëgjuan brohoritje për bashkim dhe kushte më të mira për studentët. E kishim pritur me padurim këtë ditë, që të thyhej heshtja e të hiqej frika e mbjellë me vite nga propaganda e urryer titiste për vëllazërim- bashkimin e bashkëjetesën. Shqiptarët nuk kishin asgjë të përbashkët me sllavët e jugut dhe asnjë arsye për të qenë pjesë e e asaj krijese artificiale, e quajtur e sëmura e Ballkanit.

Veprimet e para atë mbrëmje ishin heqja e thyrja përtokë e fotos më të urryer të diktatorit Tito, që qëndronte në çdo kënd, në korridore dhe në hyrje të konvikteve. Në fillim grupi i studentëve që vinte nga

mensa ishte disa dhjetëra veta, ndërsa për një kohë të shkurtër u rrit në qindra sish. Studentët sikur kishin pritur këtë çast për të shprehur revoltën e mllefin për padrejësitë që u bëheshin shqiptarëve.

Protesta e 11 marsit 1981 zgjati thuajse tërë natën. Asaj iu bashkuan shumë shpejt edhe qytetarë të tjerë dhe ajo mori karakter të demonstratës. Të kota ishin përpjekjet e udbashëve dhe të aktivistëve komunistë jugosllavë për të qetësuar shpirtin e trazuar të studentëve. Të kota ishin premtimet e Azem Vllasit të gjorë se ai vetë do të përkujdesej për kushtet e studentëve. Çirrjet e tij ishin vetëm premtime boshe të një argati të Serbisë. Vllasi mori përgjigjen me sharje të studentëve dhe disa grushte shpinës e shqelma bythëve. Ai iku si një langua i përjargur nga Qendra e studentëve.

Nuk vonoi shumë dhe ai langua serb i quajti kërkesat e drejta të studentëve nacionaliste, irredentiste e kundërrevolucionare. Këto slogane të tij u bënë edhe programe serbo- jugosllave kundër shqiptarëve, që leheshin nga shërbëtorët jugosllavë, si Fadili Hoxha, Ali Shukria, Sinan Hasani, Kolë Shiroka, Mahmut Bakalli, Rrahman Morina etj. Për këtë besnikëri serbosllave, Vllasi u gradua më vonë dhe u bë njeriu më i besueshëm i Beogradit pas vitit 1981.

Menjëhere pas Demonstratës së 11 marsit 1981 pushtuesi serb dhe veglat e tyre shqiptare filluan arrestimet dhe burgosjet masive të studentëve në Prishtinë. Më 26 mars1981 në Qendrën e studentëve shpërtheu sërish demonstratë. Konviktet u rrethuan shpejt nga të katër anët nga forca të shumta policore dhe mjete të blinduara. Qëllimi i organizatorëve të

demonstratës ishte marshimi drejt qendrës së qytetit, masivizimi i demonstratës dhe pengimi i pritjes së stafetës së Titos, që kalonte më 26 mars nëpër Prishtinë.

Policia serbe u egërsua dhe u sul pa mëshirë mbi studentët. Përleshja ishte shumë e ashpër. Studentët ishin këmbëngulës për të çarë rrethimin e egër. Policia hodhi tonelata gaz lotsjellës e tym helmues mbi turmën e studentëve.

Studentët u detyruan të futen nëpër dhomat e konvikteve, ku gazi e tymi helmues ta zinin frymën. Pak ndihmonin ato pak qepë që na sillnin nënat dhe fëmijët e Prishtinës.

Kriminelët serbë thyenin xhamat e dritareve, duke gjuajtur nga largësia. Tymi dhe gazi helmues kishin depërtuar nëpër dhomat e të gjitha konvikteve. Studentët u detyruan të dalin jashtë, duke kërcyer edhe nga dritaret. Në të dy anët e hyrjes kryesore të konvikteve ishte vendosur kordoni i qindra policëve serbë, që goditnin pa mëshirë me të gjitha mjetet mbi studentët e kërrusur. Nuk ishte e mundur të kaloje përmes tyre, pa u goditur dhjetëra herë me shqelma, grushte, kërbaç e qyta armësh.

Provova të depërtoja nëpër një hapësirë të ngushtë mes policëve nga ana e djathtë e konviktit. Çava kordonin e parë, por në të dytin më kapën policët. Duke më shqelmuar e tërhequr zvarrë, më dërguan te studentët e tjerë të rrëmbyer, që ishin detyruar të qëndronin ulur në formë rrethi në oborrin e Qendrës së studentëve. Një udbash mbajti një fjalim shqip, duke lavdëruar forcën e treguar policore dhe madhëruar Serbinë e Jugosllavinë. Më vonë na liruan, pasi nuk

kishin as kohë, as mundësi teknike ta burgosnin gjithë atë turmë të madh studentësh.

Atë ditë pata humbur edhe njërën këpucë, por e gjeta të nesërmen në oborrin e konvikteve. Aty pashë plot këpucë të djemve, vajzave e fëmijëve të tjerë.

Në atë demonstratë pati edhe mjaft nxënës të shkollave fillore e të mesme. Në një dhomë të konvikteve qe strehuar edhe një fëmijë, që mezi mbante lotët nga tymi helmues. Dikush nga ne e pyeti se kush ishte dhe nga vinte. Fëmija tha se ishte nxënës i klasës së gjashtë fillore në Prishtinë.

- Po si quhet shkolla jote? – e pyeti tjetri.

- Aco Maroviç hë nënën e nënës!- shfryu fëmija i pezmatuar. Të gjithë shpërthyem në gaz, duke i premtuar se këtë emër do ta ndërrojmë shpejt me një shqiptar. Imazhi i këtij fëmije edhe sot më rri para syve. Qëndrimi burrëror i tij dhe i fëmijëve të tjerë të Prishtinës, që na mbështetën me gurë e me qepë, na dha forcë e moral për të vazhduar demonstratat në Prishtinë dhe qytetet e tjera të Kosovës. Ai brez i fëmijëve të 1981- ës u bënë ushtarët më të mirë të UÇK- së, që realizuan ëndrrat për lirinë e Kosovës.

Demonstratat e prillit

Pavarësisht burgosjeve masive, torturave dhe propagandës së egër kundër shqiptarëve nën Jugosllavi, studentët e Universitetit të Prishtinës përsëri u ngritën në demonstrata më 1 e 2 prill 1981, duke u nisur nga Qendra e studentëve. Që në orët e hershme të mëngjesit studentëve iu bashkuan shumë qytetarë të Prishtinës, nxënës të shkollave të mesme dhe fshatarë nga rrethina.

Për herë të parë asaj iu bashkëngjitën edhe punëtorët e ndërmarrjes ndërtimore " Ramiz Sadiku" dhe të Fabrikës së amortizatorëve në Prishtinë. Qendra e studentëve vërshohej për çdo orë nga grupe të demonstruesve me flamur kombëtar në dorë, pankarta e brohoritje tanimë të qarta politike: *Kosova Republikë! Republikë e Kushtetutë, ja me hatër, ja me luftë! Poshtë regjimi serb! Liri e barazi...!*

Në prill 1981 demonstrata e studentëve të Prishtinës kishe marrë karakter të kryengritjes gjithëpopullore, ku ishte përfshirë gjithë populli shqiptar i Kosovës me viset e saj. Demonstruesit kishin vënë nën kontroll Qendrën e studentëve, sidomos Palestrën e sporteve dhe Mensën e studentëve. Forcat policore serbe, njësitë speciale e të blinduara ishin pozicionuar në udhëkryqin te Mensa e studentëve për të bllokuar rrugën kah qendra e qytetit.

Demonstrata sa vinte e ashpërsohej. Policia serbe hidhte gaz në drejtim të demonstruesve dhe shtinte edhe me armë zjarri e predha lufte. Pranë nesh filluan të fishkëllojnë predhat e rafaleve të automatikëve dhe u goditën e shpuan disa xhama të palestrës sportive.

Ndërkohë u godit një student me predhë plumbi dhe ra në tokë pranë këmbëve tona. Aty ishim bashkë me Gafurr Elshanin. Studenti kishte marrë plagë në gjoks e në këmbë, nga rridhte gjak. Aty erdhi një makinë dhe me ndihmën e studentëve u dërgua në spital. Në ato moment janë dëgjuar të shtëna me armë zjarri edhe nga shtëpia e serbit Delibashiç, përballë palestrës sportive, nga të cilat u plagosën dy studentë. Më vonë mësuam se të dy studentët kishin vdekur në spitalin e Prishtinës.

Edhe pse serbët filluan të vrasin, demonstrata mori hov dhe vazhdoi tërë ditën. Të vetmet armë të studentëve në këto demonstrata ishin gurët e shumtë, që u hodhën si breshëri mbi policët serbë. Punëtorët e " Ramiz Sadikut" a të një ndërrmarrjeje që punonte afër konvikteve, kishin sjellë aty një eksavator, që ishte vendosur përballë policëve e tankeve serbe. Dikush vuri në eksavator flamurin kombëtar. Disa studentë hipën në eksavator dhe u sulën mbi tankun serb, duke e mënjanuar nga rruga dhe paaftësuar për lëvizje. Numri i demonstruesve shtohej nga çasti në çast dhe presioni i tyre ishte shumë i madh. Policia serbe u detyrua t'i lëshojë pozicionet.

Në orët e mbrëmjes së 1 prillit demonstruesit marshuan nga të katër anët në drejtim të qendrës së qytetit të Prishtinës. Përqendrimi kryesor i demonstruesve ishte para Komitetit Krahinor, ku qëndronin udhëheqësit e urryer komunistë. I tërë kryesheshi i Prishtinës dhe të gjitha rrugët ishin mbushur me demonstrues. Dëgjoheshin brohoritjet*: Poshtë tradhtarët! Kosova Republikë! Republikë e Kushtetutë, ja me hatër, ja me luftë! etj*. Demonstruesit ftuan njërin nga ata me megafon të hipte në blirin para Komitetit Krahinor. Ai iu drejtua masës së demonstruesve me një fjalim të shkurtër dhe të qartë për vazhdimin e demonstratave në tërë qytetet e Kosovës deri në realizimin e kërkesave legjitime të shqiptarëve për Republikë e pavarësi. Më vonë mësuam se personi me kapelë në kokë dhe megafon në dorë ishte Hydajet Hyseni, i cili pas disa ditësh, bashkë me një grup, u arrestua dhe u dënua me burg të rëndë jugosllav.

Demonstrata studentore vazhdoi edhe më 2 prill 1981, tani me përmasa edhe më të gjera. E tërë Prishtina ishte në gjendje lufte. Në të katër anët dëgjoheshin krisma rafalesh nga armë të ndryshme dhe uturima tankesh, ndërsa tym dukej në çdo lagje të Prishtinës. Mbi qytet fluturonin aeroplanë luftarakë.

Të gjitha rrugët ishin të mbushura me gurë e barrikada. Demonstratat zhvilloheshin njëkohësisht në Qendër të studentëve, në Kodër të Diellit, në Kodër të Trimave etj. Autoambulancat dhe veturat e tjera private bartnin të vrarë e të plagosur drejt spitalit të qytetit. Njoftimet zyrtare flisnin për 11 të vrarë e shumë demonstrues të plagosur. Mbi demonstrues gjuanin edhe civilë serbë, duke hedhur nga ballkonet sende të forta, vazo lulesh etj. Demonstratat e Pranverës 1981 ishin ngjarje historike të zgjimit kombëtar të shqiptarëve nën Jugosllavi. Pas këtyre ngjarjeve historike serbët u vërsulën mbi çdo gjë shqiptare në Kosovë dhe në viset e tjera.

Nuk pati përkrahje politike në Jugosllavi, që çështja shqiptare të zgjidhej në mënyrë demokratike. Zëri i intelektualit Ukshin Hoti në mbështetje të Republikës së Kosovës u mbyt me burgosjen dhe dënimin e tij shumëvjeçar.

Tashmë shqiptarët filluan ta kuptojnë se ishin të kota përpjekjet, që çështja e tyre të rregullohej në mënyrë paqësore.

LËVIZJA POPULLORE E KOSOVËS

*M*ë 17 shkurt 1982 të gjitha grupet ilegale që vepronin brenda e jashtë vendit bashkohen në Lëvizjen për Republikën e Shqiptarëve në Jugosllavi (LRSSHJ). Tanimë organizimi politik e kombëtar i shqiptarëve kishte marrë fizionomi të mirëfilltë. Ky bashkim politik i shqiptarëve depërtoi shumë shpejt edhe te studentët e Universitetit të Prishtinës dhe në të gjitha viset shqiptare. Më 1982 nuk kishim dijeni se në krye të këtij organizmi politik ishin strategët e Lëvizjes kombëtare, Kadri Zeka dhe vëllezërit Jusuf e Bardhosh Gërvalla.

Njohja me Nuhi Berishën

Një mbrëmje funddhjetori 1981, në Konviktin nr.1 të studentëve, një student i ri kishte vënë në derë të dhomës sonë një trakt, ku kërkohej mobilizimi e bashkimi i shqiptarëve për të drejtën e Republikës dhe të pavarësisë. Njëri nga shokët e dhomës, Ramadan Kuqi, kishte vërejtur studentin që kishte vënë këto trakte. Atë natë ai vetëm e përshkroi këtë person, ndërsa të nesërmen e njohu në oborr të konvikteve, duke na thënë: ja, ky është ai djali, që mbrëmë vuri traktin në dhomën tonë!

Bashkë me shokun tim Gafurr Elshani u interesuam ta takojmë gjithsesi. Kështu, një mbrëmje të fundvitit 1981 u takuam me studentin Nuhi Berisha. Për arsye sigurie, në fillim Nuhiu u prezantua me emrin *Nazmi*. Na tha se na njihte më herët gjatë demon-

stratave të marsit e prillit 1981 dhe na kishte vërejtur në ballë të tyre. Na tregoi se edhe ai ishte student i Fakultetit juridik dhe se kishte kontakte edhe me studentë të tjerë nga Theranda. Ai foli me admirim për përkushtimin e organizimin e tyre.

Që të tre u pajtuam të takohemi vazhdimisht dhe të bisedojmë për një organizim e bashkëveprim edhe me student të tjerë. Po atë mbrëmje vendosëm të formojmë edhe celulën e organizimit ilegal në kuadër të Lëvizjes.

Gjatë disa takimeve të rregullta nga fundviti 1981 dhe fillimviti 1982, Nuhi Berisha na njoftoi se kishte kontakte të rregullta me veprimtarë të organizuar brenda dhe jashtë Kosovës, sidomos në Zvicër.

Një natë të ftohtë janari më 1982, në shtëpinë e Shaban Mujës (Magjupit), ne të tre, Nuhiu, Gafurri dhe unë, formuam celulën dhe bëmë betimin për veprimtari të organizuar në Lëvizje. Betimi ishte obligim statutar për çdo anëtar të Lëvizjes. Nuhiu kishte siguruar flamurin kombëtar dhe tekstin e betimit të shkruar me makinë. Që të tre u ngritëm në këmbë. Nuhiu lexoj tekstin e betimit, pastaj u përkulëm para flamurit kombëtar dhe njëzeri brohoritëm: *Betohemi!* Teksti i betimit: *Para flamurit kombëtar betohemi se deri në vdekje do të luftojmë për çlirimin e Kosovës dhe të viseve të saj nga Serbia dhe bashkimin me shtetin amë Shqipërinë!* Me emrin Betim pagëzova pastaj djalin tim të parë, i cili lindi në tetor 1982. Kur bëmë betimin, ne ende ishim të rinj dhe në fillim të studimeve: Nuhiu 20, unë 21 dhe Gafurri 22-vjeçar. Edhe pse Nuhiu ishte më i ri, ai gëzonte respekt të veçantë nga celula jonë treshe

dhe konsiderohej udhëheqës i grupit.

Nuhi Berisha ishte një djalë i zgjuar, i shkathët dhe shumë praktik në veprime. Ai ishte më trim se ne dhe shumë i vendosur në zbatimin e detyrave. Ai vepronte vazhdimisht ditë e natë. Lëvizjet e tij të pandërprera dhe kontaktet me veprimtarë të shumtë nëpër rrethe të ndryshme të Kosovës nuk mbetën pa rënë në sy të Sigurimit të fshehtë serb dhe të veglave të tij shqipfolëse. Në fund të vitit 1982 Nuhi Berisha u detyrua të ndërpriste studimet dhe të kalonte në ilegalitet të thellë. Tani veprimtaria jonë politike ilegale kishte hyrë në një fazë të veprimit të vendosur, me shumë rreziqe të arrestimit e burgosjes, por edhe të sakrifikimit të jetës.

Me kërkesën e Lëvizjes jashtë vendit dhe me pëlqimin e celulës sonë, në pranverë 1983 Nuhi Berisha udhëton për në Zvicër. Pas disa ditë qëndrimi atje, ai kthehet në Prishtinë me shumë udhëzime e detyra të veprimit. Kishte sjellë edhe shumë literaturë nga Shqipëria, plot trakte e materiale të tjera, që i kishte fshehur përkohësisht në tyrbenë e Sulltan Muratit në Mazgit të Kastriotit (*Obiliq*). Këto materiale e trakte i morëm bashkë me Gafurrin e Nuhiun dhe i shpërndamë nëpër tërë Kosovën. Në mesin e trakteve ishte edhe një kundër tradhtisë, ku ftoheshin bashkëpunëtorët shqipfolës të Serbisë të ndërprisnin veprimet e dëmshme kundër shqiptarëve nën Jugosllavi. Nuhiu kishte sjellë nga Zvicra edhe pak armë e municion, ndërsa shokët atje i kishin dhuruar edhe një revole shumë të mirë të markës *Sigsauer*. Nuhiu e mbante me vete gjithmonë atë revole të mbushur dhe i gatshëm të vepronte në çdo

situatë. Nuhi Berisha bënte edhe ndërlidhjen e grupit tonë me celulat e tjera. Ai dhe Rexhep Mala, që porsa kishte dalë nga burgu, ishin kreu i Lëvizjes brenda vendit. Edhe Rexhep Mala vepronte nga ilegaliteti i thellë dhe unë nuk pata fat ta takoja. Ndoshta edhe e kam takuar, por nuk e kam njohur, për shkak të rrethanave në të cilat vepronim.

Grupit tonë së shpejti iu bashkuan edhe veprimtarë të tjerë, si Enver Topalli, Haki Gashi etj. Së bashku me Nuhiun, Gafurrin e Enver Topallin bëmë planin dhe organizuam Njëvjetorin e Demonstratave 1981. Kishim vendosur që Demonstrata më 11 mars 1982 të nisej nga fontana e tre rrokaqiejve në Ulpianë, ngase në Qendrën e studentëve ishin vendosur forca të mëdha të policisë dhe agjentë serbë.

Fillimisht aty u tubuam rreth 20-30 studentë, që formuan një rreth në formë sofre, që shpejt u bë një sofër e madhe. Duke parë këtë përqendrim të studentëve, udbashët në uniforma civile kërkuan nga studentët t'i dorëzojnë letërnjoftimet dhe të shpërndahen. Një student nga fshati Sopi i Therandës, mbase nga mosdija, ia dha letërnjoftimin një udbashi. Në atë moment kam urdhëruar studentët e tjerë të mos ua japin letërnjoftimet këtyre derrave, ngase do të pasonte arrestimi i tyre. Sakaq fillon një përleshje e rreptë mes studentëve dhe udbashëve. Shumë goditje pësuan udbashët: grushte, shqelma, dhëmbë të thyer e gurë në shpinë.

Kjo përleshje me policinë serbe ishte një stërvitje e mirë për ngjarjet e mëvonshme. Atë ditë, së bashku me studentin Mehmet Osmani nga Mushtishti, arritëm ta nxjerrim nga kthetrat e kriminelëve serbë

Besim Baraliun, një shok yni i ilegales, që para pak kohësh kishte dalë nga vuajtja e dënimit në burgun e rëndë serb. Besimi nuk kishte përfillur këshillën tonë që të mos dilte në demonstratë. Disa kriminelë serbë e kishin shtrirë përtokë dhe e goditnin pa mëshirë me shqelma, grushte e shufra. Unë e Mehmeti i goditëm me gurë në rruazë të shpinës ata kriminelë. Ata harruan Besimin dhe u hodhën pas nesh, mirëpo ne ishim më të shkathët të iknim. Vetëm shkathtësia dhe përvoja jonë e gjuatjes me gurë shpëtuan Besimin nga burgosja e sërishme. Kështu shpëtoi dhe iku edhe Besimi.

Për Demonstratat e 11 marsit 1982 shkroi në shtypin ilegal vetë Nuhi Berisha, duke përshkruar përleshjen fytafytas të studentëve me policinë serbe. Nuhi Berisha gjatë veprimtarisë së tij ilegale përshkoi këmbë çdo cep të Kosovës për ta përçuar frymën e Lëvizjes. Ai thoshte shpesh se pa njohjen e atdheut në çdo cep, nuk mund t'ia dimë vlerën dhe ta duam aq sa meriton.

Disa herë Nuhiu kishte ardhur edhe në Therandë dhe në shtëpinë time në Bukosh. Aty ai takonte të rinj, por edhe pleq me përvojë, si Liman e Selman Kadolli dhe babanë e Gafurrit, Azem Beqë Elshanin, me te cilët bisedonte për hallet e popullit dhe përpjekjet e Lëvizjes Popullore të Kosovës për çlirim e bashkim kombëtar. Edhe pse i ri në moshë, ai kishte aftësinë të bënte për vete të gjitha shtresat e qytetarëve. Një ditë prilli 1982 në Bukosh, i frymëzuar nga biseda me Nuhi Berishën, plaku Liman Kadolli i thotë: *T'i kisha dhjetë djem si ti, o Nazmi, do ta kisha marrë edhe Nishin!*

Atëherë Nuhiu ia pret me krenari: *Të jesh shumë i sigurt se do ta mundim me luftë Serbinë!* Edhe pse Nuhiu vepronte në ilegalitet të thellë, shumë herë i është tërhequr vërejtja për lëvizjet e tij gjate ditës. Mirëpo, ai gjithherë përgjigjej: *Gjallë nuk dorëzohem në dorë të serbit. Ata nga Karpatet kanë ardhur dhe andej do të ikin!*

Nuhiun e pezmatonte shumë propaganda antishqiptare e disa shqipfolësve në pushtet, sidomos e disa profesorëve në Universitet. Një mbrëmje shkurti 1983, në një rrugicë pranë Fakultetit Juridik, Nuhiu kishte ndalur profesorin e filozofi- sociologjisë Hajredin Hoxha dhe ia kishte ngjeshur një shpullë të nxehtë, si vërejtje të parë për të ndalur lehjen e tij kundër studentëve dhe demonstratave. Që nga ai rast profesori i gjorë kishte mbetur si qyqe derisa një ditë kishte thyer qafën në një aksident komunikacioni.

Gjatë verës 1983 Nuhiu më njoftoi me gëzim se Lëvizja Popullore ka bërë hapin konkret për themelimin e Ushtrisë së Kosovës, parti e luftës, siç e quante ai. Më tregoi se i kanë caktuar detyrat e gradat ushtarake, shumë i bindur se lufta për çlirimin e Kosovës ishte e pashmangshme.

Një goditje e rëndë për celulën tonë ishte burgosja e Gafurr Elshanit më 1983. Pas shpërndarjes se trakteve në rrethin e Therandës, ai bashkë me Isuf Hoxhën ishin arrestuar e burgosur. Gafurri kishte përballuar të gjitha torturat dhe nuk kishte dhënë asnjë informacion për anëtarët e tjerë të Lëvizjes. Kjo na bëri të mundure që bashkë me Nuhiun të vazhdojmë veprimtarinë ilegale gjatë vitit 1983 dhe deri më 10 janar 1984.

Janari ishte muaj i rëndë për shqiptarët. Në janar 1982 UDB- ja serbe kishte vrarë vëllezërit Gervalla dhe Kadri Zekën në Gjermani. Kur qenë vrarë strategët e Lëvizjes, Nuhiu na tregoi se kishte lidhje direkte me Kadri Zekën. Nuhiu ishte person përgjegjës për mbajtjen e lidhjeve të Lëvizjes brenda dhe jashtë vendit, sidomos me Zvicrën. Rënia e Kadri Zekës dhe e Jusuf e Bardhosh Gërvallës ishte goditja më e rëndë, që deri atëherë i ishte bërë Lëvizjes sonë kombëtare. Edhe pse humbja ishte tepër e rëndë, veprimtarët e Lëvizjes nuk u hamendën për asnjë çast, por vazhduan konsolidimin e radhëve me një zell edhe më të madh. Për ne të gjithë tanimë ishte bërë frymëzim betimi i dëshmorit Jusuf Gërvalla:

Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli vdekja dhe flijimi do të na mbesin si përjetimi më i bukur në këtë jetë dhe nuk do të ketë forcë që të na ndalë nga rruga jonë e lavdishme!

Rënia heroike e Rexhep Malës dhe e Nuhi Berishës

UDB-ja serbe dhe shërbëtorët e saj shqipfolës kishin nuhatur e rënë në gjurmë edhe të bazës, ku ishin strehuar gjeneralët e ardhshëm të Ushtrisë së Kosovës. Më 10 janar 1984 u takuam në mbrëmje me Nuhi Berishën, në banesën time në Kodër të Diellit, pranë shtëpisë së Rexhep Qosjes. Aty unë banoja me qira, bashkë me mjekun Ramadan Sopa nga Bukoshi, i cili punonte në spitalin e Prishtinës. Atë natë Nuhiu ishte i shqetësuar dhe nuk hyri fare brenda. Më njoftoi se kishte informacione që baza

e tyre në Prishtinë, ku qëndronin ilegalë me Rexhep Malën, ishte dekonspiruar dhe vëzhgohej nga Sigurimi serb. Nuhiu mbante vazhdimisht me vete revolen *Sigsauer,* dhuratë nga Kadri Zeka. Ia dhashë 35 fishekë revoleje të kalibrit 9 mm, që m'i kishte kërkuar më herët.

Ndoshta për shkak të moshës së re dhe mungesës së përvojës, nuk e vlerësuam sa duhet rrezikun që kanoste. U morëm vesh të ndërrojmë bazën nga Prishtina në Prizren. Të njëjtën mbrëmje udhëtova për në Prizren dhe kontaktova disa studentë të familjes Balaj nga Ilirioni i Therandës, që banonin në lagjen Tusuz pranë spitalit të Prizrenit. Aty sigurova që njëra dhomë e tyre të jetë e lirë për bazën e përkohshme të Lëvizjes, duke mos i njoftuar se kush do të vinte aty. Nga Prizreni arrita në mbrëmje më 11 janar në Prishtinë. Qëndrova në banesë, duke pritur të vinte Nuhiu, ashtu siç ishim marrë vesh një natë më pare, mirëpo ai nuk erdhi atë natë. Nuk e dija fare vendin se ku ndodhej baza e Nuhiut dhe e Rexhepit. Nuk e dija se atë ditë Nuhi Berisha e Rexhep Mala ishin rrethuar nga forcat policore serbe. Mirëpo e dija mirë se Nuhiu, në çfarëdo situate, nuk binte gjallë në duart e armikut.

Në mëngjesin e 12 janarit 1984 dëgjova në lajmet e RTP- së një informacion të dyshimtë. Njoftohej se policia serbe kishte vrarë kinse dy hajdutë, që iu kishin kundërvënë asaj me armë. Mjetet e informimit serb gjithashtu njoftonin edhe për vendngjarjen e përleshjes së armatosur pranë hekurudhës, në lagjen Kodra e Trimave në Prishtinë.

Lajmi për vrasjen e dy personave më theri në zemër

dhe parandjeva se diç e kobshme kishte ndodhur. Porosita cimerin tim Ramadan Sopa të shkonte shpejt në spital dhe të mësonte se kush ishin dy personat e vrarë më 11 janar 1984. Mjeku Ramadan shkoi menjëherë në spitalin e Prishtinës dhe më njoftoi më vonë se dy të vrarët mbrëmë në Prishtinë ishin dy studentë ilegalë nga rrethi i Gjilanit. Ai kishte hyrë edhe në morgun e spitalit dhe kishte mësuar edhe emrat e tyre: Nuhi Berisha dhe Rexhep Mala.

Në atë çast jam shtangur nga trishtimi, por përnjëherësh më është shfaqur para sysh Nuhiu me revole në dorë: *Ja, e sheh këtë revole, me këtë do ta përzëmë Serbinë nga Kosova. Gjallë nuk bie në dorë të armikut!* Atëherë i përlotur përmblodha veten dhe kërkova shokët për të marrë masa, që të mos pësonin edhe veprimtarët e tjerë.

Nga informacionet që mësuam më vonë, kuptuam ngjarjen e 11 janarit 1984. Nuhi Berisha e Rexhep Mala ishin rrethuar nga forca të mëdhe policore e ushtarake. Kriminelët serbë kishin kërkuar dorëzimin e tyre, por si përgjigje kishin marrë breshëri plumbash. Nuhiu dhe Rexhepi kishin rezistuar tërë natën me armë në dorë deri në fishekun e fundit kundër forcave speciale serbe. Dëshmitarët e rastit kishin pohuar se gjatë gjithë kohës së rrethimit Nuhi Berisha dhe Rexhep Mala kishin shoqëruar krismat me këngë patriotike deri në rënien e tyre heroike, ndërsa në gjoks mbanin flamurin kombëtar. Profesori ynë Muhamet Mehmeti, me të cilin mbanim kontakte dhe kosultoheshim për bashkëveprim në Lëvizje, na tregoi se në operacionin e vrasjes së Nuhi Berishës e Rexhep Malës kishin marrë pjesë, madje

edhe udhëhequr, disa kriminelë shqiptarë, në mesin e tyre edhe një emër i panjohur për ne atëherë, Tahir Zema. Ai kishte qenë edhe personi kyç për ruajtjen e stafetës se diktatorit Tito, kur për herë të fundit po kalonte nëpër Kosovë, më 26 mars 1981.

Me Nuhi Berishën kishim krijuar edhe raporte familjare. Gjatë bisedave rrallëherë ka ndodhur që Nuhiu të mos përmendte Bajramin e vogël, një djalë të vëllait, që e donte shumë. Ai tregonte edhe për lojën që bënte me të:

E hidhja përpjetë në ajër e ai i hapte krahët si shqiponjë!

Nuhiu kishte njoftuar babanë e tij Rexhep Berisha edhe për shokët që kishte në Therandë e nëpër Kosovë. Në një takim me mixhën Rexhep, kur i dërguam me Hysen Gegën një skulpturë të Nuhiut, të punuar nga shokët e Lëvizjes në Zvicër, ai na tregoi edhe porosinë e Nuhiut disa javë para se të vritej. Në mesin e shokëve kishte lënë amanet edhe emrat: Gafurr Elshani e Ilaz Kadolli nga Theranda dhe Shaban Shala nga Drenica.

Miqësia me mixhën Rexhep dhe familjen e Nuhiut ka vazhduar përherë.

Rexhep Mala e Nuhi Berisha: monumenti në Gjilan.

Vrasja e strategëve të Lëvizjes, vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës nga UDB- ja në Gjermani dhe rënia heroike e gjeneralëve të luftës Rexhep Mala e Nuhi Berisha ishin goditja më e rëndë deri atëherë, që kishte pësuar Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi. Vrasja e Nuhiut dhe e Rexhepit në Prishtinë kishte shkaktuar edhe tronditje në celulat e organizuara të Lëvizjes në Kosovë. Më 4 shkurt 1984 bie heroikisht për lirinë e Kosovës edhe veprimtari i Lëvizjes, Bajram Bahtiri. Në këto rrethana të terrorit

shtetëror serb ishte vështirë të riorganizohej Lëvizja. Kemi vazhduar kontaktet individuale me disa veprimtarë nga rrethi i Therandës, si me Murat Bytyçin, Xhemajl Rudin, Halil Krasniqin, Sadik Halitjahën dhe Ibrahim Shalën.

Në verën 1984, gjatë gjykimit politik të Gafurr Elshanit e Isuf Hoxhës në Gjykatën e qarkut në Prizeren, Gafurrit i shpreha ngushëllime për Nuhiun e Rexhepin. Kur i thashë se a t'u dhimbsën shokët e rënë, Gafurri ma ktheu prerazi: *Jo, ata nuk pranuan të lidhen dhe ranë për liri, ndërsa ne pranuam burgun dhe jemi këtu. Kam qenë i bindur se Nuhiu nuk dorëzohej gjallë!* Nuhi Berisha dhe Rexhep Mala vërtet sot janë gjallë, të përjetshëm e heronj të kombit shqiptar. Emri dhe vepra e tyre ishin frymëzim për luftën heroike të UÇK- së. Monumenti i tyre sot qëndron me krenari në qendër të Gjilanit, si dëshmi se ky vend gjithmonë ka qenë dhe do të jetë shqiptar.

Me Fadil Vatën e Afrim Zhitinë

Nga shokët e Lëvizjes kisha dëgjuar për emrin e Fadil Vatës. Ata më patën treguar për burgosjen e Fadilit më 1981 në Armatën jugosllave. Pas Demonstratave 1981 qenë dënuar me qindra të rinj shqiptarë, në mesin e të cilëve kishte edhe të rinj nga Theranda. Shokët flisnin me admirim e respekt të madh për qëndrimin stoik të Fadil Vatës në burgun famëkeq të Pozharevcit, për torturat mizore dhe prangosjen e tij këmbë e duar edhe kur ishte i sëmurë rëndë në Spitalin ushtarak të Beogradit. Prisja me padurim takimin me Fadili Vatën. Dalja e tij nga

burgu më 30 prill 1987 pati ndikim shumë të madh te shokët e organizuar të Lëvizjes. E takova për herë të parë në fshatin e tij Lumbardh (*Sallagrazhdë*), ku vinin njerëz nga të gjitha anët për ta parë pas daljes nga burgu. Shtëpia e tij ishte bërë një vendtakim e rinjohje e shokëve të organizatës. Dhoma e tij e pritjes ishte plot libra, një bibliotekë e tërë me literaturë të huaj dhe të shkrimtarëve shqiptarë. Në mes të dhomës pashë për herë të parë Fadil Vatën, një djalë i gjatë e me trup të hedhur, flokë të ngritura lart, shumë modest e mendjekthjellët. Sytë i kishte si të shqiponjës. Dukej i zbehtë në fytyrë, sigurisht nga qëndrimi i gjatë në burg ose nga sëmundja që kishte marrë atje. Kisha shumë kujdes të mos e ngarkoja me pyetje, ngase ai kishte nevojë për pushim. Ndërkohë Fadili më pyeti si qëndron organizimi i Lëvizjes? Ai tha se nuk kemi kohë për të pritur shumë dhe më propozoi që pas disa ditësh të takojmë shokët Halil Krasniqi, Murat Bytyçi, Sadik Halitjaha, Ibrahim Shala, Xhemajl Rudi etj. nga rrethi i Therandës. Takimin e bëmë disa ditë pas daljes nga burgu, në një udhëtim drejt Bjeshkës së Bukoshit. Në një luginë pranë fshatit Gurkuq (*Maçitevë*) provuam krismat e revoles. Disa herë shtimë në një gur për të dëgjuar krismën dhe sa për t'ia hequr ndryshkun revoles. Fadili kishte gjuajtje precize. Shokët e kishin përshkruar vetëm si ideolog, por ai njihte edhe armët dhe artin e luftës. Me Fadil Vatën u morëm vesh të takohemi në Prishtinë. Ai më tregoi edhe për shokët e burgut, sidomos për Afrim Zhitinë, me të cilin kishte qëndruar disa vjet në burgun famëkeq të Pozharevcit. Afrimi, derisa ishte në pushim, nuk i përgjigjet shër-

bimit ushtarak dhe kalon në ilegalitet të thellë.

Pas disa ditësh udhëtuam me Fadilin për në Prishtinë dhe në një shtëpi në Kodër të Diellit takuam Afrim Zhtinë. Isha shumë i lumtur që tani në Lëvizje takova edhe dy shokë të rinj. M'u duk sikur u ringjallën Rexhep Mala e Nuhi Berisha! Pothuajse tërë natën vazhduam bisedën për organizimin e Lëvizjes, për shokët e rënë dhe shokët e gjallë që duhej takuar. Secili prej tyre ishte më i mirë se shoqi: të zgjuar, të qartë, të dashur e të guximshëm, por dukeshin ende të zbehtë në fytyrë nga qëndrimi i gjatë në burg. Biseduam për domosdoshmërinë e konsolidimit dhe zgjerimit të Lëvizjes, mbajtjen e një mbledhjeje, ku do të zgjidheshin organet drejtuese të Lëvizjes. Gjatë tërë kohës Fadili mbante shënime, ndërsa Afrimi mbante kraheqafë një çantë të zezë, plot me municion dhe një automatik të markës *Skorpion*, me ngjyrë të zezë. Afrimi vepronte në ilegalitet të thellë dhe lëvizte vetëm natën. Me vete mbante edhe bomba, ishte tamam luftëtar profesionist.

I thashë kujdes se serbët janë djaj. Ai vetëm buzëqeshi: *Kurdo që të ma mësyjnë, falë nuk do të shkoj dhe nuk do të kalojnë mirë as serbët!* Atë natë u ndamë me përshtypjet më të mira. Fadili dhe Afrimi arritën shumë shpejt të formojnë këshillat e rretheve në të gjitha viset shqiptare.

Mbledhja e Dyflakës (*Divjakës)*

Në pranverë 1989, në Dyflakë të Altarit (*Kleçkë)*, LPRK organizoi mbledhjen e Komitetit drejtues të Lëvizjes. Nga Prishtina për në Dyflakë udhëtuam me Sahit Krasniqin nga Kastrioti, një veprimtar shumë aktiv i Lëvizjes. Sahiti drejtonte makinën, duke nbajtur në prehër një revole të bukur. Rrugën e kalum sa çel e mbyll sytë, duke biseduar për veprimtarinë e Lëvizjes. Sahiti i kishte halë në sy udbashët serbë dhe fliste me neveri e urrejtje për bashkëpunëtorët e tyre shqiptarë. Në mbrëmje u tubuam në një shtëpi të vjetër në fshatin Dyflakë, shumë e maskuar për takime ilegale. Askush nuk kishte marrë me mend se pikërisht kjo shtëpi, 10 vjet më vonë, më 1998 do të bëhej bazë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Në hyrje të shtëpisë na priti i zoti i saj Nezir Zogaj, një burrë trupshkurtër e bujar. Më bëri përshtypje përvoja e tij për të kamufluar shtëpinë, që të mos binte në sy të armikut. Në hyrje të shtëpisë, ku shkallët ngriheshin në katin e dytë, kishte vënë najlon të trashë për të mos u vërejtur delegatët.

Në odën në katin e dytë na priste Fadil Vata e Afrim Zhitia, që kishin ardhur më herët. Pas çdo gjysmë ore në këtë shtëpi mbërrinin përfaqësues të tjerë të LPRK- së: Ali Ahmeti, Behajdin, Allaçi, Ilaz Kadolli, Binak Berisha, Bardhyl Mahmuti, Hajdin Abazi, Sahit Krasniqi, Fadil Bajrami, Ruzhdi Saramati etj. Mbledhja vazhdoi punimet tri ditë e tri net. Atëherë në Kosovë mbretëronte gjendje e jashtëzakonshme. Serbia kishte ndaluar çdo tubim të qytetarëve, ndërsa nga mbrëmja deri në mëngjes kishte vënë orën policore.

Mirëpo, kjo nuk vlente edhe për LPRK- në, e cila lëvizte ditën e natën para hundëve të pushtuesit.

Mbledhja udhëhiqej nga Fadil Vata e Afrim Zhitia. Gjatë mbledhjes mbaheshin shënime, vendosej në mënyrë demokratike, me propozime e votime. Në atë mbledhje u diskutua për organizimin më të gjerë, format e luftës dhe realizimin e programit të Lëvizjes.

Pas tri ditësh mbledhja zgjodhi organet drejtuese. Fadil Vata u zgjodh sekretar politik i Lëvizjes, ndërsa Afrim Zhitia sekretar organizativ. Me ardhjen e këtyre dy udhëheqësve në krye të Lëvizjes çdo gjë ndryshoi për mbarë në radhët e saj. Lëvizja filloi të forcohej dhe të shtoheshin radhët në gjitha viset shqiptare e në diasporë.

Takimet ishin të rregullta në Prishtinë. Mirëpo, atëherë Fadil Vata nuk ndihej mirë. Fytyra e tij çdo ditë e më tepër shprehte shenja lodhjeje e zbehjeje, por ai nuk jepej dhe nuk pranonte sëmundjen. Shokët e Zvicrës na kishin sugjeruar që Fadili të udhëtonte për mjekim në Zvicër. Fadili kishte siguruar më herët dokumentacionin e udhëtimit. Një mbrëmje ai u nis nga Prishtina për në Zvicër. M'u duk se nirthte dhe hoqa pallton time dhe ia dhashë. E mori me keqardhje, por palltoja i rrinte bukur. Fadili mori me vete edhe informacionet për gjendjen organizative të LPRK- së brenda vendit. U përshëndetëm me shtrëngim duarsh, duke mos pritur kurrë se ai do të ishte takimi ynë i fundit!

Në tetor 1989 LPRK në Zvicër mban Mbledhjen II të përgjithshme, ku delegatë nga Kosova ishin Fadil Vata, Ahmet Haxhiu dhe Arif Seferi.

Atëherë në Lëvizjen në vend vepronin: Fadil Vata, Afrim Zhitia, Ramadan Avdiu, Ilaz Kadolli, Behajdin Allaçi, Binak Berisha, Servete Krasniqi, Arif Seferi, Bedri Sokoli, Sahit Krasniqi, Jakup Nura, Musa Demiri, Shaban Muja, Ibish Neziri, Azem Syla e shumë të tjerë.

Largimi i Fadil Vatës për në Zvicër krijoi një zbrazëti në Lëvizje, ngase ai ishte një lider politik e organizativ. Brenda një kohe të shkurtër ai zgjeroi radhët e Lëvizjes dhe vendosi kontakte gati me të gjitha rrethet në Kosovë dhe në viset shqiptare nën Jugosllavi.

Më 17- 18 tetor 1989 Komiteti drejtues i LPRK- së mban në Prishtinë, në banesën e Binak Berishës, një mbledhje të rregullt, që udhëhiqej nga Afrim Zhitia. Pjesëmarrës të mbledhjes ishin: Behajdin Allaçi, Ilaz Kadolli, Bardhyl Mahmuti, Binak Berisha dhe Ramadan Avdiu.

Për shkak të shkuarjes së Fadil Vatës në Zvicër, ku planifikonte të shkonte edhe Afrim Zhitia, në këtë mbledhje u vendos të plotësohej Komiteti drejtues i Lëvizjes me dy anëtarë të rinj, Ramadan Avdiun, që para pak kohësh kishte dalë nga burgu, dhe Ilaz Kadollin.

Kjo mbledhje e LPRK- së miratoi planin për riorganizimin e Lëvizjes, organizimin e demonstratave kundër pushtuesit dhe përkrahjen e grevës e kërkesave të minatorëve të Trepçës. Mbledhja hartoi edhe një deklaratë politike në mbështetje të Qeverisë dhe të popullit slloven për pavarësi e vetëvendosje nga ish- Jugosllavia. Në atë kohë veç dukeshin qartë tendencat për pavarësi të republikave dhe shkëputje

nga ish- Federata jugosllave, ku më e zëshme ishte Sllovenia.

Mirëpo, ishte pikërisht LPRK- ja, e udhëhequr nga ideologët Kadri Zeka e vëllezërit Gërvalla dhe strategët Rexhep Mala e Nuhi Berisha, Fadil Vata e Afrim Zhitia, që dridhi themelet e kësaj krijese artificiale dhe vuri themelet e lirisë sonë.

Atëherë në Kosovë mbretëronte një situatë shumë e rëndë, me terror shtetëror e aparteid etnik. Serbia përgatitej të rrëmbente edhe atë pak autonomi, që kishte Kosova me Kushtetutën 1974. Rrëmbimi me dhunë i autonomisë së Kosovës më 1989 shkaktoi një revoltë të përgjithshme popullore. Sërish në demonstrata dolën studentët dhe punëtorët. Në krye të këtyre demonstratave ishin liderët e Lëvizjes, Afrim Zhitia me shokë, për të kundërshtuar heqjen e autonomisë. Terrori shtetëror serb në Kosovë tani udhëhiqej drejtpërdrejt nga Beogradi, nën komandën e kriminelit Milosheviç. Fjalimi i Milosheviçit në Fushë- Kosovë më 1989 ikurajoi serbët lokalë të mobilizoheshin dhe të kërcënonin me luftë për t'i frikësuar shqiptarët të pranonin në heshtje pushtimin. Fjalimi i Milosheviçit kishte çjerrë maskën e politikës serbe në Kosovë. Serbia tashmë kishte vënë në zbatim projektin e Akademisë Serbe të Shkencave për pastrimin etnik të Kosovës dhe dëbimin e shqiptarëve drejt Europës e Shqipërisë.

Për shkak të dhunës sistematike dhe përkeqësimit të planifikuar të gjendjes ekonomike, rinia e Kosovës dhe e viseve shqiptare u detyrua të shpërngulej në masë. Për çdo ditë nga qytete të ndryshme të Kosovës shpërnguleshin qindra- mijëra të rinj e të reja drejt Perëndimit. Plani i fshehtë i Serbisë për shpërnguljen

masive të shqiptarëve dhe ndryshimin e strukturës etnike të Kosovës ishte analizuar e studiuar mirë nga udhëheqësit e Lëvizjes në Kosovë. Për realizimin e këtij plani Serbia nuk kishte lënë gur pa lëvizur. Dhuna sistematike, arrestimet, torturat nëpër burgje e rrugë, mbytja e foshnjave nëpër spitale dhe helmimet masive të nxënëseve nëpër shkolla fillore e të mesme ishin planifikuar nga regjimi pushtues serb.

Vrasja e ushtarëve shqiptarë në Armatën jugosllave nga shërbimet sekrete serbe bëhej e organizuar. Ushtarët e vrarë shqiptarë ktheheshin në arkivole të mbyllura hermetikisht, në mënyrë që të mos vëreheshin gjurmët e krimeve të dyfishta. Atyre , në emër të obduksionit, u merreshin edhe organet e trupit. Të gjitha këto krime monstruoze në Armatën jugosllave bëheshin në bashkëveprim me qeverinë serbe të Beogradit.

Të gjitha këto krime fashiste serbe analizoheshin vazhdimisht në mbledhjet e fshehta të LPRK- së, sidomos nga Kryesia e Lëvizjes. Përfundim logjik ishte se rrugë e vetme për realizimin e kërkesave legjitime të shqiptarëve nën Jugosllavi mbetej lufta e armatosur. Këtë domosdoshmëri e potenconte në çdo takim të Lëvizjes sekretari organizativ i saj Afrim Zhitia më 1988 dhe 1989.

Rënia heroike e Afrim Zhitisë dhe e Fahri Fazliut

Sigurimi serb me langonjtë shqipfolës i kishte rënë në gjurmë edhe Afrim Zhitisë. Më 2 nëntor 1989 forca të mëdha të policisë speciale kishin rrethuar Afrim Zhitinë e Fahri Fazliun në lagjen Kodra e

Diellit në Prishtinë. Lajmi u dha shpejt nga shokët e organizatës. Atëherë isha në Bukosh dhe njoftova shpejt edhe dy shokë të LPRK- së në Therandë, Murat Bytyçin e Bexhet Berishën. Nga shtëpia mora pistoletën, municion dhe disa bomba dore. Në makinë mora edhe bashkëshorten dhe djalin e vogël Iliri, në trupin e të cilit vendosa tërë municionin, si kamuflim për të kapërcyer postblloqet e shumta nëpër rrugën për në Prishtinë. Kur mbërrita në Prishtinë, takova pranë vendngjarjes në Kodër të Diellit kushërirën tim Avdi Kadolli, i cili më njoftoi me pikëllim se kishte përfunduar beteja mes dy udhëheqësve të LPRK- së dhe forcave policore serbe. Avdiu tregonte se ishte e pamundur t'i afroheshe vendngjarjes. Kodra e Diellit atë ditë gjëmonte nga krismat e topave, murtajave e autoblindave serbe dhe qëndresa heroike e Afrim Zhitisë e Fahri Fazliut. Në këtë ndeshje të pabarabartë, pas një qëndrese heroike, bien për të mos vdekur kurrë udhëheqësit supremë të Lëvizjes sonë, shokët e komandantët e ardhshëm të Luftës çlirimtare, Afrim Zhitia e Fahri Fazliu.

Afrim Zhitia gjithherë ishte i gatshëm për sakrificë. Gjithnjë mbante me vete revolen *Uzi* dhe një çantë të zezë mbushur me municion e bomba dore.

Afrim Zhitia ishte një djalë i pashëm, ballëlartë e me sy të mprehtë shqiponje. Ai përfaqësonte komplet udhëheqësin e ardhshëm të çlirimit dhe të bashkimit kombëtar

Rënia heroike e Afrimit dhe e Fahriut ishte edhe një goditje tjetër e rëndë për Lëvizjen tonë, por ajo shtoi edhe më tepër urrejtjen ndaj Serbisë pushtuese. Qëndresa e tyre heroike ishte edhe një betim e mobilizim i ri

për të vazhduar luftën për çlirim e bashkim kombëtar.

Në këtë gjendje të rëndë, dhjetë ditë pas rënies së Afrim Zhitisë e Fahri Fazliut, Këshilli drejtues i Lëvizjes mbajti një mbledhje urgjente në Prizren, në shtëpinë e Shaban Shalës. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm: Ramadan Avdiu, Ilaz Kadolli, Behajdin Allaçi, Binak Berisha dhe Bajram Kadriu(*Koci*). Bardhyl Mahmuti, për shkak të dekonspirimit, ishte detyruar të largohej nga Kosova.

Në këtë mbledhje u analizuan situata e re e jashtëzakonshme dhe veprimet e mëtejshme të Lëvizjes.

Strategët e Lëvizjes Fadil Vata e Afrim Zhitia.

*

Më 25 prill 1990 ndërron jetë në spitalin e Bazelit të Zvicrës Fadil Vata, njëri ndër udhëheqësit krye-

sorë të Lëvizjes. Vdekja e tij ishte edhe një goditje tjetër e rëndë për Lëvizjen dhe dhimbje e madhe për popullin e robëruar të Kosovës. Pas shumë përpjekjeve, veprimtarët e Lëvizjes në Zvicër ia kishin dalë që trupi i Fadil Vatës të kthehej në atdhe. Varrimi i Fadil Vatës ishte madhështor në vendlindjen tij në Lumbardh të Therandës. Me mijëra qytetarë nga të gjitha viset e atdheut i bënë nderimet e fundit heroit të përjetshëm të tyre. Me Halil Krasniqin porositëm në Prizren një pllakë përkujtimore me mbishkrimin *E përkujton populli*, të cilën së bashku me flamurin kombëtar i vendosëm pranë varrit të tij.

Mbledhja e Ujëmirit

Lëvizja Popullore e Kosovës edhe në rrethana të rënda pushtimi ruajti vazhdimësinë e veprimit.

Më 2 shkurt 1991, në fshatin Prapashticë të Prishtinës, mbahet mbledhja përgatitore e Lëvizjes, në të cilën marrin pjesë rreth 20 delegatë nga të gjitha rrethet: Xhavit Haziri, Ramadan Avdiu, Halit Krasniqi, Ismet Sylejmani, Ilaz Kadolli, Behajdin Hallaçi, Azem Syla, Ramadan Pllana etj.

Aty miratohet vendimi për vazhdimin e veprimit ilegal, duke e kombinuar me forma të ndryshme të veprimit. Mbledhja zgjodhi Komitetin e ri drejtues dhe mori vendim për përgatitjen e Mbledhjes III të përgjithshme të LPRK- së.

Në Mbledhjen e tretë të përgjithshme, njëra ndër më të rëndësishmet që nga themelimi i saj më 1982, përveç këshillave të rretheve në Kosovë, ishin ftuar dhe përfaqësues nga dega e Lëvizjes jashtë vendit.

Të gjitha përgatitjet ishin bërë kryesisht natën dhe në konspiracion të thellë. Atëherë në Kosovë mbretëronte një situate e rëndë nga terrori shtetëror serb. Para Lëvizjes shtroheshin detyra të vështira e me rëndësi historike. Në të gjitha këshillat e vendit të LPK- së ishte analizuar situata politike e organizimi dhe ishin caktuar detyra në të gjitha nivelet e Lëvizjes në Kosovë dhe në viset shqiptare nën Jugosllavi.

Vendi i mbledhjes ishte caktuar më herët dhe mbahej në fshehtësi të thellë. Si rajon më i sigurt ishte caktuar fshati Ujëmir i Klinës, përkatësisht shtëpia e Sadri Shalës, një familje e njohur për besnikëri dhe tradita atdhetare. Ishin ndërmarrë të gjitha masat që delegatët të vinin të sigurt në këtë mbledhje.

Drejt Ujëmirit udhëtuam në mbrëmjen e 4 tetorit 1991 së bashku me delegatët nga rrethi i Prizrenit dhe Therandës. Në udhëkryqin e Pleqnorit (*Kjevë*) na priste Azem Syla, i cili ishte përgjegjës kryesore i logjistikës dhe vendtakimeve për mbledhje.

Shtëpia ku mbahej mbledhja ishte e vjetër, e ndërtuar me gurë. Oda ishte e traditës shqiptare, me plot portrete të heronjve kombëtarë, si Gjergj Kastrioti- Skënderbeu, Ismail Qemali, Isa Boletini, Luigj Gurakuqi etj., ndërsa në ballë të saj një tryezë pune mbuluar me flamur kombëtar.

Oda ishte rregulluar enkas për këtë qëllim dhe ishin marrë masa sigurie. Në dritare ishin vënë perde të trasha, që të mos vërehej natën asgjë nga jashtë. Në shërbim të mbarëvajtjes së mbledhjes ishte e gjithë familja Shala, kryefamiljari Sadriu me djemtë anëtarë të Lëvizjes.

Në mbledhje arritën sipas organizimit të gjithë delegatët dhe të ftuarit e tjerë. Ishte një moment emocional dhe i papritur kur për herë të parë në një mbledhje tonë pashë profesorin tonë të nderuar dr. Muhamet Mehmeti, me të cilin mbanim kontakte që nga viti 1981. Nga ai merrnin udhëzime të rëndësishme për veprim ilegal në Universitetin e Prishtinës dhe më gjerë.

Në këtë mbledhje merrnin pjesë delegatë nga të gjitha rrethet në Kosovë dhe në viset shqiptare nën Maqedoni, Kosovë Lindore, Mal të Zi dhe nga diaspora.

Pjesëmarrës të Mbledhjes III të përgjithshme në Ujëmir ishin:

Emrush Xhemajli, Ramadan Avdiu, Xhavit Haziri, Azem Syla, Behajdin Allaçi, Ilaz Kadolli, Guximtar Labenishti, Muhamet Mehmeti, Hashim Thaçi, Hydajet Hyseni, Ali Lajçi, Ahmet Haxhiu, Binak Berisha, Bislim Elshani, Xhevat Hasani, Bahri e Fadil Fazliu, Gani Syla, Ramë Buja, Berat Luzha, Mehmet Hajrizi, Hidajete Krasniqi, Musa Demiri, Fadil Bajrami, Nazmi Hoxha e Xheladin Gashi - Plaku.

Mbledhja filloi me zgjedhjen e kryesisë së punës, miratimin e rendit të ditës dhe verifikimin e mandateve të delegatëve.

Punimet e mbledhjes u zhvilluan në një atmosferë e disiplinë korrekte, me propozime e votime demokratike. Pothuajse të gjithë delegatët kishin marrë fjalën, duke diskutuar hapur për gjendjen politike në Kosovë, në rajon dhe atë ndërkombëtare.

Në këtë mbledhje u trajtuan të gjitha variantet e mundshme për arritjen e qëllimeve programore të

Lëvizjes dhe çlirimin e vendit. Për domosdoshmërinë e përgatitjes urgjente të luftës së armatosur në Kosovë ishim pajtuar më herët në këshillat e rretheve të LPRK- së në Therandë, Prizren dhe Rahavec. Në emër të këtyre këshillave, propozimin e arsyetimin për përgatitjen dhe fillimin e Luftës çlirimtare në Kosovë e paraqiti me një profesionalizëm e bindshmëri Behajdin Allaçi, delegat nga Prizreni.

Mbledhja III e përgjithshme e LPRK- së erdhi në përfundime se lufta e armatosur ishte e pashmangshme për arritjen e qëllimit final të Lëvizjes-çlirimin dhe ribashkimin e shqiptarëve në një shtet të vetëm.

Në këtë mbledhje u diskutuan edhe çështje të brendshme të organizimit të Lëvizjes. Për shkak të ndryshimit të rrethanave ndërkombëtare, Mbledhja bëri edhe ndryshime statutare, duke hequr pararojën OMLK.

Kjo mbledhje është filmuar tërësisht me kamerë amatore dhe materialet e saj gjenden në arkivin e LPK-së.

Mbledhja e Kollares

Edhe Mbledhja konsultuese e Lëvizjes në Kollare të Kërçovës në fillim të prillit 1993 ishte një mbledhje e rëndësishme. LPRK, si organizatë politike e ushtarake, ka qenë e shtrirë edhe në viset shqiptare nën Maqedoni. Për çdo takim a mbledhje ilegale duheshin përgatitje, disiplinë dhe përkushtim maksimal.

Një kontribut të veçantë për përgatitjen e Mbledhjes së Kollares kanë dhënë Ahmet Haxhiu, Ra-

madan Avdiu, Gafurr Elshani, Behajdin Allaçi dhe Xhavit Haziri.

Për koordinimin e punëve dhe përgatitjen e kësaj mbledhjeje, në janar 1993 udhëtuam nëpër Maqedoni për në Tiranë me Ramadan Avdiun, Behajdin Allaçin dhe Xhavit Hazirin. Aty u takuam me drejtuesit e Lëvizjes jashtë vendit, që për këtë qëllim kishin ardhur nga Zvicra: Ali Ahmetin (*Abazi)*, Emrush Xhemajlin e Xhavit Halitin (*Zeka*). Qëllimi i takimit ishte koordinimi i veprimeve të Lëvizjes brenda dhe jashtë vendit, njohja me gjendjen organizative të LPRK- së brenda vendit dhe përgatitja e Mbledhjes së Kollares. Neve më së shumti na interesonte gatishmëria e shtetit amë, Shqipërisë, për të mbështetur luftën për çlirimin e Kosovës me vise nga pushtuesit shekullorë sllavë.

Nga takimet që patëm në Tiranë, më ka lënë përshtypje një këshillë strategjike e atdhetarit dhe veteranit Shaban Braha në shtëpinë e tij. Baca Shaban kishte vlerësuar gatishmërinë e drejtuesve të Lëvizjes për të hyrë në luftë me Serbinë. Ai na porositi kështu:

Djema, ju me të vërtetë keni vendosur të luftoni. Nuk dyshoj aspak që ju jeni të vendosur e të gatshëm për sakrifica, por mos harroni se ju jeni pak, ndërsa në luftë ju nevojiten të gjithë, edhe ata që nuk janë 100% të mirë. Në luftë ju nevojiten edhe fshatarët e thjeshtë, edhe ata kanë ndonjë kalë a qerre, që do t'ju shërbejnë për bartjen e armatimit dhe të të plagosurve. Mos lejoni që lufta për Kosovën të shndërrohet vetëm në luftë guerile, ajo duhet të jetë luftë gjithëpopullore. Të formohet ushtria e rregullt, të ketë vija fronti dhe zona të lira luftimi, edhe pse

humbjet do të jenë më të mëdha. Në asnjë mënyrë nuk bën që lufta jonë t'i ngjajë gueriljes palestineze, sepse është rrezik që lufta jonë të zgjasë shumë vjet, ndoshta edhe me dekada, dhe të mungojë përkrahja ndërkombëtare.

Në maj 1992 vjen nga Zvicra dhe hyn ilegalisht në Kosovë Gafurr Elshani për të ndihmuar konsolidimin e radhëve të Lëvizjes brenda vendit dhe përgatitjen e Mbledhjes së Kollares.

Gafurri kishte qëndruar ilegalisht mbi dy javë në shtëpinë e veteranit Ahmet Haxhiu në Prishtinë, që ishte bazë e Lëvizjes, ku kryesisht bëheshin punët e koordinimit të veprimtarisë së Lëvizjes. Para se të kthehej në Zvicër, Gafurri vizitoi një kohë të shkurtër edhe prindërit e tij në Therandë. Së bashku me Gafurrin vizituam edhe veteranin Hysen Gega në Lumbardh, ku shkëmbyem informacione për veprimtarinë e Lëvizjes brenda dhe jashtë vendit.

Mirëpo, Gafurri duhej të kthehej sërish në Zvicër, duke dalë ilegalisht nga Kosova. Gafurri dhe Ramadan Avdiu kishin provuar ta kalonin kufirin afër Hanit të Elezit, por ishin kapur nga patrulla kufitare e Maqedonisë, që i kishte dorëzuar te policia kufitare serbe në Han të Elezit. Fatmirësisht, ajo ditë ishte e diel dhe Gafurri kishte letërnjoftimin e vëllait të tij, shumë i ngjashëm me të. Policët serbë nuk kishin mundur ta identifikonin Gafurrin. Kishin marrë shënimet e nevojshme dhe i kishin lëshuar ata, me porosi të paraqiteshin të hënën në stacionet e tyre policore. Për arrestimin e Gafurrit dhe të Ramadanit më kishte njoftuar një person nga fshati Arrishtë (*Vraniq*) i Therandës, i cili kishte qëlluar atë çast në

Han të Elezit. Ai e kishte parë Gafurrin duarlidhur.

Menjëherë shkova në Prishtinë te baca Ahmet Haxhiu dhe aty gjeta Gafurrin e Ramadanin, që porsa ishin kthyer nga kufiri. Ata treguan në hollësi ngjarjen dhe vetëm fati i kishte shpëtuar. Aty vendosëm ta përcillnim Gafurrin pëtej kufirit. Së bashku me Ahmet Haxhiun e Ramadan Avdiun u nisëm me veturën time Golf-2 në drejtimin Gjilan-Preshevë-Shkup. Në Strugë takuam veprimtarin e Lëvizjes Guzimtar Labenishti, i cili organizoi kalimin ilegal natën për në Shqipëri. Gafurri kaloi kufirin së bashku me disa të rinj nga Shqipëria, që bënin tregti me bagëti në Maqedoni. Kur Gafurri doli mirë në Shqipëri, së bashku me Guzimtarin, bacën Ahmet dhe Danin shfrytëzuam rrugën të vizitojmë edhe Shën Naumin, një perlë shqiptare buzë liqenit të Ohrit, ku buronte Drini i Zi. Ahmet Zogu ia kishte falur Shën Naumin Mbretërisë jugosllave, si shpërblim për ndihmën për t'u rikthyer në fronin shqiptar.

Mledhja e Kollares u mbajt më 24 prill 1993 dhe ishte parapërgatitje për Mbledhjen IV të përgjithshme, që u mbajt **m**ë 28-29 korrik 1993 në shtëpinë e veprimtarit Fatmir Brajshori në Kodër të Trimave të Prishtinës.

Fshati Kollare nuk ishte zgjedhur rastësisht. Ishte një fshat i vogël, por i njohur për tradita liridashëse e atdhetare. Nga ky vend dhe nga kjo anë ishin edhe dy ndër udhëheqësit kryesorë të LPRK-së, Fazli Veliu e Ali Ahmeti. Vendi ku u mbajt mbledhja ishte i sigurt. Gjithë rrugët që çonin në Kollare siguroheshin nga sektori i veçantë i Lëvizjes me djemtë e armatosur të Kollares. Për çdo rast rrethimi, ishte edhe plani i

mbrojtjes e tërheqjes kah kufiri i Shqipërisë. Atëherë LPRK ishte në vlugun e organizimit të mirëfilltë politik. Në këtë periudhë kishte formuar këshillat e rretheve pothuajse në të gjitha viset shqiptare nën Jugosllavi. Në Mbledhjen konsultuese të Kollares morën pjesë delegatët: Ahmet Haxhiu, Xhavit Haziri, Behajdin Hallaçi, Beqir Limani, Ruzhdi Veliu, Ali Ahmeti, Gafurr Elshani, Hydajete Krasniqi, Azem Syla, Adem Grabovci, Bilall Sherifi, Ramadan Avdiu, Halil Selimi, Ilaz Kadolli, Guximtar Labinishti, HashimThaçi, Adnan Asllani, Fadil Bajrami, Ibish Neziri, Sali Lajçi, Gani Fetaj, Musa Demiri, Bexhet Luzha, Fatmir Brajshori, Hysen Gega, Milaim Elshani, Ramadan Pllana, Dervish Çadraku, Mustafë Krasniqi dhe Ulusi Sylejmani.

Mbledhja u zhvillua në një atmosferë korrekte. U caktua rendi i ditës dhe u zgjodh kryesia e punimeve të mbledhjes. Në kryesinë e punës u propozua edhe Behajdin Allaçi, i cili kishte përvojë të mirë në udhëheqje e në analiza politike. Ndërkohë erdhi i papritur kundërshtimi i Hashim Thaçit dhe Azem Sylës. Pjesëmarrësit kërkuan arsyetime e fake. Ata thanë se Behajdini kishte faje që në radhët e Lëvizjes kishte futur Shaban Shalën nga Prizreni, një person i dyshuar kinse për lidhje me Shërbimin e fshehtë serb. Për këto dyshime ata nuk ofruan argumente dhe kundërshtimi i tyre nuk u pranua nga shumica e delegatëve. Nëse Behajdin Allaçi nuk mund të ishte në kryesimin e kësaj mbledhjeje, ai as nuk mund të ishte fare pjesëmarrës i mbledhjes, andaj kundërshtimi i tyre u pa me dyshime qysh atëherë nga pjesëmarrësit e mbledhjes.

Mbledhja bëri një analizë të hollësishme të situatës politike brenda dhe jashtë vendit, duke vlerësuar edhe situatën ndërkombëtare. Ajo pati një rëndësi të veçantë për vendimet që mori:

- Të fillojnë përgatitjet urgjente për luftë të armatosur në Kosovë.

- Të fillohet me aksione të armatosura kundër ushtrisë, policisë dhe bashkëpunëtorëve të pushtuesit serb në Kosovë.

- Të organizohet Mbledhja IV e përgjithshme e LPRK-së, që do të mbahej në fund të korrikut 1993 në Prishtinë.

Vendimet që u morën në këtë mbledhje filluan të zbatohen menjëherë nga sektorët e veçantë. Këshillat e rretheve të LPRK-së në Drenicë ndërmorën një aksion të armatosur në verën 1993 kundër patrullave policore serbe afër hekurudhës në Drenas, ku iu shkaktuan dëme në efektiv e teknikë forcave armike. Nga Kollarja u kthyem një natë me shi, me makinën time që ishte në shërbim të Lëvizjes. Kur mbërritëm në Therandë, afër stacionit të policisë na ndali patrulla serbe. Në atë moment u gjend më se miri baci Hysen, duke iu drejtuar policëve: unë i kam të gjitha fajet për këtë udhëtim në orët e vona të natës, sepse dëshirova të rrinim më gjatë në një dasmë në Prishtinë! Policët shënuan vetëm emrat tanë dhe ne vazhduam rrugën për në shtëpitë tona.

Organizimi i LPK-së

Rruga e Lëvizjes Popullore të Kosovës ishte e gjatë, e mundimshme dhe me plot sakrifica. E veçanta e

LPK- së, që e dallon nga të gjitha organizimet e tjera politike shqiptare, legale e ilegale, ishte këmbëngultësia e vazhdimësia e veprimtarisë, pavarësisht sfidave e goditjeve nga pushtuesi serb. Megjithatë, në shumë raste rëniet heroike vetëm kanë forcuar e mobilizuar edhe më tepër Lëvizjen. Gjatë veprimtarisë 30-vjeçare, që nga themelimi më 1982 deri në përfundim të Luftës së UÇK-së, Lëvizja ka pasur rënie e ngritje, por asnjëherë nuk ka pushuar veprimtarinë për çlirim e bashkim kombëtar, pavarësisht se janë burgosur e torturuar shumë veprimtarë dhe kanë rënë shumë dëshmorë.

Në radhët e Lëvizjes mund të aderonte çdo qytetar, që pranonte programin dhe statutin e saj, pa marrë parasyshe gjininë dhe përkatësinë fetare a krahinore. Kusht i vetëm ishte pastërtia morale e kombëtare, që vlente sidomos për organet drejtuese të Lëvizjes. Veprimtarët dhe simpatizuesit e Lëvizjes kishin orientim kombëtar, karakter të fortë dhe shquheshin për guxim, disiplinë e vendosmëri në kryerjen e detyrave. Në rrethana të rënda të pushtimit, anëtarët e Lëvizjes ishin mjaft vigjilentë, por edhe shumë këmbëngulës në realizimin e qëllimit përfundimtar – çlirimin e vendit dhe ngadhënjimin mbi pushtimin serb. Që nga viti 1992 LPRK kishte shtrirë rrjetin e organizimit pothuajse në të gjitha trojet shqiptare nën Jugosllavi. Njësitë të këshillave të rretheve në Skënderaj, Drenas, Klinë, Ferizaj, Prishtinë, Besianë, Therandë, Prizren, Rahavec, Malishevë, Deçan, Gjakovë, Pejë, Gjilan, Kërçovë, Tetovë, Shkup e Kumanovë bëhen njësite të para të armatosura. Detyrë fillestare e këtyre njësiteve ishte përgatitja luftarake dhe sig-

urimi i armatimit. Këto njësite në fillim vepruan në kuadër të LPRK-së deri në zyrtarizimin dhe daljen publike të UÇK-së në nëntor 1994.

Një organizim i këtillë ushtarak ekzistonte më 1991-1992 edhe në rrethin e Therandës, ku ishte edhe baza ime e veprimeve ilegale. Më 1992 LPRK kishte në rrethin e Therandës së paku 22 këshilla popullorë me mbi 140 anëtarë dhe një shtrirje gati në të gjitha fshatrat. Në atë kohë çdo anëtar i LPRK-së konsiderohej edhe ushtar i gatshëm për luftë në çdo situatë. Takimet ishin të rregullta dhe me një disiplinë që karakterizonte gjithë veprimtarinë e Lëvizjes. Çdo anëtar i Lëvizjes në rrethin e Therandës kishte detyrat në rast mobilizimi dhe ishte i pajisur së paku me një armë të kalibrit të lehtë, që ishin siguruar më herët nga sektorët përkatës të Lëvizjes. Bazë e njësiteve konsiderohej çdo familje a shtëpi nga ishin anëtarët e këshillave në fshatra dhe në vetë qytezën e Therandës. Për armatosje tonë kishin ndihmuar shumë dy veteranët e Lëvizjes, Muharrem Dina, Sefedin Krasniqi dhe Haxhi Demiri etj. Ata sillnin vazhdimisht armatim nga Zvicra e Shqipëria për radhët e organizuara të Lëvizjes në vend. Gjatë viteve 1991- 1992 Këshilli i rrethit i LPRK-së në Therandë kishte organizuar disa stërvitje ushtarake për aftësim luftarak, siç ishte edhe ajo në fund të marsit 1992 në vendin Bungajë, mes fshatrave Arrishtë e Gurkuq. Plani i organizimit ishte që të gjithë anëtarët e këshillave të rrethit në Therandë të tuboheshin në orën 7 të mëngjesit në vendin e caktuar. Mirëpo, të njëjtën ditë dhe pothuajse në të njëjtën vend, ku ne planifikonim stërvitjen ushtarake, kishin dalë në ushtrime

edhe ushtarët jugosllavë të garnizonit të Prizrenit. Kjo na imponoi tërheqjen në pozicionin tjetër afër fshatit Gurkuq dhe reduktimin e stërvitjes vetëm në çështje teorike e përgatitje fizike.

LPRK i bënte këto stërvitje edhe si parapërgatitje për stërvitjet ushtarake, që ishin planifikuar në Shqipëri në vitet 1991-1992, por ishin ndërprerë për shkak të dekonspirimit nga Sigurimi i fshehtë i Serbisë. Për gjendjen e gatishmërisë luftarake të LPRK- së në rrethin e Therandës pata raportuar edhe në Mbledhjen e Kollares. Më 1992 më pati tërhequr vëmendjen një stërvitje ushtarake nga NATO-ja, e koduar me emrin "Syri i shqiponjës". Në atë kohë NATO-ja sprovonte gatishmërinë luftarake nga aeroplanmbajtëset në Adriatik dhe nga baza ajrore Aviano në Itali. Më pati bërë përshtypje krahasimi i avionëve me shqiponjën, për shkak të shkathtësisë së saj dhe syve shumë të mprehtë. Që atëherë më pati lindur ideja që edhe njësitet tona luftarake për çlirimin e Kosovës të quheshin *Syri i shqiponjës*.

Lëvizja në përgjithësi dhe në rrethin e Therandës ishte e përgatitur për luftë të armatosur që nga viti 1991. Atëherë Këshillin e rrethit e përbënin veprimtarët: Hysen Gega, Shefki Muça, Murat Bytyçi, Gani Balaj, Xhemajl Rudi, Halil Krasniqi, Skënder Basha, Sejdi Gega, Muharrem Elshani, Avdi Kadolli, Ibrahim Shala, Adem Kadolli, Nexhmedin Elshani, Abedin Balaj, Bafti Sopa etj.

Veprimet tona në atë kohë koordinoheshin edhe me veprimtarët tanë në Zvicër, Gafurr Elshanin e Shefit Bajraktarin. Në rrethin e Therandës nuk kishin pushuar asnjëherë përpjekjet për çlirim dhe bashkim kombëtar.

Nga Lumbardhi i Therandës ishte njëri ndër udhëheqësit e strategët kryesorë të Lëvizjes, heroi Fadil Vata dhe veprimtari e veterani Hysen Gega. Nga Gurkuqi ishte trimi Besim Ndreca, që kishte vrarë kriminelët serbë në Shirokë. Këto figura atdhetare u bënë frymëzim për liri gjatë Luftës së lavdishme të UÇK-së.

Komandantët e UÇK-së Maliq Ndreca, Sadik Halitjaha, Blerim Kuqi, Habib Elshani, Nezir Kryeziu e të tjerë u shquan me trimëri në luftërat çlirimtare në Kosovë, në Kosovën Lindore dhe në Maqedoni.

Gafurr Elshani nga Theranda, njëri nga drejtuesit e LPK- së, ideoi emblemën e UÇK- së, ndërsa grafikisht e realizoi, bashkë me Adnan Asllanin, në zyrën e organit të LPK- së, "Zëri i Kosovës" në Arau të Zvicrës, që e drejtonte atëherë Bislim Elshani nga Theranda.

Gjatë gjithë veprimtarisë sime ilegale, një strehë të rëndësishme në Prishtinë kam pasur edhe banesën e bacit Abdyl Kadolli, që na priste me gruan bujare Besa dhe djalin Dritëroi, veprimtar i Lëvizjes. Aty kemi bujtur me bashkëveprimtarët Gafurr Elshani, Hysen Gega, Behajdin Allaçi etj. Nga aty jam nisur për në mbledhje të rëndësishme të LPK-së dhe aty jam kthyer sërish.

Gjatë Luftës çlirimtare Theranda u dha një goditje të rëndë forcave pushtuese serbe.

Mjerisht, edhe në Therandë, si në tërë Kosovën, pati edhe mjaft tradhtarë e bashkëpunëtorë të pushtuesit serb. Mirëpo, siç thotë populli, nuk ka mal pa derra. Udbashët e sigurimit serb Sahit Zogaj nga fshati Zogaj (*Novosellë*) i Malishevës dhe Ilaz Vranoci nga Taraxha (*Tërrn*) e Therandës, bashkë me Milorad Nisheviçin-*Mishki*, nuk kishin lënë të zezë pa bërë kundër shqip-

tarëve dhe veprimtarëve të Lëvizjes në Therandë.

Arrestimet e gushtit '93

Sigurimi i fshehtë serb, me ndihmën edhe të bashkëpunëtorëve shqiptarë, më 1993 kishte rënë në gjurmë të organizimit tonë ilegal. Në fillim të gushtit 1993 Sigurimi serb kishte ndërmarrë një aksion të gjerë arrestimesh në tërë Kosovën, duke burgosur rreth 100 veprimtarë të Lëvizjes. Një numër i atyre që i shpëtoi arrestimit u detyrua të kalojë në ilegalitet të thellë ose të largohej për në Shqipëri, Zvicër e në vende të tjera perëndimore.

Në Prishtinë u arrestuan Ahmet Haxhiu, Xhavit Haziri, Shemsi Veseli, Nehat Selimi e Rexhep Avdiu, ndërsa në Besianë Hajredin Hyseni, Faik Ajeti e Ismet Mahmuti. Në Prizren e Rahavec u arrestuan Behajdin Allaçi e Binak Berisha, ndërsa në Therandë Hysen Gega, Ilaz Kadolli e Shefki Muça. Në Vushtrri u arrestuan Ramadan Pllana e Islam Maloku dhe në Ferizaj Bajrush Xhemajli e shumë të tjerë.

Kësaj vale arrestimesh i kishte paraprirë ditë më parë arrestimi i 4-5 veprimtarëve të LKÇK-së në Prishtinë e në Mitrovicë.

Me 1 gusht 1993 ishte arrestuar veprimtari Behajdin Allaçi nga Prizreni, ndërsa më 2 gusht 1993 u arrestuam njëkohësisht unë dhe Hysen Gega. Në të njëjtën ditë kishin ndodhur edhe arrestimet e bastisjet në Prishtinë dhe në qendrat e tjera të Kosovës.

Operacioni i arrestimit në Prizren e Therandë u bë nga udbashët kriminelë Ilaz Vranoci, Sahit Zogaj dhe Milorad Nisheviç- Mishki. Udbashi serb Vranoci

na kishte përcjellë dy muaj para arrestimit. Kështu kishte pohuar gjatë hetimeve në Sigurimin serb në Prizren, duke u krekosur para eprorëve të tij serbë se arrestimi nuk ishte i rastësishëm: *nuk kishte një thes me emra dhe të merrte rastësisht emrin tim, të Hysenit e Behajdinit!* - thoshe ai.

Ishim të vetëdijshëm se veprimtaria jonë ilegale në Lëvizje ishte edhe me shumë rreziqe, jo vetëm të arrestimit, torturimit e dënimit të rëndë, por kushtonte edhe me jetë e me pasoja familjare. Arrestimin dhe burgun e kemi pritur si diçka të mundshme në ato rrethana të pushtimit.

Menjëherë pas arrestimit më dërguan në stacionin policor në Therandë. Aty kuptova se ishte arrestuar edhe Hysen Gega, kur dëgjova policët serbë duke e urdhëruar të hiqte rripin e pantallonave dhe briskun, që Hyseni e mbante gjithherë me vete. Për briskun Hyseni tregonte shpeshherë me shaka një thënie gjermane: *një burrë që nuk mban së paku një brisk me vete, ai nuk është burrë!*

E kam përjetuar rëndë arrestimin e bashkëveprimtarit Hysen Gega, i cili u burgos për të dytën herë. Për të njëjtën veprimtari politike Hyseni kishte vuajtur më parë 10 vjet burg të rëndë në kazamatet serbosllave.

Arrestimi i Hysenit ishte bërë pikërisht në ditën e dasmës së djalit të tij, që Hyseni e kishte pritur me gëzim pas shumë vuajtjeve nëpër burgje. Ishte shumë burrëror qëndrimi i bacit Hysen gjatë arrestimit. Me duar të lidhura në oboorrin e shtëpisë iu tha dasmorëve të vazhdonin dasmën. Porosia e tij kishte edhe simbolikën e vazhdimit të Lëvizjes, pavarësisht

rrethanave, për inat të armiqve, siç thoshte shpesh baci Hysen, një burrë trim e bujar.

Një kohë të shkurtër na mbajtën në stacionin policor në Therandë dhe pastaj na nisën veç e veç në drejtim të Prizrenit. Më lidhën me pranga në duar e këmbë dhe më vendosën në ulëset e prapme të makinës, që e ngiste me gëzim udbashi Ilaz Vranoci, i shoqëruar nga kryepolici Milorad Nisheviç, i njohur me nofkën *Mishki*. Të gezuar për suksesin në arrestimin tonë, që të dytë filluan të fishkëllonin një melodi të një kënge serbe. Në atë gjendje që isha, pak nga inati e pak nga sikleti, s'di si me shkrepi kënga e Hajredin Pashës, që fillova ta këndoja.

Kjo iu dogji fort Mishkit e Vranocit dhe ma ndërprenë këngën, duke thënë:

Edhe po të këndohet? A e di se çka të pret brenda!

Mua më vendosën në një dhomë në katin e tretë të hetuesisë, në anën e majtë në fund të korridorit, ndërsa bacin Hysen në të njëjtin kat, por në anën e kundërt të ndërtesës.

Torturat mizore

Porsa na mbyllën në lokalet e hetuesisë në Prizren, rreth orës 12 të 2 gushtit 1993 Mishki e Vranoci filluan torturat psikike e fizike ndaj meje, në fillim duke më urdhëruar t'i shtrija duart përpara. Unë nuk pranova, ndërsa ata urdhëruan dy policë të tjerë në rroba civile të m'i lidhin këmbë e duar dhe të më shtrijnë përtokë. Kështu e kishin më lehtë të më goditnin në të gjitha pjesët e trupit, duke kërkuar nga unë të tregoja për Lëvizjen Popullore të Kosovës, për shokët dhe armët.

Pasi u lodhën me goditje dhe nuk arritën qëllimin, më thanë se tash do të vijnë disa policë specialë nga Peja, që do ta tregojnë qejfin, pasi ti nuk po marrke vesh me kaq. Pas disa orësh erdhën ata dy kriminelë serbë nga rrethina e Pejës. Kryesori quhej Dragan Milosheviç, ndërsa ndihmës i tij ishte një bishë tjetër, i ashtuquajtur *Medved*. Ata u shfrynë mbi trupin tim katër ditë e katër net pandërprerë deri në alivanosje. Nuk më dhanë asnjë pikë ujë, edhe pse isha bërë shkrumb nga etja e dajaku. Kriminelët serbë më zhveshën edhe lakuriq. Nuk kishte pjesë të trupit që nuk ishte nxirë nga goditjet, madje edhe në organet gjenitale. Gjersa isha i shtrirë në dysheme, mbi mua qëndronte ariu serb Medved. Derisa të tjerët goditnin me shqelma e kërbaç, ai më shkelte me çizmet e tij të rënda në shpinë për të mos lëvizur, duke ditur pasojat për organet, sidomos veshkat.

Në të njëjtën kohë torturohej edhe baci Hysen, të cilit i dëgjohej qartë britma, edhe pse ishte në fund të korridorit.

Ne nuk dinim fare se një ditë para nesh ishte arrestuar edhe Behajdin Allaçi, i cili ndodhej në të njëjtin kat dhe në të njëjtin objekt të Sigurimit serb. Për arrestimin e Behajdinit mësova pas 3- 4 ditësh, kur kriminelët serbë më tërhoqën zvarrë korridorit për të më ballafaquar me të në një dhomë tjetër të hetuesisë. Në fillim nuk e njoha fare Behajdinin, ngase ishte ënjtur e dërrmuar aq shumë nga torturat. Dikur e njoha vetëm nga flokët, por ishte pa syze, që i mbante vazhdimisht para se të burgosej.

Në një moment, derisa kriminelët serbë pushonin ose hanin diçka për të fituar energji dhe për të vazh-

duar turturat, papritmas në dhomën ku mbahesha i lidhur u duk një person që më foli shqip: *O Kadoll, mos u mundo kot se i dinë të gjitha!* Ai përmendi si me përbuzje emrin e një Raifi nga Mitrovica, i cili paska dhënë shumë informacione për Lëvizjen, mbi 100 emra të veprimtarëve. Edhe ai tregoi atë ditë, më 4 gusht 1993, se edhe Behajdini e shtëpia e tij në Prizren ishin vëzhguar gjatë dy muajve nga Sigurimi serb. Të gjitha këto që i tha ai person, i mora me rezervë, për shkak të detyrës që kryente. Unë vetëm e shikova me kujdes për të mos ia harruar fytyrën dhe nuk ndërrova asnjë fjalë me të. Më vonë mësova se ai person quhej Astrit Koshi dhe punonte në Sigurimin serb.

Të gjitha ato që m'i kishte thënë Astrit Koshi në gusht 1993 në Sigurimin serb në Prizren, i vërtetova pas përfundimit të luftës. Në fund të qershorit 1999, kur isha me detyrë në TMK, e kërkova dhe e gjeta Astritin në Prizren. Thirra në telefonin e tij, që e sigurova nga ushtarët e Zonës II. Në fillim u paraqit bashkëshortja e tij, e cila tha se Astriti nuk gjendej në shtëpi. Pasi e sigurova se dua të pi vetëm një kafe me të, duke i treguar edhe kush isha, vetëm atëherë u paraqit Astriti, i cili pranoi të dilte në një kafene.

Kur e pyeta se a di përse të kam thirrur, ai u përgjigj se e merrte me mend, sigurisht për burgosjet më 1993. Ai përsëriti pikë për pikë të njëjtat fjalë që m'i kishte thënë në gusht 1993. Isha i interesuar të dija më shumë për veprimtarin dhe shokun tim të Lëvizjes Behajdin Allaçi. Astriti më tha:

Të garantoj me kokë dhe me familje se Behajdini asnjëherë dhe në asnjë kohë nuk ka qenë në shërbim

të sigurimit serb. Përkundrazi, është konsideruar si nacionalist, si njëri nga udhëheqësit kryesorë të LPK-së dhe kundërshtar i shtetit serb.

Behajdin Allaçi është arrestuar nga UÇK-ja në Drenaj (*Drenoc*) të Rahavecit në qershor 1998, kur kishte dalë në luftë. Që nga ajo kohë nuk dihet asgjë për fatin e tij. Dyshohet se është likuiduar në rrethana të pasqaruara dhe nuk i dihet as varri.

Të burgosurit politikë shqiptarë asnjëherë nuk kanë përshkruar të gjitha torturat e tmerret nëpër burgjet serbosllave. Ndiej një obligim moral të rrëfej për vrasjen në burg të një shqiptari nga fshati Vlashnje i Prizrenit, më 4 gusht 1993. Sigurimi i fshehtë serb e kishte sjellë atë ditë në lokalet e hetuesisë në Prizren. Policët serbë Qerim Buzhala, Milorad Nisheviç dhe Ilaz Vranoci filluan torturat ndaj tij që nga mëngjesi. Ndërkohë kuptova se ai ishte shofer kamioni dhe atij i kërkonin armë. Torturat ndaj tij zgjatën nga mëngjesi deri në mbrëmje. Dikur natën britmat e gjëmat filluan të rralloheshin, sa mezi dëgjoheshin. Të nesërmen, më 5 gusht 1993, hetuesit famëkeqij serbë njoftuan për vrasjen e tij, duke e paraqitur si vetëvrasje ose vdekje të natyrshme! Ai person nga Vlashnja qe mbytur në torturat mizore pikërisht nga kriminelët, Milorad Nisheviç dhe Ilaz Vranoci. Dëshmitarë të kësaj vrasjeje ishin edhe të burgosurit e tjerë në hetuesi, si vëllai im Vesel Kadolli, Behajdin Allaçi etj. Në torturë policore më 1989 qe mbytur edhe bashkëveprimtari ynë dhe njëri nga udhëheqësit e LPK-së në Prizren, Xhemajli Berisha. Edhe mbytja e tij ishte shpallur vetëvrasje, kinse kishte kërcyer nga kati i tretë i ndërtesës së Sigurimit serb në Prizren!

Xhemajli Berisha ishte në udhëheqjen e ngushtë të LPK- së në Prizren. Shtëpia e tij në lagjen Arbana ishte ndër bazat e Lëvizjes, ku shpeshherë mbanim takime. Ai ishte profesor në një shkollë të mesme të Prizrenit. Tani emrin e tij e mban me krenari Pallati i kulturës në Prizren.

Mjerisht, këto raste të mbytjes në torturë dhe plot të tjera nuk janë hetuar ende nga drejtësia e Republikës së Kosovës.

Këtë fat kanë pësuar edhe mijëra të rinj e të reja, që janë torturuar mizorisht, madje edhe likuiduar nëpër burgjet jugosllave.

Rrëfimet e mia janë vetëm një pjesë e vogël e tmerreve që kanë përjetuar të burgosurit politikë.

Serbia që nga viti 1876 ka bërë gjenocid shekullor ndaj shqiptarëve, duke dhunur, masakruar e dëbuar shqiptarët nga vatrat e tyre etnike.

Sot duhet të ndriçohen të gjitha krimet e gjenocidit serb në Kosovë dhe flijimet e mëdha shqiptare për çlirim e bashkim kombëtar, për t'iu treguar brezave të ardhshëm se liria dhe pavarësia e Kosovës nuk kishin pikur nga qielli, as nga lutjet politike.

Lëvizja Popullore e Kosovës ishte historike, me karakter të mirëfilltë kombëtar e çlirimtar.

Edhe gjatë kohës se vuajtjes së dënimit, përmes familjes, shokëve dhe lidhjeve, mbaja kontakte me jashtë dhe isha në rrjedhë të ngjarjeve e përgatitjeve për fillimin e luftës në Kosovë. Brenga jonë e vetme në ato kohë të viteve 1993-1995 ishte se ishim të ngujuar dhe peng. Ishim të vetëdijshëm që serbët edhe si të burgosur do të na vrisnin si qengjat. Kishim merak të ishim në fushëbetejë për t'u përballur me

pushtuesin barbar serb. Mezi prita të dal nga burgu për të vënë menjëherë kontakt me pjesëtarë të UÇK-së dhe me shokët e Lëvizjes për të vazhduar luftën dhe betimin e dhënë qysh herët bashkëveprimtarëve Nuhi Berisha, Rexhep Mala, Afrim Zhitia, Fadil Vata dhe shumë veprimtarëve të ilegales, që ishin betuar se vetëm me luftë do të çlirohej vendi.

USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS

Themelimi i UÇK-së

Nuk ka asnjë dyshim se Lëvizja Popullore e Kosovës është themeluese e vetme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Lufta çlirimtare e UÇK-së nuk ndodhi rastësisht. Lëvizja Popullore e Kosovës ishte organizatë politike e ushtarake, që kishte program të qartë për çlirimin e vendit. Ishte lëvizja e parë serioze, që veproi me ngulm për shkëputjen e Kosovës nga krijesa artificiale e quajtur Jugosllavi. Për këtë qëllim LPK kishte përdorur të gjitha format paqësore të rezistencës. Vetëm atëherë kur ishin shterur këto forma, Lëvizja kalon në veprime konkrete të formimit të mekanizmit luftarak- Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Themelimit të UÇK- së i ka paraprirë një veprimtari e vazhdueshme, këmbëngulëse dhe me shumë sakrifica për një kohë të gjatë, sidomos që nga vitet 1981-1982 deri në fillimin e luftës së armatosur 1997-1999.

Mbledhjet kryesore të Lëvizjes që i kanë paraprirë themelimit të UÇK-së:

Mbledhja I e përgjithshme e LPK-së në Cyrih të Zvicrës, korrik 1987; Mbledhja II e përgjithshme në Baden të Zvicrës, tetor 1989; Mbledhja III e përgjithshme në Ujëmir të Klinës, tetor 1991; Mbledhja konsultuese në Kollare të Kërçovës, prill 1993; Mbledhja IV e përgjithshme në Prishtinë, korrik 1993, si dhe Mbledhja e Kryesisë së LPK- së, që

vendosi për emrin dhe emblemën e UÇK-së në Arau të Zvicrës, më 17 nëntor 1994. Në arkivat e Lëvizjes gjenden të gjitha procesverbalet, dokumentet, vendimet dhe pjesëmarrësit. [1]

Çlirimi i vendit dhe bashkimi i kombit ishin objektiva të përhershme programore të Lëvizjes që nga themelimi i saj.

Pjesë nga programi i LPK-së:

"Duke u nisur nga e drejta e ligjshme e çdo popullit për liri, pavarësi e vetëvendosje, është e drejte e pamohueshme dhe domosdoshmëri që edhe populli shqiptar të luftojë me të gjitha mjetet dhe format për çlirim, konform normave ndërkombëtare.

I. Populli shqiptar ka energji të pashtershme për të arritur mobilizim, unitet dhe besim në forcat e veta, që përfundimisht çojnë drejt çlirimit.

Çlirimi i pjesës së robëruar të popullit shqiptar përkrahet nga i gjithë kombi.

Egërsia në rritje e pushtimit dhe dështimi i përpjekjeve për zgjidhje paqësore të çështjes sonë kombëtare po e ndërgjegjësojnë popullin se rruga e vetme është lufta çlirimtare.

Shqiptarët duhet të jenë të barabartë me kombet e tjera, sepse nuk janë minoritet, as në përqasje kombëtare, as ndërkombëtare, por komb i ndarë.

Pjesa e robëruar e popullit shqiptar i ka të gjitha karakteristikat që e përbëjnë një popull e një komb: është popull tremilionësh që ka historinë dhe gjuhën e vet, territorin kompakt, lidhjet ekonomike, formimin psikik dhe kulturën e tij.

Populli shqiptar duhet të orientohet drejt çlirimit të

1. Nga historiku i LPK-së.

Kosovës dhe formimit të shtetit të pavarur, që do të përfshijë të gjitha trojet nën okupim, ku shqiptarët janë shumicë.

Çlirimi dhe formimi i shtetit të pavarur të Kosovës krijon kushte që populli ynë të barazohet me popujt e tjerë të hapësirës ballkanike. Vetëm atëherë ka mundësi të ndërtohet sistemi pluralist, të vendoset ekonomia e tregut, liritë e plota kombëtare, njerëzore dhe demokratike.

Modelet koniunkturale për zgjidhjen e çështjes shqiptare nën sovranitetin e shteteve të tjera janë të padrejta dhe jolegjitime, sepse bëjnë ricopëtimin e trojeve etnike shqiptare dhe rrezikojnë identitetin etnokulturor të popullit tonë.

Çlirimi dhe formimi i shtetit të pavarur të Kosovës nuk u sjell asnjë të keqe popujve të Ballkanit. Përkundrazi, ai do të jetë shembull i mirëqenies, bashkëpunimit dhe barazisë mes kombeve.

Çlirimi dhe formimi i shtetit të pavarur të Kosovës, si vullnet i popullit shqiptar, është në përputhje të plotë me normat ndërkombëtare. E drejta e vetëvendosjes është e drejtë kombëtare e universale dhe parim themelor i Kartës së OKB-së, të Helsinkit e të Parisit.

Populli ynë nuk do të pranojë asnjë zgjidhje ndërkombëtare, që do të ishte në kundërshtim me vullnetin e tij dhe me të drejtën e tij për vetëvendosje. Pa zgjidhjen e drejtë të çështjes së popullit shqiptar nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme në Ballkan e më gjerë.

II. LPK është organizatë nacionalçlirimtare e pjesës se robëruar të kombit shqiptar nën Serbi, Maqedoni

e Mal të Zi, që ka për qëllim:

Çlirimin dhe formimin e shtetit të pavarur të Kosovës mbi bazë të parimit të vetëvendosjes.

Ndërtimin e shoqërisë së re, të lirë e demokratike në përputhje me vullnetin e popullit.

Pas çlirimit LPK do të angazhohet për zbatimin e dispozitave kushtetuese, ligjore e juridike të shtetit dhe do të shqyrtojë pozicionin e saj në raport me jetën politike të vendit.

III. Për arritjen e aspiratave kombëtare, LPK do të përdorë të gjitha format e luftës çlirimtare: demokratike, paqësore e politike, si dhe të rezistencës së armatosur.

LPK i kombinon format ilegale e legale të veprimit në përputhje me rrethanat e situatën që krijohet.

LPK është për formë popullore të luftës, ndërsa është kundër formave fashiste, raciste, anarkiste e terroriste të veprimit, por edhe kundër atyre ekskluzivisht pacifiste e kapitulluese.

Me Kosovën nënkuptohen të gjitha viset e banuara me shumicë shqiptare nën Serbi, Maqedoni e Mal të Zi.[2]

Krahu ushtarak i LPK-së qysh në vitin 1991 në Mbledhjen III të përgjithshme në Ujëmir kishte analizuar situatën politike e të sigurisë dhe kishte marrë vendim për themelimin e një force ushtarake, që do të ishte në gjendje të zhvillonte luftën çlirimtare kundër pushtimit serb.

Njësitet ushtarake të LPK-së u ndeshën disa herë

---

2. "Zëri i Kosovës" nr. 15, më 15. 9. 1993; Gafurr Elshani, *Mbledhja IV e përgjithshme e Lëvizjes Popullore të Kosovës, dokumente dhe artikuj,* **f. 24 e 25.**

me forcat armike serbe. Është e njohur përballja e Komandantit legjendar të UÇK-së dhe e familjes së tij me forcat serbe që nga viti 1991 deri në rënien heroike në mars 1998. Njësitet luftarake të LPK-së në Drenicë me Adem Jasharin në krye, në Llap me Zahir Pajazitin, në Dukagjin me Ardian Krasniqin e Edmond Hoxhën etj., kishin kryer disa aksione të suksesshme kundër forcave pushtuese serbe. Të gjitha aksionet ushtarake kundër ushtrisë e policisë serbe në vitet 1995-1997 e më vonë u kryen me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, që në atë kohë drejtohej nga LPK-ja.

Pikërisht ato njësite kishin kërkuar nga Kryesia e Lëvizjes të merrte përsipër sulmet dhe të bënte emërtimin e formacionit ushtarak.

Kryesia e LPK- së, në përbërje Emrush Xhemajli, Gafurr Elshani, Ali Ahmeti, Xhavit Haliti e Fazli Veliu, më 17 nëntor 1994 vendos që formacionet luftarake të LPK- së të emërtohen Ushtria Çlirimtare e Kosovës(UÇK) dhe ajo të marrë përgjegjësinë për të gjitha sulmet kundër forcave policore- ushtarake serbe në Kosovë. Gjithashtu, Kryesia e LPK- së vendosi edhe për emblemën e UÇK- së, që e bartën me krenari dëshmorët dhe ushtarët e saj gjatë Luftës çlirimtare në Kosovë. Komunikata e parë e UÇK- së u dha të njëjten ditë, më 17 nëntor 1994 në Arau të Zvicrës. Komunikata mbante numrin 11 dhe për shkaqe taktike u dërgua në mjetet e informimit në Shkup nga Abdylmexhid Karaga (Xhida), një veprimtar i dalluar i Lëvizjes.

Këtu po japim të plotë një nga komunikatat e para të UÇK-së, që në atë kohë janë dhënë nga Kryesia e LPK-së.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)
***Komunikatë nr.13,** qershor 1995*

Gjatë dy muajve të fundit Komanda Qendrore urdhëroi njësitet e armatosura për veprime ushtarake, të cilat u zbatuan sipas planit.

Në muajin prill u sulmua postëkomanda e policisë serbe e vendosur në fshatin Irzniq.

Në fillim të majit u minuan dy shtëpi të sapondërtuara për vendosjen e kolonëve serbë e malazez. Shpërthimet e eksplozivit në Junik janë vërejtje për ata kolonë që pranojnë të bëhen mish për top në duart e politikës së pastrimit etnik të Beogradit.

Në javën e fundit të majit u ekzekutua me vdekje spiuni i Serbisë Bexhet Muçaku.

Thirret popullata civile serbe e malazeze që të mendojë për ardhmërinë e tyre në Kosovë dhe të mos marrë pjesë në terrorin e trupave okupuese ushtarake e policore kundër shqiptarëve!

Komanda jonë qendrore do të urdhërojë njësitet tona të armatosura për sulme të tjera.

Sulmet tona do të vazhdojnë deri në çlirimin e plotë të vendit.[3]

Siç shihet edhe nga kjo komunikatë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës në fazën e parë të themelimit ka vepruar në njësite të vogla dhe në ilegalitet të thellë, ndërsa veprimet e saj kanë qenë shumë efikase.

Me këto fakte dëshmohet se lufta e forcave çlirimtare kundër forcave pushtuese serbe ka filluar shumë më herët se lufta e hapur më 1997-1999.

LPK- ja krijoi edhe logjistikën e strukturat e UÇK-së, duke formuar edhe fondin "Vendlindja thërret"

---

3. Gafurr Elshani, *Dokumente dhe artikuj*, **f. 32.**

të UÇK- së, kryesisht nga mjetet e grumbulluara të mërgimtarëve shqiptarë në Perëndim dhe në vende të tjera të botës, si dhe në Kosovë, Maqedoni e Shqipëri.

Përballja e parë dhe lufta e hapur me serbët ndodhi më 27 e 28 nëntor 1997, kur në Drenicë, në varrimin e mësuesit Geci, UÇK- ja doli publikisht para masës së qytetarëve.

Pa dyshim, krijimit të UÇK- së i kanë paraprirë veprimtaria dhe sakrificat e veteranëve dëshmorë të kombit që nga vëllezërit Jusuf e Bardhosh Gërvalla, Kadri Zeka, Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Fadil Vata, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Bajram Bahtiri dhe shumë dëshmorëve të tjerë të Lëvizjes në të gjitha trojet shqiptare.

Në luftën e UÇK- së u rreshtua pjesa më e ndërgjegjshme e kombit tonë, pa dallime ideologjike, politike e fetare. Lufta e drejtë e UÇK- së fitoi edhe përkrahjen e opinionit demokratik ndërkombëtar dhe të Aleancës më të fuqishme ushtarake në botë. Më 24 mars 1999 NATO- ja kaloi në mbrojtje të drejtpërdrejtë ushtarake të Kosovës, duke bombarduar 78 ditë rresht bazat ushtarako- policore serbe në Kosovë e Serbi.

Lufta çlirimtare ishte kurorëzim i të gjitha përpjekjeve rreth një çerek shekulli të popullit të Kosovës të udhëhequr nga LPK-ja.

Në themelin e lirisë së Republikës së Kosovës qëndron gjaku i derdhur i 2400 dëshmorëve të kombit dhe i mbi 13.000 civilëve martirë shqiptarë, që ranë gjatë Luftës çlirimtare në Kosovë.

Gazeta "Zëri i Kosovës"

"Zëri i Kosovës", organ i Lëvizjes që botohej në Zvicër, edhe në fillimet e konfrontimit të armatosur mes forcave çlirimtare dhe forcave pushtuese serbe, ishte burim i vetëm i informimit të drejtë të faktorit ndërkombëtar dhe opinionit vendor për luftën e drejtë dhe të pastër të UÇK-së. Në krye të këtij organi, që nga themelimi i tij prej Jusuf Gërvallës, u ndodhën figura të çmuara të LPK-së, si Mustafë Xhemajli, Avni Dehari, Beqir Beqa, Bislim Elshani, Adnan Asllani, Xhafer Durmishi e Xhafer Shatri. Bashkëpunëtorë të saj brenda vendit, si Nuhi Paçarizi e Besim Zymberi, rrezikuan edhe jetët e tyre nëpër torturat mizore të organeve të pushtuesit.

Ishin faqet e saj që ftonin bashkatdhetarët për t'iu bashkuar luftës për liri të UÇK-së. Aty botoheshin komunikatat e UÇK-së, siç ishte edhe kjo me rastin e rënies së tre dëshmorëve të UÇK-së:

Komunikatë nr. 30

Qëndresa heroike e tre luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Më 31 janar 1997, në orët e vona të pasdites, tre pjesëtarë të njësiteve tona ushtarake: Hakif Zejnullahu, Zahir Pajaziti dhe Edmond Hoxha, rrugës për në detyrë të karakterit të veçantë, u ndeshën ballë për ballë me forca të shumta të policisë okupatore serbe. Pas një qëndrese heroike, në një betejë të pabarabartë, dhanë jetën për çlirimin e vendit.

Gjaku i tyre i njomë edhe më tepër do të forcojë

unitetin dhe vendosmërinë tonë për të luftuar edhe më me ngulm deri në fitoren e plotë. Dhembja për ta është e madhe, por ajo nuk do të na dëshpërojë, përkundrazi do të na japë forcë në rrugën e mundimshme, por të sigurt drejt lirisë.

Popullit tonë i bëjmë thirrje që në këto çaste vendimtare të mos bëhet pre e propagandës së turpshme të qarqeve të caktuara, të cilat me veprimtarinë e tyre po ndihmojnë mbajtjen nën pushtim të Kosovës, por t'i bashkohet luftës sonë përmes angazhimit të drejtpërdrejtë në radhët tona dhe duke ndihmuar atë me të gjitha mjetet.

Familjeve të tre të rënëve, përmes ngushëllimeve tona, duke ndarë dhembjen me ta, u zotohemi se hakun e tyre do ta marrim shumëfish.

Lavdi jetës dhe veprës se tyre!

Shtabi Qendror i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Prishtinë, më 3. 2. 1997.[4]

Ndër të tjera, në faqet e "Zërit të Kosovës" botohet edhe thirrja e LPK- së drejtuar masave për mobilizim dhe luftë kundër pushtuesit.

Thirrje

drejtuar të gjithë shqiptarëve të gatshëm për sakrifica për çlirimin e vendit.

Lëvizja Popullore e Kosovës mbështet veprimet e armatosura të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër trupave pushtuese serbe, të cilat u intensifikuan kohëve të fundit nëpër fshatrat e Drenicës, Dukag-

4. **Gafurr Elshani** , *Dokumente dhe artikuj*, **f. 127; "Zëri i Kosovës", nr. 5, më 6.2.1997.**

jinit dhe në vise të tjera shqiptare. Lufta e popullit tonë është rrjedhojë dhe kundërveprim i imponuar nga shtypja e egër e okupatorit. Andaj iu bëjmë thirrje gjithë shqiptarëve të gatshëm për sakrifica që së bashku:

Ta ndihmojmë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ta ndihmojmë me njerëz, me çdo mjet dhe në çdo mënyrë. Të presim dhe të përcjellim njësitet e saja, t'u japim informacion, ndihmë mjekësore, bukë, veshmbathje dhe mjete transporti.

Të kuptohet drejt shkalla fillestare e luftës së armatosur. Çdo popull që luftoi dhe fitoi, kaloi nëpër këtë fazë të ashpër dhe të përgjakshme.

Ta ndihmojmë popullatën për ta përballuar terrorin armik. Më mirë të vuajmë deri në çlirimin e vendit sesa të vuajmë pa kufij.

Të injorohen frikacakët, që po përhapin panik e konfuzion në popull.

Lufta e popullit tonë për çlirim është e drejtë dhe do të ngadhënjejë.

Poshtë okupatorët dhe shërbëtorët e tyre!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Ushtria Çlirimtare e Kosovës!

Lavdi të rënëve për liri!

Lëvizja Popullore e Kosovës.[5]

Kushtrimi i lirisë

Luftërat në Kroaci e në Bosnjë-Hercegovinë më 1991-1995 ishin një përvojë dhe alarm se Serbia do të zbatonte skenarin e njëjtë edhe në Kosovë.

5. "Zëri i Kosovës" nr. 44, më 4. 12. 1997.

Në luftërat në Kroaci e Bosnjë serbët nuk respektuan asnjë normë ndërkombëtare të ligjeve të luftës. Në kundërshtim me të gjitha konventat ndërkombëtare të luftës, ushtria e policia serbe bënë gjenocid të tmerrshëm mbi popullsinë civile. Krimet më të mëdhe serbët i bënë pikërisht aty ku organizimi ushtarak ishte më i dobët. Ata vranë e masakruan në Bosnjë mbi 100.000 civilë të pafajshëm dhe bënë spastrimin etnik të gjysmës së saj. E kundërta ndodhi në Slloveni e Kroaci, ku serbët hasën në rezistencë të organizuar dhe u larguan me bisht nën shalë.

Serbia kishte pandehur se me sulmin tinëzar mbi familjen Jashari dhe bazën kryesore të UÇK-së në Prekaz, më 5-7 mars 1998, do të shuante përgjithmonë Lëvizjen dhe do ta zhbënte qëndresën në Kosovë. Mirëpo, qëndresa heroike e kësaj familjeje të njohur për trimëri e tradita liridashëse, me burrat Shaban, Hamëz e Adem Jashari dhe Prekazin historik, ngriti në këmbë gjithë forcat liridashëse shqiptare. Rënia heroike e Komandantit legjendar dhe flijimi i gati tërë familjes Jashari u bë kushtrim për luftë të hapur çlirimtare. Në radhët e UÇK- së u rreshtuan djemtë dhe vajzat më të mira të Kosovës dhe të Shqipërisë.

Kur serbët sulmuan familjen Jashari, menjëherë vumë kontakt me Lëvizjen në Zvicër, Gafurr Elshanin dhe Emrush Xhemajlin, për t'u takuar në Tiranë lidhur me furnizimin me armatim dhe mobilizim për luftë të përgjithshme.

Më 11 mars 1998, bashkë me veprimtarin Habib Elshani u nisëm për në Shqipëri. Me ndihmën e Tanit nga Morina (*Korabi*), një veprimtar i Lëvizjes nga

familja Demiri, lëvizëm në drejtim të Gjakovës për në fshatin Morinë. Aty u takuam me ushtarët e UÇK-së nga Morina e Gjakovës, qëndruam deri rreth orës dy pas mesnatës për të vazhduar në drejtim të kufirit dhe qytetit Bajramcurr.

Në Tiranë u takuam me Emrush Xhemajlin, Habib Elshanin dhe disa ushtarë të tjerë, me të cilët bëmë dy javë ushtrime ushtarake në bazën e Zall-Herrit. Skënder Çeku na ushtronte në një poligon pranë Durrësit, ndërsa në Zall-Herr oficerët e tjerë shqiptarë.

Stërvitjet në Shqipëri bëheshin edhe në vende të tjera dhe me ndihmën e ekspertëve ushtarakë të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë gushtit 1998, Skënder Çeku qe plagosur rëndë në luftimet me bandat serbe në rajonin e Dukagjinit dhe qe dërguar në spitalin ushtarak të Breshancit të Therandës. Derisa ishim në një detyrë ushtarake në Budakovë, na njoftuan se Skënder Çeku kërkonte të na takonte mua dhe Gafurrin. Edhe pse shkuam shpejt atje, nuk arritëm ta gjejmë gjallë Skënderin, sepse kishte ndërruar jetë nga plagët e rënda. Megjithatë, arritëm t'i bëjmë nderimet e fundit ushtarake, kur bashkë me disa dëshmorë të tjerë u varros përkohësisht në një kodër pranë Semetishtit të Therandës. Skënderit ia vumë te koka një shishe qelqi me shënimet personale, sepse luftës nuk i dihej.

Pas dy javë qëndrimi në Shqipëri, në prill 1998 hymë natën përmes Morinës në Kosovë. Kolonës prej mbi 20 ushtarëve i printe komandant Tigri. Ishim të ngarkuar me shumë armë e municion, sa që përballuam vështirë rrugën e gjatë nga Bajramcurri deri në Morinë. Në fshatin Shqiponjë na pritën ushtarët e

parë të Dukagjinit: *Magjupi, Toni, Mala* dhe Rexhep Selimi. Me Rexhep Selimin udhëtuam unë, Habibi dhe Qamil Suka në drejtim të Altarit. Në mesin e ushtarëve në Altar takuam Ismet Jasharin- Komandant Kumanovën, i cili porsa ishte kthyer nga një aksion kundër forcave serbe pranë Duhlës. Ai ishte i plagosur në këmbë dhe qëndronte në paterica. Me Kumanovën e Fatmir Limën u morëm vesh, që unë, Habibi dhe Qamili të kalonim në zonën e Therandës, për të bërë mobilizimin e ushtarëve dhe zgjerimin e frontit të luftës.

Brigada 123

Bazë e parë e UÇK- së në rrethin e Therandës u bë fshati Ilirion (*Dobërdolan*), përkatësisht shtëpia e Mehmet Balës, e cila tërësisht u vu në shërbim të luftës. Habib Elshani u caktua komandant i njësitit "Çeliku 50".

Ndërkohë në këtët fshat vendoset edhe një njësit tjetër i UÇK-së, i quajtur "Lisi", që udhëhiqej nga Blerim Kuqi. Një kohë këto dy njësite vepruan në gjysmilegalitet, kryesisht në mobilizimin e ushtarëve dhe përgatitjen e pikave strategjike të luftimeve.

Dalja e parë publike e UÇK-së në rrethin e Therandës ndodhi më 3 qershori 1998 në Shtëpinë e kulturës të fshatit Ilirion. Aty ishin të pranishëm përfaqësues dhe komandantë të UÇK- së, që vepronin prej kohësh në këtë fshat. Banorëve të fshatit iu bënë të njohura veprimet tona luftarake dhe vendosmëria e UÇK-së për luftë të përgjithshme kundër pushtuesit serb.

Po atë ditë u vunë edhe pozicionet e para të UÇK-së në trekëndëshin e rrugës Therandë- Ilirion- Rahavec. Pozicionimi në këtë pikë kishte për qëllim të bllokonte qarkullimin e forcave serbe mes Therandës e Rahavecit. Atë ditë të 3 qershorit, së bashku me dëshmorin Reshat Muça nga Arrishta, bëmë rojën e parë në atë pikë derisa ushtarët hapnin istikamet. U vendosëm mu në trekëndëshin e rrugës Therandë- Ilirion- Rahavec dhe u morëm vesh të goditej çdokush që lëvizte në uniformë të policisë e ushtrisë serbe, ndërsa automjetet me civilë vetëm të legjitimoheshin.

Pesë ditë më vonë, më 8 qershor 1998, vija e frontit u zgjerua deri tek ura e fshatit Rreshtan, një pikë strategjike që lidhte e siguronte fshatrat nga ana e Semetishtit dhe fshatit Gurrë (*Studençan*).

Njësitet e para të UÇK- së në rrethin e Therandës, në një takim të qershorit 1998 në fshatin Gurrë, bashkohen dhe formojnë Brigadën 123. Sipas marrëveshjes së përbashkët, këto dy njësite zgjedhin edhe komandën e parë të Brigadës 123 në këtë përbërje:

Blerim Kuqi, komandant brigade; Habib Elshani, zëvendëskomandant brigade; Agim Kuqi, shef i operatives; Ilaz Kadolli, zv/komandant për moral e politikë; Ruzhdi Gashi, zv/komandant për logjistikë dhe Isuf Krasniqi, zv/komandant për ZKZ. Në themelimin e Brigadës 123 ishin të pranishëm edhe Gafurr Elshani e Bislim Zyrapi.

Ndër themeluesit e UÇK-së dhe të Brigadës 123:
Ilaz Kadolli dhe Gafurr Elshani.

Në fillim të takimit Gafurr Elshani u propozua për komandant të brigadës, mirëpo një detyrë të tillë ai nuk e pranoi, me arsyetim se një kohë të gjatë kishte jetuar jashtë dhe nuk i njihte sa duhet rrethanat e reja. Ai vetë propozoi që këtë detyrë mund ta kryente më mirë Blerimi Kuqi.

Themelimi i brigadës ishte organizimi i parë profesional i UÇK-së në rrethin e Therandës, që pati ndikim të madh në mobilizimin e zgjerimin e radhëve të UÇK- së në këtë komunë. Në këtë drejtim ndikim të mirë pati edhe hyrja në radhët e UÇK- së e Ukë Bytyçit, i cili bëri thirrje publike për përkrahje të luftës kundër pushtuesit serb, edhe pse kryesia e

partisë së tij me kryetarin Rugova ishte kundër luftës fillim e mbarim.

Në kuadër të Brigadës 123 u formuan edhe dy batalione. Batalioni I udhëhiqej nga Bali Muharremaj, ndërsa Batalioni II në Budakovë nga Sadik Halitjaha.

Brigada një kohë vëzhgoi pozicionet armike dhe mblodhi informacione për vendqëndrimet e forcave serbe në rrethin e Therandës.

Së bashku me Gafurr Elshanin dhe Daut Iljazin (*Shpati*) nga Gjilani, inspektuam vijat e frontit që mbulonte Brigada 123. Qëllimi ishte të shihej e testohej nga afër gatishmëria, organizimi dhe morali luftarak i ushtarëve të UÇK-së, që vepronin në pozicionet nga Duhla, në Dardhë (*Sllapuzhan*), Peqan, Semetisht, Rreshtan, Gurrë dhe deri në anën e Rahavecit. Në fshatin Dardhë pozicionet mes UÇK- së dhe forcave serbe ishin në vijë ajrore vetëm dyqind metra nga vendi Pishat në Biraç.

Gjatë rrugëtimit nëpër Dardhë vizituam dajën tim Avdullah Meta (Sylaj). Hymë në shtëpinë e plakut, i cili një herë nuk na njohu, ngase ishim në uniformë dhe me armë. Kur i treguam kush jemi, plakut filluan t'i rridhnin lotët nga gëzimi. Na mori ngrykë, na uroi shëndet e mbarësi në rrugën e shenjtë që kishim nisur.

Plaku na dha edhe një porosi:

Mos bëni ashtu siç po bën shkau! Ata po vrasin fëmijë, pleq e gra, po dhunojnë, po plaçkitin e po djegin shtëpi, sepse e kanë luftën të humbur. Nuk është në traditën tonë të vrasim gra e fëmijë. Nëse i përmbaheni kësaj tradite, lufta është e fituar dhe ju do të keni ndihmën edhe të botës, edhe të Zotit! - u

shpreh plaku.

Edhe një këshillë na dha plaku në përcjellje:

Nuk është turp të tërhiqeni kur ziheni ngushtë, por jo duke ia kthyer shpinën armikut. Tërheqja të bëhet pjesë- pjesë, dikush në pozicione e dikush në tërheqje.

Porosia e plakut dhe tradita jonë për rregullat e luftës përputheshin në tërësi edhe me konventat ndërkombëtare për luftën, që i kishim mësuar gjatë studimeve. Pikërisht zbatimi i këtyre rregullave nga ushtria jonë gjatë luftimeve bëri që UÇK-ja të fitonte simpatinë e përkrahjen e faktorit ushtarak dhe të opinionit demokratik ndërkombëtar.

Inspektimin e pozicioneve të UÇK-së në fshatin Dardhë e bëmë edhe për arsye se në malin Biraç, te Pishat, ishin pozicionuar forca të mëdha serbe me teknikë luftarake. Pozicioni i tyre ishte tejet strategjik, ngase aty serbët e kishin si në pëllëmbë të dorës gjithë territorin e komunës së Therandës. Nga aty granatoheshin pothuajse çdo ditë pozicionet UÇK-së në Budakovë, në Gurkuq dhe në Dardhë. Nga Biraçi serbët komunikonin edhe me pozicionin tjetër strategjik në manastirin e Trinisë, mes fshatrave Mushtisht e Grykos (*Greikoc*).

Kisha menduar shumë kohë se ku mund t'i godisnim serbët në atë pozicion. Nezir Kryeziut i pata propozuar që sulmi të bëhej në hyrje të Biraçit, në kufi me vreshtat e Therandës. Mirëpo, njerëzit tanë që vepronin për UÇK-në në qytetin e Therandës na thanë se në atë pikë ishte një pozicion i maskuar me ushtarë serbë, që ruanin rrugën e ngushtuar në hyrje të Biraçit.

U detyruam të kërkojmë një vend më të përshtatshëm për t'i sulmuar serbët. Të nesërmen vizitova përsëri ushtarët e Brigadës 123 në pozicionet mes fshatit Dardhë dhe malit Biraç. Ishte korrik 1998 dhe me mua ishin edhe ushtari Bekim Hajdari dhe një ushtar nga fshati Dardhë, që njihte terrenin.

Kërkonim një vend të përshtatshëm nga mund të sulmonim forcat serbe. Ishte me shumë rëndësi që sulmet e para të ishin të suksesshme dhe me sa më pak dëmtime. Kësisoj do të rritej morali ynë luftarak, ndërsa forcave serbe do t'u shkaktoheshin jo vetëm dëme, por edhe frikë e pasiguri.

Kështu e mendoja detyrën time si zëvendëskomandant për moral dhe politikë në kuadër të Brigadës 123. Vlerësoja që nuk mjaftonte vetëm krenaria për trimërinë dhe heroizmin e shqiptarëve gjatë historisë, por duheshin edhe vepra të reja.

Ishte pika e verës dhe mali Biraç tepër i shpeshtë. Si për inat, mali ishte plot krimba, që zvarritjen tonë të rrezikshme e bënin edhe më të vështirë. Ishte pika e ditës kur pozicioneve serbe iu afruam shumë pranë. Për shkak të dendësisë së malit, ata nuk shiheshin, por as nuk na shihnin. I dëgjuam duke folur serbisht. Dëgjoheshin edhe kazmat e tyre duke rrëmihur e hapur pozicione. Pasi vëzhguam mirë gjendjen, dhashë urdhër të ndërrojmë drejtimin e lëvizjes kah pozicioni tjetër në dalje të Biraçit, te Qershiat.

Aty ishte një pozicion tejet i përshtatshëm për sulm, por nuk ishim të sigurt në kishte aty ushtarë serbë, ndërsa për shkak të pozitës strategjike, vendi edhe mund të ishte i minuar.

Me Bekim Hajdarin iu afruam pozicionit te Qershi-

at në Biraç. Dy ushtarëve të tjerë iu dhashë shenjë të qëndronin të fshehur në mal, ndërsa vetë vazhdova nëpër lëndinë, duke prekur me dorë çdo fije bari, sepse ishte rrezik nga minat. Pasi konstatova se nuk kishte mina dhe vëzhgova mirë rrugën e asfaltuar, u bëra shenjë dy ushtarëve të vinin për të parë edhe ata pikën strategjike nga mund të sulmonim forcat serbe.

Një kohë qëndruam në atë pozicion, por nuk pati asnjë lëvizje as nga Duhla, as nga Theranda. Në mbrëmje e njoftova komandantin e brigadës Blerim Kuqi për vëzhgimin që kishim bërë gjatë ditës. Blerimi m'u përgjigj se paskemi menduar njësoj.

- Edhe unë nuk kam qenë i sigurt në ka aty forca serbe, porse është një vend shumë i përshtatshëm për t'i goditur,- shtoi ai.

Të nesërmen Blerimi kishte përgatitur një grup prej rreth 10 ushtarësh për ta kryer sulmin. Në pritën e organizuar në Biraç serbët morën një goditje të fuqishme. Qenë vrarë shumë forca serbe dhe patën dëme të mëdha në teknikë luftarake.[6]

Pas aksionit takova Blerimin dhe e pyeta:

- Pse nuk kishe treguar të vija edhe unë në aksion?

- E bëra me qëllim, nuk doja të të rrezikoja ty që në fillim të luftës, edhe pse ke rrezikuar më shumë në vëzhgim të terrenit se me pjesëmarrje,- më tha ai.

Pas aksionit në Biraç, takova edhe Nezirin e Bekimin, që kishin marrë pjesë në këtë aksion shumë të suksesshëm të Brigadës 123. Ky ishte aksioni i parë kundër forcave pushtuese serbe në rrethin e Therandës, në korrik 1998.

---

6. Emrat e të vrarëve dhe të të plagosurve gjenden në Arkivin e Brigadës 123.

Ishte e natyrshme që ushtarët ishin frymëzuar shumë nga ky sulm, duke shtënë me të gjitha armët që kishin mbi banditët serbë, pa marrë as dëmtimin më të vogël.

Dëshmori i parë

Korriku 1998 ishte konfrontimi i parë frontal i UÇK-së me ushtrinë dhe policinë serbe në rrethin e Therandës.

Më 3 korrik 1998 serbët sulmojnë pozicionet tona në afërsi të fshatit Dardhishtë të Therandës.

Nga Ilirioni shihej qartë tymi e flaka në një lagje të fshatit Dardhishtë. Aty tërë ditën kishte pasur luftime të rrepta. Menjëherë shkuam me përforcime në ndihmë të Batalionit të Budakovës. Së bashku me Isufin e Arben Muçën lëvizëm me një makinë nga fshati Ilirion drejt Pagarushës, Bellanicës dhe Rrezes (*Javor*). Aty pushuam pak për t'u takuar me Ismet Jasharin- Komandant Kumanovën, me të cilin shkëmbyem informacione për gjendjen në zonat e luftimit. Në Qafë të Duhlës lëshuam rrugën kryesore dhe vazhduam në drejtim të fshatit Gjytet (*Greiçec*), për të mbërritur para mëngjesit në pozicionet e UÇK-së mes fshatrave Dardhishtë (*Krushicë)* e Malas (*Muhlan*).

Aty mësuam për luftën heroike dhe rënien e ushtarit të parë të UÇK-së në rrethin e Therandës, dëshmorit të kombit Kadri Kokollari nga Budakova. Atë ditë, më 3 korrik 1998, ende pa përfunduar mirë istikamin e tij, Kadriu ishte ndeshur me forcat serbe. Siç njoftuan bashkëluftëtarët e tij, edhe pse rrezikohej

drejtpërdrejt, ngase nuk kishte ku të pozicionohej, ai nuk u zmbraps fare. Qëndroi në atë pikë ku kishte filluar të gërmonte vetë. Trupi i tij i madh nuk mund të strehohej në vijën e sapofilluar. Ai vetëm mund të tërhiqej, por nuk kishte pranuar dhe kishte rënë dëshmor në ditën e parë të luftimeve, për t'u bërë themel i lirisë së Kosovës. Të nesërmen pritej ceremonia e varrimit të Kadriut. Kisha shumë dëshirë t'ia jepja lamtumirën e fundit, por forcat serbe përsëri mësynë pozicionet tona në Dardhishtë. Së bashku me ushtarët e Batalionit të Budakovës, atë ditë të 4 korrikut zmbrapsëm forcat armike për të mundësuar varrimin me nderime ushtarake të dëshmorit të parë të UÇK-së në rrethin e Therandës.

Të njëjtën ditë, më 4 korrik 1998, luftimet filluan edhe në fshatin Bllacë. Nga Dardhishta shihej tymi dhe dëgjoheshin gjëmimet e tankeve e topave të ushtrisë serbe, që po bombardonin pozicionet e UÇK-së mes Duhlës e Bllacës. Edhe pse ishim të lodhur nga luftimet e paradites, vendosëm t'u shkojmë në ndihmë bashkëluftëtarëve në Bllacë. Me makinën që drejtonte Driton Muça lëvizëm në drejtim të fshatit Papaz. Me ne erdhën edhe ushtari Shaban Gashi nga Ujëmiri (*Savrovë*) dhe Xhafer Gashi nga Dardhishta. Pak pa mbërritur pranë pozicioneve serbe, mes Qafës se Duhlës dhe fshatit Duhël, makinën e lamë në një vend të padukshëm dhe vazhduam t'u afrohemi në këmbë pozicioneve e tankeve serbe.

Ishte një pjesë e malit pranë shtëpive të para të Duhlës, nga mund të shihej si në pëllëmbë të dorës gjithë beteja e madhe mes UÇK- së dhe ushtrisë e policisë serbe. Dëgjoheshin qartë urdhrat e eprorëve

serbë për njësitë e tyre tankiste për marshim e goditje të pozicioneve tona në Bllacën heroike. Serbët bombardonin nga pozicionet e tyre pranë Duhlës dhe nga pozicionet mbi Bllacë, tek Lisi. Nga gjëmimi i tankeve e topave serbë dridhej edhe toka. Dridhej edhe vetë tanku serb, por jo edhe zemra e madhe e luftëtarëve të Bllacës. Nga bombardimet e makinerisë serbe krijohej përshtypja sikur nuk kishte mbetur asnjë ushtar gjallë në pozicionet e Bllacës. Mirëpo, sapo pushonin pak gjëmimet e topave e tankeve, dëgjoheshin krismat njëra pas tjetrës të snajperëve e automatikëve të UÇK-së. Ato krisma i njihnim nga tingëllimi i veçantë i tyre dhe thoshim: qenkan gjallë ende, tani po sulmojnë tanët! Herë pas here dëgjoheshin edhe zërat e luftëtarëve tanë. Nuk isha i sigurt në thoshin përpara apo prite- prite!

Edhe pse nuk ishim larg pozicioneve të tyre, ne nuk mund të komunikonim me ta. Në mungesë të radiolidhjes, ne shfrytëzuam snajperin tonë. Iu ofruam pozicioneve serbe edhe më afër dhe nga një vend i përshtatshëm mbrapa qëllova me snajper mbi snajperistët serbë, që qëndronin në katet e sipërme të shtëpive të Duhlës.

Serbët një moment mbetën të habitur se ç'po ndodhte dhe disa orë i ndalën operacionet e tyre. Kur konstatuan se nga vinin të shtënat, filluan të shtinë në drejtimin tonë. Prapa kokës sime ra një dru i drejtë bungu. Dritoni në krahun tim të djathtë klithi: Kujdes baci Ilaz, shpëtove për një qime floku! Ktheva kokën mbrapa dhe pashë si plumbi kishte këputur drurin pranë meje.

Ishte rrezik të qëndronim edhe më tutje në atë pozi-

cion, sepse serbët e kishin diktuar atë. Ata sikur harruan Bllacën dhe u sulën nga pozicioni ynë. Mirëpo, ne u strehuam në një luginë të përshtatshme, ku nuk mund të na merrnin në shënjestër. Mali sipër nesh po digjej flakë nga breshëria e mitralozëve e snajperëve serbë. Thosha me vete: sikur edhe ne të kishim armë të mjaftueshme dhe teknikën e komunikimit, edhe lufta jonë do të ishte shumë më e fuqishme. Serbët do të shporreshin më shpejt dhe do ta harronin përgjithmonë Kosovën.

Gjetja e dy ushtarëve të humbur

Nuk më kujtohet saktë në ishte fundi i gushtit apo fillimi i shtatorit 1998. Në rrethinën e Therandës ditë me radhë zhvilloheshin luftime të rrepta mes UÇK- së dhe forcave pushtuese serbe. Në mbrëmje kur pushonin pak luftimet, Komanda e Brigadës 123 takohej për të analizuar situatën dhe për t'u informuar më hollësisht për rrjedhën e luftimeve.

Ishte luftë për liri a vdekje dhe lufta ka edhe çmimin e saj. Atëherë Komanda e Brigadës ishte vendosur në fshatin Breshanc, një vend strategjik. Aty, në shtëpinë e Fevzi Bytyçit, ishte edhe Spitali ushtarak i UÇK-së. Ishte një takim i jashtëzakonshëm i brigadës, ku u raportua për shumë humbje në radhët tona dhe humbjen e dy ushtarëve tanë mes fshatrave Semetisht e Peqan. Të dy ushtarët kishin rënë në pritë të forcave serbe kur po tentonin të futeshin në fshatin Peqan. Dy ushtarët e zënë robër, duke ditur se do të vriteshin nga serbët, para tytave të armikut kishin provuar të iknin në hyrje të fshatit Peqan kur kishte rënë muzgu.

Rafalet e automatikëve serbë ishin dëgjuar lugut të Rreshtanit, Semetishtit e Breshancit.

Dyshohej se të dy ushtarët ishin vrarë atë mbrëmje. Tani kur rasti i tyre po diskutohej në Komandën e Brigadës, ora kishte kaluar 23 të natës. Kishte hezitime se a vlente të rrezikohej në atë kohë të pasigurt. Insistova që me çdo kusht duhej të shkonim në vendngjarje. Kështu u deklarua edhe Blerim Kuqi dhe pas këtij pothuaj e gjithë Komanda e Brigadës ishte e gatshme për të shkuar atje. Gafurrit dhe disa të tjerëve iu propozova të qëndronin në bazë, sepse nuk ia vlente që e gjithë Komanda e Brigadës të futej në një rrezik të madh.

Nga Breshanci lëvizëm me dy makina në drejtim të Semetishtit e Peqanit, ndërsa nga aty ecëm këmbë nëpër anët e rrugës dhe peregjet e arave. Nuk përjashtohej mundësia që serbët të kishin ngritur edhe ndonjë kurth tjetër, siç ka ngjarë në disa raste kur minoheshin kufomat ose i ruanin ato duke ditur se do të tërhiqeshin më vonë. Duke lëvizur ngadalë nëpër terr të thellë, me gishtin në këmbëz të automatikut, para këmbëve tona u duk një trup njeriu, i gjatë dhe i shtrirë përmbys në mes të rrugës. Iu afruam pranë dhe duke e prekur kuptuam se trupi i tij ishte shtangur. Ilmet Fandaj e njohu ushtarin e vrarë, ishte Remzi Bytyçi nga fshati Peqan. Trupi i tij ishte bërë shoshë nga plumbat, ndërsa gjaku i tij ishte derdhur në tokën e Peqanit dhe të Kosovës. Njëri nga ushtarët qëndroi pranë kufomës, ndërsa ne të tjerët kërkonim ushtarin tjetër.

Nja 15 metra larg u dëgjua një gjysmëzë i mekur: o vëllezër, a jeni shqiptarë, jam i plagosur! Që të katër-

tit sa ishim mbetëm të shtangur. Lëvizëm ngadalë nga vendi kah vinte zeri. Ishte një vend i pjerrët, një palë dyer të mëdha me një deriçkë të hapur, që shpinte në oborrin e një shtëpie. I plagosuri ishte shtrirë skaj një muri me gurë pranë dyerve të oborrit. Dikush nga ne ndezi një shkrepës dhe fytyra e ushtarit të plagosur shndriti si kandil në terrin pus të natës. I plagosuri kishte derdhur shumë gjak, ndoshta ato ishin minutat e fundit të jetës së tij. Ia shtrënguam pak plagët për të mos rrjedhur ende gjak. Atëherë u dëgjuan disa fjalë urimi nga thellësia e shpirtit të tij të lodhur dhe i plagosuri filloi ta merrte veten.

Ushtarin e vrarë dhe atë të plagosur i bartëm në krahë deri te makinat tona. Në njërën vendosëm të plagosurin, që e dërguam me shpejtësi në spitalin ushtarak, ndërsa në tjetrën trupin e ushtarit të vrarë. Këmbët e tij të gjata mbetën jashtë dritares së pasme të makinës, ndërsa trupin e tij e vendosa në prehrin tim, duke udhëtuar për në komandën e Brigadës 123 në Breshanc.

Evakuimi i të plagosurve

Ofensiva serbe e gushtit 1998 ishte e fuqishme dhe me përmasa të mëdha. Ushtria dhe policia serbe në këtë ofensivë angazhuan me mijëra trupa, tanke dhe artileri të rëndë.

Fillimisht, më 18 gusht 1998, sulmohen pozicionet e UÇK-së afër fshatit Apterrush (*Opterushë*) dhe pothuajse në të njëjtën kohë edhe pozicionet tek pika Loni pranë Therandës, në drejtim të fshatit Rreshtan.

Për një kohë të shkurtër fronti i luftimeve përfshiu

pjesën më të madhe të rrethit të Therandës, që nga Qafa e Duhlës, Bllaca, Dardha, Rreshtani, Semetishti, Gurra, Vneshta, Nepërbishti e deri në Pagarushë e Rahavec.

Tetë ditë me radhë pozicionet e UÇK-së u bombarduan nga të gjitha anët nga artileria e rëndë serbe, që ishte pozicionuar në pikat strategjike të Therandës e Rahavecit.

Numri i ushtarëve të vrarë e të plagosur shtohej çdo ditë nga granatimet serbe. Spitali ushtarak në shtëpinë e Fevzi Bytyçit në Breshanc ishte stërmbushur me ushtarë e civilë të plagosur. Ishte një gjendje tepër e rëndë, sepse nuk kishim përjetuar më herët një front kaq të gjerë. Problem më i madh ishte mungesa e armatimit, sidomos e municionit. Për dy- tri ditë luftime harxhuam ato pak predha të mortajave, ndërsa ishte e pamundur të ndaleshin me municion kallashi tanket serbe.

Në mbrëmje u mblodh në takim Komanda e Brigadës 123, ku u ndanë detyrat për ditën e nesërme. Mua dhe Gafurrit na u dha detyrë zhvendosja e të plagosurve nga spitali ushtarak i Breshancit. Me përgjegjësin e spitalit Agim Hazrolli bëmë planin e evakuimit dhe zhvendosjen e spitalit, sepse tani ushtria serbe i ishte afruar fshatit Semetisht dhe rrezikohej drejtpërdrejt jeta e të plagosurve në spitalin e Breshancit.

Të plagosurit u vendosën në një kamion të madh të mbuluar me ceradë dhe në disa automjete të tjera. Rruga nga Breshanci drejt fshatrave malore të Malishevës ishte shumë e pasigurt dhe me plot rreziqe.

Në përkujdesjen e të plagosurve dhe në kolonën që

i siguronte ishte i angazhuar i tërë personeli i spitalit ushtarak me mjekët kryesorë të UÇK-së: Agim Hazrolli, Shpëtim Robaj (dëshmor i kombit) dhe mjeku Ilir Batusha. Vazhduam rrugën në drejtim të fshatrave Dragubil e Sukë të Gashit (*Svërkë*). Me të arritur në oborrin e shkollës së fshatit, na vdiq nga plagët e rënda dhe temperatura e lartë ushtari Shaban Gashi nga fshati Rreshtan i Therandës. Ai ishte plagosur ditë më parë në luftimet me ushtrinë serbe tek pika Loni afër Therandës.

Mjekut Shpëtim Robaj i rrodhën lotët, duke ofsharë thellë:

Uh, na shkoi djali për pak! Nuk kishte barna për t'ia larguar temperaturën. Tani duhej ta varrosnim ushtarin e ndjerë, diku afër apo gjetkë. Ushtari Bekim Bytyçi nga Gurra tha:

Më është harxhuar karburanti, nuk mund të lëviz as 2-3 km, se do ta dërgoja gjithsesi në Pagarushë.

Për fat, në një rrugë të fshatit Sukë e Gashit dy fëmijë të moshës 10-12 vjeçare kishin qitur në rrugë dy bidonë me karburant për shitje. Ua blemë atë naftë dhe ia dhamë Bekimit, i cili ishte i lindur të vepronte në situata të tilla. Ai vuri karburantin në makinë dhe aty vendosëm ushtarin dëshmor. Bekimi kishte arritur ta dërgonte në Pagarushë (afro 20 km larg) dhe ta varroste me nderime ushtarake, ndërsa vetë ishte kthyer për përkujdesje ndaj të plagosurve të tjerë në Sukë të Gashit.

Të plagosurit i vendosëm përkohësisht në shkollën e fshatit. Komandanti i fshatit na njoftoi se në afërsi të shkollës, në një minierë të braktisur, ishin vendosur forca serbe. Ishte rrezik të qëndronin aty gjatë

të plagosurit dhe vendosëm të lëviznim në drejtim të fshatrave pak më të sigurta Grap (*Panorc*) e Rud.

Në hyrje të fshatit pyeta disa banorë se kush ishte përgjegjës i fshatit? Më treguan emrin Fetah Rudi dhe pas pak u kthyen bashkë me të. Ishte pak i frikësuar, sepse nuk dinte arsyen pse ishte ftuar. I treguam se kishim nevojë urgjente për strehimin e të plagosurve. Ai pranoi me kënaqësi dhe dukej i gëzuar në fytyrë, që po i bënte një shërbim luftës së UÇK- së.

Me ndihmë edhe të fshatarëve, të plagosurit u vendosën në dy- tri shtëpi të fshatrave Grap e Rud. Familjarët e atyre shtëpive na mirëpritën me shumë bujari, duke na ofruar edhe ushqim të mjaftueshëm. Aty personeli mjekësor ua dha ndihmën e nevojshme të plagosurve.

Atëherë m'u kujtuan këshillat e veprimtarit e atdhetarit Shaban Braha, në mars 1992 në Tiranë:

Në luftë do të keni nevojë edhe për ndihmën më të vogël të një fshatari. Edhe ai do t'jua lëshojë shtëpinë ose do të bartë me qerren e tij ndonjë të plagosur, prandaj lufta duhet të ketë karakter gjithëpopullor.

Të plagosurit nuk mund të qëndronin gjatë edhe në ato fshatra, sepse edhe aty pritej ndonjë ofensivë serbe.

Me shokun tim të ilegales e të luftës Muharrem Dina shqyrtuam mundësinë që të plagosurit të vendoseshin përkohësisht në Zonën e Dukagjinit. Për këtë qëllim udhëtuam në drejtim të fshatit Prapaçan, ku ishte një komandë e UÇK-së.

Fillimisht u habitëm paksa: oborri i kësaj kazerme ushtarake i ngjante më shumë një kazerme në kohë paqeje se lufte. Në hyrje të kazermës pamë vetëm

një ushtar të veshur me fanellë të bardhë me krahë të shkurtër. Ai mbante në dorë një bostan të madh. Pak më larg, para objektit të komandës vërejtëm dy vajza gjysmë të uniformuara. Mixha tha: si duket këta ende nuk ia paskan ndier erën barutit! Ushtari me fanellë të bardhë na tha:

- Urdhëroni, çfarë doni dhe nga jeni?

I thamë se jemi nga Zona e Pashtrikut dhe duam ta takojmë komandantin e kësaj kazerme. Kemi nevojë urgjente për vendosjen e të plagosurve në këtë zonë.

- Pritni pak të bisedoj me komandantin!- na tha ai.

Pas nja 5-10 minutash ushtari me fanellë të bardhë u kthye dhe na dha përgjigjen e komandantit:

- Na vjen keq, por nuk mund të pranojmë të plagosur të zonave të tjera!

Komandanti që nuk na pranoi t'ia tregonim së paku hallin, ishte vetë Tahir Zema. Këtë na konfirmoi ushtari me fanellë të bardhë, pas insistimit tonë të dinim së paku emrin e këtij komandanti.

Të dëshpëruar në komandën e Prapaçanit, vazhduam me Mixhën rrugën nëpër Dukagjin. Në orët e vona të mesnatës mbërritëm në fshatin Gllogjan për ta takuar Emrush Xhemajlin.

Emrush Xhemajli, Dukagjin, mars 1999

Ishte natë e shumë terr dhe për pak nuk kishim rënë në një pritë serbe. Për fat, hasëm dy ushtarë rojë. Ata na kishin hetuar në hapa, edhe pse ecnim shumë lehtë. Kërkuan me zë të lartë të ndaleshim dhe të tregonim kush ishim. Na kërkuan edhe kodin e verifikimit. U thamë se ishim nga Zona e Pashtrikut dhe se kërkonim Emrush Xhemajlin. Kërkuan edhe pseudonimin e tij. Kur ia përmendëm emrin *Kompjuteri*, atëherë na thanë të afroheshim ngadalë me duart lart. Porsa na vërejtën që ishim ushtarë të UÇK-së, na përshëndetën ushtarakisht dhe na uruan mirëseardhje.

- E dini se nga këtu vetëm 70 metra janë pozicionet serbe? - Jo, - u thamë, por na zuri nata dhe vendosëm të vijmë këtu.

- Keni mundur të vriteni edhe prej nesh, e lëre më nga serbët!

Dy ushtarët e Dukagjinit na dërguan në një shtëpi aty pranë, në një vend të rrafshët plot gjelbërim. Kaluam përmes një vije uji dhe një verrishte. Fshati ishte bërë shkrumb e hi nga lufta dhe nuk dëgjohej asnjë zë i gjallë, përveç ndonjë pëllitje lopësh. Bagëtia e braktisur ishte hapërdarë fushës.

Përpara na doli Emrushi, *Kompjuteri* i UÇK-së. Ishte vendosur në një shtëpi të djegur. Edhe pse ishte natë, mbante komplet uniformën, automatikun, bombat dhe thikën ushtarake. U gëzua shumë kur na pa:

- Këso mrekullie dinë të bëjnë vetëm veteranët e UÇK-së! Po ç'e mirë ju solli në këtë kohë të natës? I treguam hallin me të plagosurit.

- Pritni pak, - na tha - merrni frymë e pushoni pak!

Na ofroi pak bukë të thatë misri, që ishte bërë e fortë guri, sa mezi e ndau më dysh. Edhe pak djathë, edhe ai më i fortë se buka e misrit. Ishim shumë të uritur dhe atë darkë të shijshme nuk do ta harroj kurrë. Vazhduam bisedën gati deri në mëngjes. *Kompjuteri* na njoftoi për heroizmin e ushtarëve të Dukagjinit dhe për luftën e tyre në atë zonë.

Porsa zbardhi dita, u bindëm se në Dukagjin ishte gjendja edhe më e keqe se në Zonën e Pashtrikut. Nuk kishte mbetur shtëpi në këmbë, të gjitha ishin bërë shkrumb e hi nga lufta. Të plagosurit nuk mund të vendoseshin aty as për një kohë të shkurtër. U kthyem në bazën e Brigadës 123, ku ishte një gjendje e rëndë.

Në mbrëmje Komanda e Brigadës mbajti një takim urgjent. Një pjesë të personelit komandues kishte filluar ta lëshonte morali i luftës. Ata kërkonin që

Brigada 123 të dilte me një deklaratë publike, që tani e tutje t'i përkiste së ashtuquajturës "Ministri e mbrojtjes" dhe të vihej nën urdhrat e të ashtuquajturit "President i Kosovës". Propozuesi i kësaj deklarate, zëvendëskomandanti i logjistikës, arsyetohej se me këtë gjë lufta jonë do të fitonte përkrahje më të madhe ndërkombëtare. Madje ai propozoi të votohej për këtë. Mirëpo, një gjë të tillë nuk e lejuam assesi, sepse kjo do të ishte goditja më e rëndë për UÇK-në. Vënia e Brigadës 123 nën urdhrat e Rugovës do të ishte njësoj si t'i dorëzoheshim vetë kriminelit Milosheviç.

Në këtë takim unë mora detyrën të kontaktoja me komandën e Batalionit të Budakovës, në mënyrë që Komanda e brigadës te kalonte në atë zonë, që ishte pak më e sigurt. Të njëjtën natë udhëtova për në Budakovë dhe u morëm vesh me komandant Sadik Halitjahën, që Komanda e brigadës të kalonte në Budakovë.

Të nesërmen në mbrëmje u ktheva në fshatin Vneshtë (*Samadraxhë*). Aty kuptova se komandanti i brigadës, i gjendur në një situatë të rrethimit të plotë nga forcat serbe, kishte marrë një vendim të ngutshëm, pa konsultim me anëtarët e tjerë të komandës, që brigada të vepronte në grupe të vogla deri në një vendim tjetër. Të gjedur në një situatë të vështirë, të nesërmen u takuam në fshatin Ilirion me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Bislim Zyrapin, i cili na propozoi që disa ditë të shkonim për konsultime e furnizim me armë në Shqipëri.

Kuajt e luftës

Shumica e armatimit e municionit të luftës vinte nga shteti amë, Republika e Shqipërisë. Armët barteshin në krahë nga vetë ushtarët, duke kaluar kufirin nëpër bjeshkët e Sharrit, Pashtrikut, Shkëlzenit e bjeshkëve të Pejës, që mbaheshin nën kontrollin e rreptë të forcave pushtuese serbe. Me qindra luftëtarë të lirisë ranë në prita, duke kaluar kufirin e mallkuar, që një shekull ndante dhunshëm vëllezërit e një gjaku.

Ishte hera e dytë që shkonim e ktheheshim nga Shqipëria. Qëllimi ynë ishte që në Kosovë të fusnim sa më shumë armë e municion.

Në fshatin Vlanë ishte një nga bazat e logjistikës, prej nga bëhej furnizimi me armë. Në hyrje të ndërtesës së kësaj baze qëndronin ushtarët që bënin rojë.

Raif Gashi, njëri nga përgjegjësit e logjistikës në Shqipëri, më pyeti në kisha dëshirë ta takoja *Plakun*, siç e thërrisnin ushtarët Xheladin Gashin, njërin nga veteranët e Lëvizjes Popullore dhe të Luftës çlirimtare. Së bashku me Raifin u futëm në një dhomë të veçantë në formë të zyrës, ku bëhej e mbahej evidenca e ushtarëve dhe e armatimit. Ishte rregull që dikush nga grupi të nënshkruante dokumentin për pranimin e armëve.

Dhoma që shërbente si zyrë e Komandantit të logjistikës ishte e stërmbushur me armë e municione. Shokut tim të ilegales e luftës, në fillim as i bëri përshtypje prania jonë. Ishte i lodhur e dërrmuar nga pritja dhe përcjellja e mijëra ushtarëve në të dy anët e kufirit.

- Përshëndetje zoti Komandant! – i thashë. Vetëm kur dëgjoi këtë ai hapi sytë dhe u ngrit në këmbë për të më uruar mirëseardhje. Kishin kaluar shumë vjet pa u parë me Plakun. Shtatë vjet më parë në Ujëmir të Klinës ishim takuar në Mbledhjen e tretë të përgjithshme të LPK-së, ku ishim dakorduar se lufta kundër pushtuesit ishte zgjidhja e vetme për çlirimin e vendit. Tani kjo luftë ishte bërë realitet. Nuk patëm shumë kohë për t'u çmallur, sepse me qindra ushtarë prisnin në radhë të merrnin ngarkesën më të çmuar për luftë: armët dhe municionin.

Plaku na pyeti sa ushtarë ishim dhe na porositi të merrnim edhe disa kuaj për ngarkesë. Përballë bazës së logjistikës prisnin disa kuaj me samarë. Pronarët e tyre kishin vënë re përgatitjen tonë për të lëvizur në drejtim të Kosovës. Na pyetën nëse kishim nevojë për kuaj. Sigurisht ata e bënin këtë punë, sa atdhetare, aq edhe të rrezikshme, nga halli e nevoja për të mbajtur familjet e tyre. Kështu, ata rrezikonin shumë edhe veten, edhe kuajt e tyre, por donin të kontribuonin për luftën e përbashkët. Raifi na siguroi edhe markat, me të cilët paguam çmimin e kuajve: 50 marka për një kalë për bartjen e armëve nga fshati Vlanë deri në brendi të Kosovës. Ishte një rrugë e gjatë dhe me plot rreziqe. Kuajt i ngarkuam mirë. Dikush nga ushtarët tha se duheshin edhe dy kuaj rezervë, që në rast nevoje të bartnin ushtarët e lodhur, ndërsa në ndonjë rast eventual, edhe të plagosurit.

Për shkaqe sigurie, lëvizja drejt kufirit bëhej zakonisht natën. Rruga nëpër Shqipëri mund të shfrytëzohej edhe pa rënë terri, ndërsa nga kufiri e më tej ishte një rregull i pashkruar që lëvizja të bëhej vetëm

natën. Nuk prishte punë edhe po të binte shi, pavarësisht se na rëndonte ngarkesën, sepse në kushte të tilla mundësia për të rënë në pritë ishte më e vogël.

Armët e municionet i vumë nëpër disa thasë dhe i ngarkuam në kuaj. Nuk e kishim vështirë t'i ngarkonim, sepse shumica e ushtarëve ishin nga fshatrat.

Pasi u ngarkuam edhe vetë me armë, bëmë edhe disa fotografi, sepse nuk i dihej rrugës. Ndonjë fotografi e bukur me kuaj e gomarë do të na mbetej kujtim edhe për së gjalli, edhe për së vdekuri.

Karvani me 25 ushtarë e 10-12 kuaj të ngarkuar u nis drejt Pashtrikut. Me Habib Elshanin u morëm vesh që ai me një ushtar tjetër t'i prinin kolonës, ndërsa unë të qëndroja në fund të saj. Në fillim të kolonës ishte detyrimisht edhe njëri nga pronarët e kuajve, sepse ata e njihnin mirë rrugën drejt kufirit, që e kishin kaluar me dhjetëra herë natën e ditën.

Ishte natë e errët, kur ne po kalonim dhiareve, tërthore të vështira edhe për alpinistët me përvojë. Ne ishim të ngarkuar rëndë, pa ndonjë kondicion të duhur në atë rrugëtim.

Gjatë tërë rrugëtimit binte një shi i imët, që na rëndonte edhe me shumë barrën tonë. Në një pjesë të rrugës shfrytëzuam kuajt rezervë për t'i bartur ushtarët që ishin lodhur më shumë, në mesin e të cilëve edhe Gani Krasniqin nga Malisheva, i cili iu bashkua kolonës sonë në fshatin Vlanë.

Pas disa orë udhëtimi iu afruam pjesës së kufirit kah maja e Pashtrikut, një pjesë e së cilës ishte e mbjellë me mina. Në këto shtigje të rrezikshme ushtarët tanë shpeshherë kishin rënë në prita, duke humbur edhe jetën. Ushtarët tanë me përvojë kishin rrezikuar

shumë herë për t'i hequr ato mina të vëna nga ushtria serbe në çdo shteg e rrugë.

Para se të futeshim në zonën e kufirit me Kosovën, u ndalëm të pushojmë pak dhe t'i vëzhgojmë shtigjet nga duhej të kalonim. Një stan barinjsh majë Pashtrikut na shërbeu për t'u çlodhur. Për çudi, pranë stanit dukej një varr. Ndoshta ishte varrosur ndonjë ushtar i vrarë apo ndonjë bari i vdekur nga acari. Ushtarët e lodhur pushuan pak të mbështetur në armët e tyre. Edhe kuajt e mirë të luftës, ashtu të ngarkuar, kërkuan ndonjë fije bari për të marrë forcë në atë rrugëtim të gjatë.

Nuk guxonim të pushonim më shumë se 10-15 minuta, sepse ushtarët e djersitur mund të ftoheshin, ndërsa rruga duhej kaluar medoemos natën. Gjithnjë në krye të kolonës ishte pararoja e ushtarëve dhe drejtuesit e rrugës me kuajt e tyre. Nuk shihej asgjë. Dikush nga ushtarët mbahej për bishtin e kalit, ndërsa të tjerët ndiqnin këmbët e ushtarit që kishin përpara. Rruga ishte e thepisur, me plot kthesa të rrezikshme. Rrallë kishte ndonjë lëndinë, ku vëreheshin gjurmët e kolonave të tjera të ushtarëve.

Ushtarët ecnin me kujdes dhe me armë në dorë, të gatshëm për çdo të papritur. Nuk pipëtinte asgjë, përveç zhurmës së lehtë të nallçave të kuajve, që edhe nëpër terr të thellë ndiqnin shtigjet. Në një pjesë të rrugës së mbuluar me bar e shkurre, një ushtar i ri lëshoi një zë të mekur:

- Kujdes, kemi rënë në mina!

Ushtarët e tjerë u shtrinë përtokë dhe prisnin ç'po ndodhte. Ushtar mbrapa tij iu afrua ngadalë për ta ndihmuar. Këmba e ushtarit të ri ishte ngatërruar në disa rrënjë të forta. Ai nuk lëvizi derisa ushtari

prapa tij u sigurua që nuk ishte tel i minës dhe nuk kishte rrezik.

Pavarësisht rreziqeve, udhëtimi duhej vazhduar. Ushtarët e njësitit *Syri i Shqiponjës*, bashkë me armët e municionin, duhej të mbërrinin patjetër në frontin e luftës.

Në anën lindore të majës së Pashtrikut, gjersa po ecnim në heshtje, papritmas rrëshqiti një kalë. Ai u rrokullis poshtë në një greminë rreth 30- 40 metra. Ishte ai kali i ngarkuar me predha e municione të mortajës 500-she të prodhimit kinez. Ushtarët u shtrinë përdhe në pritje të gjëmimit të predhave. Qëndruan ashtu të shtrirë për një kohë derisa u siguruan se nuk kishte shpërthim. Duhej të tërhiqnim kalin bashkë me predhat, edhe pse ishte rrezik. Njëri nga pronarët e kuajve tha ta linim kalin dhe të mos rrezikoheshim. Ushtarëve u thashë të prisnin pak, ndërsa unë me Emriun u lëshuam zvarrë nga ishte rrokullisur kali. Vërejtëm se kali i mjerë, ashtu i ngarkuar me barrë e municion, qëndronte i shtrirë. Pranë tij dëgjohej një zhurmë krrup- krrup. Kali po këpuste bar me dhëmbët e tij. Pasi u siguruam që barra ishte e padëmtuar, e ndihmuam pak anash dhe kali u ngrit në këmbë me gjithë barrën. Ecëm disa shtigjeve me leqe tërthore, ku Emriu tërhiqte kalin, ndërsa unë mbaja barrën. Pas disa minutash kali hyri përsëri në kolonë. Ishte një qëndresë e paparë e një kali, që ndoshta meritonte edhe një këngë. Emriut, që kishte prirje për humor, i propozova që pas luftës, në majën e Pashtrikut t'i ngrinim një përmendore këtij kali të luftës.

Emriu ma ktheu si me rafal:

- Jo në Pashtrik, por mu në qendër të Prishtinës!

Shumë herë në pritat serbe ishin goditur edhe ushtarët tanë, edhe kuajt që bartnin armë për luftën dhe lirinë.

Fatmirësisht, atë ditë nentori 1998 kaluam mirë të gjithë. Pas rreth 12 orë udhëtimi, njësiti mbërriti në cakun tonë, në fshatin Mazrek, ku në dy kamionë transportues ngarkuam armët e municionin dhe vetë ushtarët e dërrmuar nga rruga e gjatë. Pronarët u kthyen me kuajt e tyre, pa pushuar fare, në drejtim të kufirit, rrugës së tyre të rrahur qindra herë.

Një muaj më vonë, gjatë acarit të dimrit të madh, një kolonë tjetër me rreth 100 ushtarë të UÇK-së, pasi kalon kufirin nga maja e Pashtrikut, bie në një pritë të armikut dhe më 14 dhjetor 1998 në luftë me bishat serbe vriten 41 luftëtarë të UÇK-së, në mesin e tyre edhe veterani e heroi Mujë Krasniqi.

Beteja e ashpër në Pagarushë

Gjatë pranverës 1999 në rrethin e Therandës u zhvillua njëra nga betejat me të mëdha mes UÇK-së dhe ushtrisë serbe.

Vija e frontit ishte shumë e gjatë dhe e gjerë. Gjithë rajoni i komunave Therandë e Rahavec ishte përfshirë në luftime të ashpra. Vija e frontit kapte rreth 30 kilometra, që nga Qafa e Duhlës, Dardha e Rreshtani, Semetishti e Gurra, Vneshta e Ilirioni, Zoqishta, Apterrushi deri në Rahavec.

Dymbëdhjetë ditë me radhë pozicionet tona bombardoheshin me artileri të rëndë serbe. Gjëmimi i

topave, minahedhësve të kalibrit të rëndë dhe tanket qëllonin ushtarët tanë, duke krijuar një atmosferë të rëndë, sidomos për ushtarët e rinj dhe pa përvojë.

Komandanti i Zonës Tahir Sinani kishte kohë që ndodhej në luftime. Ardhja e tij në radhët tona, përveç simbolikës së luftës gjithëkombëtare, kishte edhe anën pozitive e konkrete në terrenet e luftimit. Tahiri nga fshati Grijë i Tropojës kishte shërbyer një kohë në njësitet speciale të Ushtrisë shqiptare. Ai me kohë mori të gjitha masat për luftë dhe mbrojtje efektive. Me hir e pahir kishte mobilizuar në luftë edhe civilët e fshatrave Pagarushë, Ilirion e më gjerë. Në pikat strategjike mes këtyre dy fshatrave kishte hapur istikame aq të mëdha dhe të thella, sa që ato u përngjanin greminave.

Ishte e domosdoshme që vija e frontit të tërhiqej në pozicionet rezerve, pikërisht në istikamet që ditë më parë kishte hapur komandanti Tahir Sinani.

Sulmet e ushtrisë armike ishin shumë të fuqishme, ndërsa qëndrimi i ushtarëve tanë në fushë të hapur ishte baras me vetëvrasjen. Edhe me gurë të granatoheshin pozicionet tona për 12 ditë me radhë ishte hata, e lëre më me granata topash, që nuk linin vend pa goditur. Të gjitha këto goditje në fillim bëheshin nga largësia, një kohë kur larghedhja e armëve tona nuk arrinte një rreze më të gjatë se 400-500 m. Vetëm ndonjë mitraloz 12.7 mm mund të qëllonte në largësi deri 1000 metra.

Ai që sulmon në luftë gjithmonë ka epërsi në terren dhe shanse më të mira për fitore. Mirëpo, kur mbrojtja është e mirë, shpeshherë mund të ndërrojë situata dhe armiku të thyejë qafën. Istikamet tona

në malin e Pagarushës ishin të përgatitura aq mirë, sa ushtarët tanë kishin mundësi pozicionimi, por edhe për të lëvizur e ndërruar pozicionin. E vetmja mundësi për të na goditur ishte gjuajtja në diagonale me minahedhës, që minat të binin pingul mbi pozicionet tona.

Pasi serbët sulmonin nga largësia, ata u afroheshin me tanke pozicioneve tona. Atëherë vija e frontit mes nesh dhe ushtrisë armike nuk kishte më shumë se 200- 300 metra.

Kur pozicionet tona digjeshin flakë nga tanket armike, inspektonim me shpejtësi ushtarët tanë nëpër istikame lufte. Rreziku ishte i madh dhe ushtarët tanë të rinj ishin të lodhur, pa bukë e ujë. Mbi të gjitha, ata kishin nevojë për forcë morale. Ushtarëve të rinj u thoshim me zë të lartë të qëndrojnë përballë kësaj furtune, që shpejt do të kalojë. Shpeshherë ushtarët nuk u besonin fjalëve tona dhe na shikonin me habi. Megjithatë, merrnin zemër e fuqi për të vazhduar luftën e pabarabartë, por të drejtë e të pastër si loti. Në orët e mbrëmjes zakonisht pushonin luftimet, ndërsa ne numëronim të vrarët e të plagosurit. Më vështirë për ne ishte kur luftimet zgjasnin me javë të tëra, kur na harxhohej municioni, sepse armët pa municion ishin thjesht si hunj gardhi.

Në këso rastesh duhej të ndërrohej patjetër taktika e luftimit. Me njësitin tonë dhe një numër të vogël ushtarësh çorientonim armikun me sulme të befasishme, duke e goditur në prita, anash dhe mbrapa.

NJËSITI *SYRI I SHQIPONJËS*

Lufta mes UÇK-së dhe ushtrisë e policisë serbe ishte një luftë shumë e pabarabartë. Serbët kishin epërsi të madhe në teknikë dhe forca ushtarake. UÇK-ja ishte ushtri vullnetare, pa ndonjë përvojë luftarake, me ushtarë kryesisht të rinj, që më parë nuk kishin pasur as kontakt me armë. Shumica sish nuk kishin kryer as shërbimin e rregullt ushtarak. Etja për liri, vullneti dhe gatishmëria për luftë kundër pushtuesit bënë që UÇK-ja të aftësohej në luftë e sipër për përballje me një ushtri me përvojë dhe sipërore në armatim.

Për shkak të masivizimit të luftës, zgjerimit të fronteve të betejave dhe raportit të pabarabartë të forcave, lindi nevoja e formimit të njësiteve të veçanta elite, me ushtarë trima, që kishin një përvojë të ndeshjes me serbët. Këto njësite kishin një numër më të vogël ushtarësh, që goditnin me sulme të befasishme nga të gjitha anët dhe në prita, në mënyrë që t'i shkaktoheshin armikut sa më shumë dëme teknike dhe në efektiv ushtarak.

Për këtë qëllim u formua edhe njësiti diversant sulmues *Syri i Shqiponjës*. Të gjithë ishin dakord që njësiti të merrte emrin e simbolit tonë kombëtar, shqiponjës. Arsyetimi im që tipar themelor i shqiponjës ishin sytë e saj të mprehtë, që piketonin gjahun në largësi, u pëlqye nga të gjithë.

Njësiti vepronte në kuadër të Komandës së Zonës Operative të Pashtrikut, ndërsa terren i luftimit ishte kryesisht rajoni i komunave Therandë, Malishevë, Rahavec dhe një pjesë e Prizrenit. Njësiti vepronte

ku kishte nevojë dhe aty ku vlerësonte komanda e njësitit.

Sukseset në luftimet me serbët bënë që për një kohë të shkurtër njësiti *Syri i Shqiponjës* të krijonte një autoritet të dalluar në Zonën Operative të Pashtrikut dhe në tërë UÇK- në. Ky njësit shkaktonte tmerr e panik në radhët e ushtrisë e policisë serbe.

Njësiti *Syri i Shqiponjës* vetëm në muajt mars, prill, maj dhe qershor 1999 kreu mbi 30 aksione të suksesshme kundër forcave pushtuese serbe.

Sulmet e njësitit *Syri i Shqiponjës* në të shumtën e rasteve u ngjanin sulmeve kamikaze dhe ishin shumë efektive, për arsye se asgjësonin tërësisht forca pushtuese serbe, ndërsa dëmet në radhët e njësitit ishin minimale, shpesh edhe pa pasoja.

Parim kryesor i njësitit gjatë tërë luftës ka qenë sulm dhe vetëm sulm. Kësisoj dëshmonim në praktikë thënien se sulmi është mbrojtja më e mirë.

Numri i ushtarëve të njësitit asnjëherë nuk ka kaluar shifrën 30, duke përfshirë logjistikën dhe personelin mjekësor.

Asnjëherë njësiti nuk ka pasur vështirësi për efektivin e tij, sepse aty paraqiteshin vazhdimisht ushtarë vullnetarë, zakonisht më të mirët. Vetëm ata që kishin në gjak e në shpirt artin e luftës gjenin veten në këtë formacion elitar të UÇK-së.

Edhe pse armatimi në UÇK ka qenë gjithnjë me mungesë, për ata që luftonin me përkushtim, edhe armët gjendeshin ose vinin vetë. Furnizimin me armë e bënin vetë ushtarët, të cilët, para se të hynin në UÇK, së paku një herë duhej të kalonin kufirin me Shqipërinë për t'u furnizuar me armë. Në të shumtën

e rasteve armët barteshin në krahë dhe në shpinë, ndërsa në raste të rralla edhe me kuaj, që siguroheshin nga banorët e fshatrave pranë kufirit Kosovë-Shqipëri.

Për furnizim të njësitit tonë me armë qe përkujdesur posaçërisht edhe Komandanti i Zonës Operative të Pashtrikut, Tahir Sinani, i cili kishte dhënë edhe një urdhëresë të veçantë për furnizim me armë të këtij njësiti.

Gjeneral Tahir Sinani, komandant i Zonës Operative të Pashtrikut.

Armët e njësitit ishin kryesisht të lehta dhe të kalibrit të vogël, aso armë që kishte e gjithë UÇK-ja: thika, pistoleta, bomba dore, automatikë të prodhimit shqiptar e kinez, snajperë të prodhimit jugosllav, mortaja dore të prodhimit kinez, të ashtuquajturat 500-she dhe 150-she, pak zola të prodhimit jugosllav, një sasi të vogël minash antitanke dhe një sasi të kufizuar eksplozivi.

Armët në fillim të luftës u siguruan në Shqipëri nga vetë ushtarët tanë, duke i bartur në krahë dhe në kushte të rrezikshme kur tërë kufiri Kosovë- Shqipëri kontrollohej rreptë nga policia e ushtria serbe.

Një pjesë të mirë të armatimit njësiti *Syri i Shqiponjës* e rrëmbeu nga serbët gjatë luftimit, kur nga goditjet e fuqishme të *Syrit të Shqiponjës*, barbarët serbë linin kokën dhe armët e tyre.

Komandanti dhe zëvendëskomandanti i Zonës Operative të Pashtrikut, Tahir Sinani e Sadik Halitjaha, i dhanë mbështetje morale e logjistike njësitit *Syri i Shqiponjës*. Ardhja e komandant Tahir Sinanit i dha shpirt e moral të lartë gjithë Zonës Operative të Pashtrikut dhe mbarë UÇK-së. Përvoja dhe gatishmëria e tij e një ushtaraku profesionist ndryshoi rrjedhën e luftimeve, duke kombinuar format e luftimit frontal me aksione të rrufeshme të njësiteve të vogla elite të UÇK-së kundër forcave ushtarake e policore serbe.

Baza në Ilirion

Fshati Ilirion ishte halë në sy të forcave pushtuese serbe. Në këtë fshat ishte vendosur baza e parë e

UÇK-së në rrethin e Therandës. Gati nuk kishte ditë që ky fshat nuk granatohej nga serbët me armatim të rëndë nga pozicionet e tyre në Therandë, Shirokë, përballë Gurrës, pranë Taraxhës dhe nga ana e Rahavecit. Pas një ofensive të madhe serbët arritën ta marrin përkohësisht nën kontroll fshatin Ilirion. Me ditë të tëra ushtria serbe granatoi fshatin. Nuk kishte pëllëmbë toke që nuk ishte qëlluar me topa, minahedhës, tanke e armë të ndryshme. Serbët dogjën fshatin, vranë disa të moshuar të palëvizshëm dhe plaçkitën gjithçka. Ishim të detyruar të tërhiqeshim në pozicionin mes Ilirionit e Pagarushës.

Serbët kishin vendosur tanket në dalje të fshatit dhe herë pas here granatonin pozicionet tona.

Me Nezir Kryeziun e Xhavit Bajraktarin vendosëm t'i sulmojmë pozicionet serbe pranë lagjes Gallopen. Pas një vëzhgimi të detajuar, vendosëm t'i godisnim serbët herët në mëngjes. Siguruam dy snajperë të prodhimit jugosllav; njërin e mbaja unë dhe tjetrin Neziri. Xhaviti mbante një automatik dhe një palë dylbi, me të cilat vëzhgonte çdo lëvizje të serbëve. U vendosëm në një pozicion pranë tyre, nga mund t'i qëllonim pa na vënë re. Një moment pamë në syrin e snajperit dy ushtarë serbë, që po bisedonin pranë tankut të tyre. Sigurisht ata bënin ndonjë plan për të filluar granatimin mbi pozicionet tona. Ata granatonin tërë ditën, ndërsa në mbrëmje barrikadoheshin dhe nuk lëviznin.

Me Nezirin qëlluam të dytë përnjëherësh vetëm në njërin ushtar serb, atë që na u duk më i lartë në gradë dhe më i madh në trup. Eprori serb u plandos përtokë, ndërsa ushtari tjetër u fut me shpejtësi në një shtëpi pranë.

Serbët u befasuan nga sulmi i papritur dhe filluan të shtinë si të çartur me breshëri armësh të kalibrave të ndryshëm në drejtimin nga kishin ardhur krismat e snajperëve tanë. Mali ku u strukëm digjej flakë nga breshëria e makinerisë luftarake serbe.

Snajperët efektivë

Çdo ardhje e re në radhët e UÇK-së na gëzonte dhe na jepte moral për të vazhduar edhe më të fortë luftën kundër pushtuesit. Në dimrin '99 hynë nga Shqipëria disa oficerë shqiptarë, që kishin shërbyer në ish- armatën jugosllave. Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm një numër i tyre u caktua në Komandën e Brigadës 123, ku shërbyen me nder deri në mbarim të luftës.

Në atë kohë në Brigadën 123 erdhi edhe një oficër tjetër, që kishte dezertuar nga armata serbe derisa ishte në pushim. Quhej Shefkat Halimi nga ana e Sharrit, një djalë truphollë dhe i zbehtë në fytyrë. Ashtu siç ishte në uniformë ushtarake të ushtrisë jugosllave, duke u kthyer nga pushimi kishte pyetur disa vendas në qendër të Therandës se ku ishte UÇK-ja. Meqë Shefkati ishte në uniforme të armikut, ushtarët tanë shprehën dyshime për të. Iu afruam bashkë me Nezirin. Nga thjeshtësia e qëndrimi dukej shumë i gëzuar, që tani ndodhej në radhët tona për t'i shërbyer atdheut. Kaçurreli ia kërkoi kapelën.

- Po, me dëshirë, – hoqi kapelën dhe ia dorëzoi atij. Hoqi edhe emblemën serbe dhe vuri emblemën e UÇK-së.

Në fillim biseduam për vlerësimin e tij për armatën serbe, moralin e saj dhe forcat ushtarake. Ndërkohë e pyetëm edhe për shkathtësitë e profesionit të tij. Ai na njoftoi se ishte specialist i rregullimit dhe centrimit të snajperëve të prodhimit jugosllav. Unë dhe Kaçurreli kishim siguruar më herët nga një snajper të tillë.

Snajperistët efektivë: Ilaz Kadolli e Habib Elshani.

- Merri këta dy snajperë dhe shih a janë në rregull, – i thamë. Shefkati i mori snajperët, siguroi një mengene dhe bashkë me dy ushtarë të tjerë u largua në një vend të përshtatshëm për t'i provuar e rregulluar. Pas një kohe erdhi i gëzuar që kishte rregulluar snajperët:

- Tani janë të sigurt qind për qind.

- Mirë, po të besojmë, por duhet t'i provojmë, – i thashë. Së bashku me Kaçurrelin, Shefkatin, Emri Gashin dhe 2-3 ushtarë të tjerë të njësitit u nisëm nga fshati Kastër në drejtim të Semetishtit e Peqanit të Vogël. Kështu edhe Shefkatin e angazhuam në njësitin *Syri i Shqiponjës*.

Ai as nuk paramendonte që ne kishim qëllim t'i provonim snajperët drejtpërdrejt mbi forcat serbe. Kaluam fshatin Peqan dhe iu ofruam rrugës kryesore që lidhte fshatin Rreshtan me Therandën. Siguruam një pozicion në fund të vreshtave, të mbuluar mirë me akacie të dendura. Shefkati me ushtarët e tjerë qëndronte në prapavijë rreth 50 metra. Si me porosi, para grykës së snajperëve tanë u ndal një automjet i policisë serbe, që vinte nga Theranda në drejtim të fshatit Rreshtan. Aty ishin tre policë, që një kohë nuk zbritën nga makina, sa për të na dhënë afat t'i futnim në shënjestrën e snajperit. Me Kaçurrelin u morëm vesh të qëllonim të dytë policët në ulëset e para. Ata ishin në vijë të drejtë dhe jo shumë larg nga ne. Shiheshin qartë duke biseduar, sepse deri atëherë nuk i kishte shqetësuar askush. Shtëpitë e familjes së Ilmaz Papajt në Rreshtan i kishin bërë si të vetat. Tejqyra e snajperit na i afronte aq shumë, sa dukej se nuk ishin më larg se 30 metra. Qëlluam të dytë përnjëherësh. Njërit polic iu var koka në timonin e automjetit dhe nuk lëvizi fare. Dy të tjerët dolën me shpejtësi nga vetura dhe u futën në oborr pas murit ose hynë në shtëpi. Shefkati, i cili qëndronte prapa nesh, tha i habitur: A kështu i provoni ju snajperët!

- Prit edhe pak, - i thamë.

Me Kaçurrelin qëndruam edhe një kohë në pozicion. Ishim të sigurt që dy serbët e ikur do të kthenheshin për ta marrë trupin e shokut të vrarë. Pas nja 15- 20 minutash dy policët dolën shpejt nga shtëpia, kapën për krahu të vrarin dhe e tërhoqën zvarrë nga makina. Në hyrje të derës së shtëpisë ua shkrepëm edhe disa snajperë. Policët serbë hynë zvarrë dhe me plumba shpine në shtëpinë e familjes Papaj në Rreshtan.

Filluan të shtinë në panik në drejtimin tonë, edhe pse nuk na shihnin. Me Shefkatin, Emriun dhe ushtarët e tjerë u tërhoqëm ngadalë në drejtim të Peqanit të Vogël dhe bazës sonë në Kastër.

Në mbrëmje u njoftua se në fshatin Rreshtan ishin vrarë disa ushtarë serbë.

Me Mixhën nëpër Dukagjin

Veteranët e Lëvizjes dhe të UÇK- së gjatë tërë luftës, por edhe më herët, kishin bartur barrën kryesore. Konfrontimi direkt i armatosur me serbët ishte kurorëzim i të gjitha përpjekjeve e sakrificave gjatë dekadave me radhë. Pothuajse në të gjitha zonat e luftës, sidomos në fazën fillestare, veprimet luftarake drejtoheshin nga veteranë të sprovuar të Lëvizjes Popullore të Kosovës. Njëri nga ta ishte edhe veterani i LPK- UÇK- së, Muharrem Dina- *Mixha*. Që nga viti 1981, Mixha asnjëherë nuk kishte pushuar së vepruari në shërbim të çlirimit të vendit. Mixha ishte vetë UÇK- ja. Pjesëmarrja e tij në celulat e para të ushtrisë sonë kishte pasur ndikimin e simbolikën e vet. Prania e tij në luftë shtonte sigurinë për pastërtinë e luftës

dhe moralin tek ushtarët e rinj, për shkak të përvojës dhe moshës që kishte. Kushdo që ka pasur fatin ta njohë Mixhën, ka ruajtur kujtimet më të dashura gjatë gjithë kohës së luftës. Me qëndrimin e tij burrëror ai gjente kurajë e moral, shpeshherë edhe me humorin e tij plot kripë, për t'i tejkaluar edhe situatat më të rënda të luftës. Edhe pse më i moshuari ndër ne, ai ishte plot forcë e energji dhe nuk ndalej natë e ditë së vepruari kundër forcave pushtuese serbe.

Në mars 1999 dolëm me Mixhën t'u ofroheshim pozicioneve serbe tek ura e Rreshtanit. Ata kishin zënë një pozicion të rëndësishëm dhe mbanin në vëzhgim atë udhëkryq. U afruam në kodrën e parë pranë Peqanit të Vogël. Nga aty shihej si në pëllëmbë të dorës gjithë rrethi i Therandës dhe një pjesë e Prizrenit. Përmes dylbive shihej flaka e tymi që dilte nga fshatrat përreth. Pothuajse nuk kishte fshat që nuk digjej nga barbarët serbë. Nëpër rrugën nga Duhla drejt Prizrenit e Kukësit shiheshin kolona të gjata të refugjatëve nga dhuna e masakrat serbe. Në çaste të tilla ishte vështirë të përmbaheshe nga trishtimi. Në atë çast i thashë Mixhës:

- Ç'po ndodh kështu, o Mixhë?

Ai tha me të qeshur:

- Pasha mixhën, kurrë më mirë nuk ka qenë! Thonë se tymi e flaka edhe në ëndërr dalin mirë. Ky vend 100 vjet është helmuar nga serbët, edhe gjaku na është përzier... Le të digjet pushtimi dhe çdo gjë të ndërtohet nga e para!

Edhe Mixha ndiente dhimbje, sidomos për fëmijët e gratë që iknin në drejtim të Shqipërisë:

- Le të shkojnë, edhe luftë, edhe fëmijët nëpër këm-

bë është vështirë. Do të luftojmë më lehtë kur ata të jenë të sigurt në Shqipëri. Porsa të përfundojë lufta, ata do të kthehen të gjithë!

Dhe koha i dha të drejtë Mixhës.

Të nesërmen shkuam me Mixhën në Zonën Operative të Dukagjinit. Rrugën e gjatë nga Kastra për atje e bëmë në këmbë, sepse udhëtimi me makinë ishte me rreziqe të mëdha, mund të binim në ndonjë pritë të armikut.

Rreth orës 11 arritëm në Komandën e Zonës Operative të Dukagjinit, në Shqiponjë. Fshati ishte bërë shkrumb e hi nga lufta. Në shumë pjesë të fshatit ende dilte tymi dhe ndihej era e barutit. Në skaje të rrugëve shihej edhe ndonjë mbetje e makinerisë së djegur serbe. Kjo skenë tregonte se në atë zonë kishte pasur luftë të vërtetë kundër okupatorit serb.

Disa ushtarë na treguan bazën e komandës. Ishte një shtëpi e vogël njëkatëshe, pa kulm, por me një pllakë betoni që kishte mbetur pa u dëmtuar. Si gjithherë i gëzuar dhe i qeshur, na priti Emrushi- *Kompjuteri* i UÇK- së dhe prapa tij Gafurr Elshani.

- Kjo është komanda juaj?! – u tha Mixha.

Çdo gjë ishte nxirë nga zjarri e tymi. Rreth dhomës ishin disa krevata hekuri që shërbenin si karrige. Në atë çast u dëgjua jashtë zëri i Komandantit të zonës. Në hyrje të shtëpisë së djegur nga lufta u duk vetë Ramush Haradinaj, i veshur komplet me uniformë ushtarake. Në dorë mbante një automatik me grykë të gjatë, ndërsa në krah një mortajë dore "Zola" të prodhimit jugosllav. Ende pa nxjerrë asnjë fjalë nga goja, shkrepi një rafal. Tymi e era e barutit u përzien me shkrumbin e djegur të dhomës. Ramushi na

dëshiroi mirëseardhje me këto fjalë:

- Mos ma shihni për të madhe, e bëra në shenjë nderimi për komandantët e Pashtrikut dhe shokët e mi të moçëm, Ilazin dhe Mixhën.

Dikush tha me humor:

- Gati na vrave!

- Jo - tha Ramushi, - u gëzova për shokët!

U çmallëm pak. Koha nuk premtonte dhe duhej të ktheheshim në bazën tonë. Para se të largoheshim, Ramushit ia kërkova një kujtim nga Dukagjini, duke ia hedhur sytë mortajës së tij. Pa u hamendur fare, hoqi nga krahu mortajën: - Merre, e ke dhuratë nga unë dhe me siguri nuk do ta çosh huq asnjë predhë!

Nuk mund të ktheheshim pa takuar edhe Maliq Ndrecën, ose Komandant Maliqin, siç e quanin me simpati ushtarët.

Mala ishte nga ana jonë, nga Gurkuqi. Kishim dëgjuar për heroizmin e tij gjatë luftës dhe shpeshherë ishim interesuar të vinte tek ne. Mirëpo, Maliqi ishte mishëruar me ushtarët trima të Dukagjinit dhe nuk pranonte të ndahej prej tyre. Emrushi e Gafurri na përcollën deri në një lëndinë në dalje të fshatit Shqiponjë. Aty, si përshëndetje, provuam armët në një shenjë. Pastaj me Mixhën vazhduam në drejtim të Therandës, në bazën e Zonës Operative të Pashtrikut.

Ishte fat ta kesh Mixhën shok lufte dhe ta përjetosh luftën deri në fund me të, bashkë me fitoren kundër pushtuesit shekullor serb.

Takimi me oficerët amerikanë

Në mars 1999 njësiti *Syri i Shqiponjës* po kthehej nga një aksion afër fshatit Semetisht të Therandës. Atë ditë ofensiva serbe ishte shumë e ashpër dhe ishte shumë vështirë të mbroheshim nga bombardimet e mitralimet e ushtrisë serbe. Ata kishin zënë një pozicion strategjik në një kodër në hyrje të fshatit Semetisht dhe e kishin fshatin si në pëllëmbë të dorës, nuk lanë shtëpi pa granatuar. Shumica e ushtarëve tanë u tërhoqën në pozicionet rezerve, sepse ishte rrezik të vriteshin të gjithë. Njësiti *Syri i Shqiponjës* kishte shkuar aty me përforcime. Tërë ditën kishte qëndruar pothuajse ballë për ballë me tanket serbe. Ishim vetëm 6 ushtarë të ndarë në dy grupe. Nuk largoheshim shumë nga njëri- tjetri, sepse mund të shkëpusnim lidhjet. Më herët nga aty ishte larguar edhe një pjesë e spitalit ushtarak. Pranë ishin disa shtëpi të reja të pameremetuara, të rrethuara me mure të gjata me blloqe betoni. Të dy grupet e vogla të njësitit zunë pozicione prapa mureve, edhe pse ato nuk mund të përballonin predhat e tankeve. Muri rrethues i shtëpive ishte i lartë rreth 80 cm, ndërsa mbi blloqe betoni në lartësi mesatare deri 1,5 metra. Njërin nga ushtarët e porosita të kërkonte në shtëpitë pranë ndonjë mjet për shpimin e blloqeve të betonit. Për dy- tre minuta ushtari solli një kazmë, me të cilën hapëm shpejt disa vrima, nga ku mund të shihej gjithë hapësira në drejtim të forcave serbe, të pozicionuara para nesh jo më larg se 300-400 metra në vijë ajrore. Ne u pozicionuam mirë dhe ata nuk na shihnin. Tërë njësiti ynë aty kishte vetëm dy snajperë

të prodhimit jugosllav, disa kallashë dhe vetëm një mortajë dore me dy predha. Municion rezerv kishim vetëm atë në gjoksoret tona.

Sa herë serbët tentonin të lëshoheshin me këmbësori në drejtim të brendisë se fshatit, ne qëllonim me snajperë nga pozicioni ynë. Këtë e bënim me gjuajtje të rralla, ngase mund të zbulonin pozicionin tonë, por edhe të kursehej municioni. Nga pozicioni ynë shihej e dëgjohej çdo gjë para nesh. Katër tanke serbe ishin pozicionuar në kodër në formë zigzake në largësi 80- 100 metra nga njëra- tjetra dhe të maskuara nën disa dardha të moçme. Nga aty shiheshin eprorët dhe ushtarët serbë, të cilët pas çdo gjuajtje me tank mbi shtëpitë e fshatit, klithnin si të çartur: *Tako je!*(Ashtu duhet), ose *Pogodak!*(Goditje e saktë). Çdo shtëpie që qëllonin i dilte tymi e flaka. Pas shumë gjuajtjesh të fuqishme me orë të tëra, këmbësorët serbë tentonin të lëshoheshin në drejtim të brendisë se fshatit. Ne qëllonim vetëm me snajperë. Shihej qartë kur ndonjëri binte përdhe e nuk lëvizte më. Menjëherë afrohej tanku serb, e tërhiqte të vrarin dhe përsëri kthehej në pozicionin e mëparshëm. Rreth orëve të mbrëmjes serbët filluan të tërhiqen. Edhe ne mezi prisnim këtë, sepse ishim dërrmuar nga lodhja. Disa në këmbë pas tankeve dhe shumica të ngarkuar në mjete të blinduara, serbët u tërhoqën në drejtim të Peqanit të Vogël dhe Therandës. Pas disa minutash, duke kaluar shtëpi më shtëpi, ne të gjashtë ushtarët e njësitit u gjendëm pikërisht në vendin, ku kohë më parë ishin të pozicionuara katër tanke serbe. Vendi ishte i mbushur me gëzhoja të të gjithë kalibrave. Na tërhoqën vëmend-

jen sidomos gëzhojat e predhave të topave e tankeve. Njërën nga to e kapa në dorë dhe ajo ende ishte e nxehtë. Vetëm pak minuta më parë ato kishin vjellë zjarr mbi fshatin tonë. E afrova afër këmbës së majtë, duke e vendosur në pozitë vertikale. Predha e tankut serb, ashtu bosh, tejkalonte lartësinë e gjurit tim. E thirra Kaçurrelin, i cili gjithashtu po kapte me duar herë njërën, herë predhën tjetër.

- E sheh se ne po bëjmë mrekulli! I tërë municioni që kemi në njësit, mund të futet në këtë gëzhojë, – i thashë atij.

- E vërtetë!, - pohoi Kaçurreli.

Që të dytë morëm nga një gëzhojë të tillë dhe u larguam në drejtim të bazës sonë në fshatin Kastër.

Kur u kthyem takuam komandantin e Zonës Tahir Sinani dhe dy eprorë të Shtabit të Përgjithshëm. Ata ishin njoftuar më herët për qëndrimin tonë në atë zonë luftimi. Njëri nga ta më njohu dhe lëshoi një zë: *O Kadoll, a vetëm në ju paska mbetur kjo zonë!* Ushtari shoqërues ishte një veteran i plagosur në luftën e Kroacisë.

Kishim nevojë të pushonim pak dhe të merrnim veten. Baza e *Syrit të Shqiponjës* në fshatin Kastër nuk ishte më larg se njëqind metra nga Komanda e Zonës Operative të Pashtrikut. Dikush nga eprorët e Zonës më njoftoi se disa amerikanë kërkonin të takoheshin me mua. Mendoja se takimi ishte me interes të ndërsjellë. Ata tashmë ishin para bazës së njësitit *Syri i Shqiponjës*. Pesëdhjetë metra më larg vërehej një automjet i blinduar ngjyrë portokalli. U përshëndetëm me amerikanët në rroba civile, dy burra dhe një grua, që shërbente edhe si përkthyese. I

shikova me kujdes që nga këmbët te koka. Edhe nga pamja, edhe nga qëndrimi ishin amerikanë. Eprori i tyre hetoi shikimin tim dhe nga gjoksi nxori një dokument identifikimi. Pasi ndodhi kjo njohje e zakonshme në rrethana lufte, eprori më pyeti:

- Ju jeni komandant i njësitit?

- Jo, - i thashë - jam zëvendëskomandant i njësitit.

- Jeni ju zoti Kadolli?

- Po, - i thashë.

- Kam kënaqësinë që ju njoha!

- Gjithashtu, - u përgjigja.

Amerikani vazhdoi të pyeste:

- Po me profesion ç'jeni, çfarë grade ushtarake keni?

Duke qeshur u përgjigja se jam jurist dhe momentalisht vetëm ushtar i atdheut. Grada ushtarake ende nuk kemi.

- Si është e mundur që një jurist të udhëheqë një njësit special?! – u habit ai.

Nga biseda që zhvilluam kuptova se ai ishte i mirinformuar për veprimet e njësitit tonë në terrenet e luftimit dhe fliste me plot respekt për UÇK- në e luftën tonë çlirimtare.

Pas një bisede të dobishme dhe shkëmbimit të informacioneve për situatën në Zonën Operative të Pashtrikut, oficeri amerikan m'u drejtua me këto fjalë:

- Të qëndroni, lufta juaj do të jetë e fituar. Së shpejti edhe ne do të jemi krah jush në luftën kundër Milosheviçit. Ju si duket as vetë nuk jeni të vetëdijshëm se çfarë të mire po i sillni këtij populli dhe këtij vendi. Ju nuk i keni ditur të gjitha planet e rrezikshme të

Milosheviçit. Për një kohë të shkurtër shqiptarët do të mbeteshin pakicë në Kosovë nga terrori serb. Nga terrori dhe varfëria rinia juaj do të shpërndahej në të katër anët e globit. Ju keni shfrytëzuar shansin e fundit!

Sulmi pranë Therandës

Kaçurrelit i pata propozuar më herët të bënim një sulm pranë Therandës. Serbët kishin marrë një pikë strategjike në këtë anë. Ata ishin vendosur në trekëndëshin e rrugës Rreshtan- Semetisht dhe çdo ditë rrezikonin ushtarët tanë në atë pjesë. Serbët kishin bërë edhe shumë krime ndaj civilëve të pambrojtur në qytetin e Therandës dhe në disa fshatra përreth.

Qëllimi ynë ishte të hakmerreshim ndaj banditëve serbë edhe për masakrën ndaj familjes Berisha në qendër të Therandës, më 26 mars 1999.

Me Kaçurrelin vendosëm që goditja të bëhej në rrugën Therandë- Rreshtan, pikërisht në këtë rrugë nga furnizohej kjo bazë e rrezikshme serbe.

Kaçurreli më tha se më parë duhej të shkonte në shtëpinë e tij afër një baze tjetër të serbëve në hyrje të Therandës. Bagëtia e tij kishte mbetur mbi dy javë e ngujuar në ahur. Ato kishin mbijetuar vetëm me ujë, pasi më herët ua kishte lënë lëshuar rrjedhën e ujit.

Ishte mesi i natës kur iu ofruam me kujdes shtëpisë së Kaçurrelit në Therandë. Unë zura një pozicion të mirë në qoshe të shtëpisë dhe vëzhgoja lëvizjet e serbëve që bënin rojë në objektin e Shkollës teknike dhe në disa shtëpi përreth. Neziri u fut në ahurin e

bagëtive për t'i lëshuar ato. Qeni i shtëpisë lehte pa pushim. Si duket, serbët kishin nuhatur se diçka po lëvizte në afërsi të tyre. Ata shkrepën disa të shtëna në drejtimin tonë. U detyruam të qëndronim pa lëvizur pak kohë, për të mos u diktuar ku ishim.

Pastaj lëvizëm ngadalë për të zënë pritë në rrugën Therandë- Rreshtan, aty ku kishim planifikuar sulmin. Papritmas në rrugën Therandë- Rreshtan lëviz një autoblindë. Ajo u ndal një moment para dyerve të Shkollës se mesme teknike pranë varrezave. Nga dritat e autoblindës pamë policët serbë që bënin rojë. Ata këtë shkollë e kishin shndërruar në bazë të tyre. Iu thashë ushtarëve të zinin pozicionet, sepse autoblinda serbe do të lëvizte në drejtimin tonë. Serbët kishin nuhatur më herët se diçka po lëvizte në afërsi të tyre, por nuk e dinin që mu në mes të rrugës po i priste vdekja. Pasi u konsultuan disa minuta me policë të tjerë në hyrje të shkollës, autoblinda u kthye në të djathtë për në rrugën Therandë- Peqan dhe lëvizte me shpejtësi. Serbët ishin mbushur taksirat, sepse kishin vrarë shumë civilë të pafajshëm deri atë natë marsi 1999.

Nuk kishim kohë për të zënë pozicione të mira, sepse vendi ishte shumë i hapur. U fshehëm pas një fidani kumbulle, i lartë vetëm gjysmë metri, ndërsa ushtarët e tjerë u maskuan nëpër fijet e barit në livadhin pranë rrugës. Atë natë, përveç automatikut, mbaja edhe antitankun e prodhimit jugosllav, që ditë më parë ma pati dhuruar Ramush Haradinaj. Autoblinda po afrohej me shpejtësi. Unë qëndroja pas fidanit të vogël, ndërsa Kaçurreli 10- 15 metra larg meje. Ai ishte në kikërr të lëndinës, ndërsa tre

ushtarët e tjerë, Rexhep Gashi, Nevzat Kryeziu dhe Xhavit Kicaj, qëndronin disa metra prapa nesh. Ata kishin vetëm automatikë, që nuk bënin punë kundër autoblindës. I ndërruam shpejt armët me Kaçurrelin. Ai kishte dëshirë të qëllonte me "Zolën" e prodhimit jugosllav, ndërsa unë kisha përvojë të mirë me mortajat kineze. Unë isha në pritën e parë, vendosa mortajën në pozicion krahu dhe prisja me padurim autoblindën serbe që po afrohej me shpejtësi. Dritat e saj të forta më ranë në sy. Nga dhjetë metra largësi qëllova autoblindën mu në pjesën ballore. I tërë vendi përreth u ndriçua nga flaka e verdhë që kaploi autoblindën serbe. Ky spektakël kurrë nuk më hiqet mendsh. Autoblinda humbi drejtimin dhe u rrokullis në një hendek pranë rrugës. Brenda saj shpërthyen piskamat serbe. Kaçurreli u avit pranë autoblindës së shkatërruar dhe qëlloi mbi të me zolën jugosllave. Autoblinda vazhdoi të digjej. Për t'u siguruar që asnjë të mos mbetej gjallë, u afruan edhe tre ushtarët e tjerë të njësitit dhe shtinë me rafale automatiku mbi çdo lëvizje brenda saj.

Ndoshta pse ishte natë, jehona e krismave të armëve tona u dëgjua shumë larg. Ishte kënaqësi e madhe të përjetosh këso çastesh, duke parë armikun në grykë të pushkës. Atëherë të shfaqen para sysh të gjithë shokët dëshmorë, të gjitha të zezat që i përjetoi populli ynë. Atëherë sikur të gjithë të rënët të thonë: Bjeri shkaut he të lumtë pushka!

Gjashtë policët serbë u shkrumbuan bashkë me autoblindën e tyre. Për çudi, nuk u ndien gjallë as shokët e tyre në objektin e shkollës dhe në disa shtëpi përreth. Si duket, ata ishin fshehur si minjtë në

biruca dhe nuk u binte ndër mend as për shokët në autoblindën e hedhur në erë.

Ngadalë dhe të sigurt u tërhoqëm në një pozicion tjetër, nja 100 metra nga vendi i sulmit, për të vëzhguar situatën. Në radiolidhje paraqitet baza e Zonës Operative të Pashtrikut në Kastër. Dy herë u dëgjua zëri i tyre: *Baza për Syrin e Shqiponjës*. Hapa radion dhe u përgjigja: *Marrje nga Syri i Shqiponjës*.

- Si qëndron puna në Therandë?

- Për shqiponjat mirë, - u përgjigja, ndërsa serbët morën atë që kërkuan!

Pas afro gjysmë ore, nga fabrika "Ballkani" dhe nga stacioni policor erdhën përforcime të shumta serbe për t'i tërhequr të vrarët. Nga frika se mund të pësonin të njëjtin fat, ata gjatë tërë rrugës shtinin në mënyrë të pakontrolluar. Ne tanimë nuk kishim predha për t'i goditur përsëri dhe u tërhoqëm të sigurt në bazën e njësitit në Kastër të Therandës.

Si na shpëtoi kriminel Mishki?

Milorad Nisheviç-Mishki, një serbo- malazias, shef i UDB- së për komunën e Therandës, pa dyshim ishte njëri ndër kriminelët kryesorë dhe më në zë në këtë anë. Me urdhrat e tij, në komunën e Therandës janë kryer shumë krime ndaj shqiptarëve, sidomos gjatë luftës 1997- 1999. Ai bashkë me "udbashët" vendës Ilaz Vranovci nga Taraxha dhe Sahit Zogaj nga Zogaj i Malishevës nuk kanë lënë të zezë pa bërë kundër qytetarëve shqiptarë dhe familjeve më në zë në këtë anë, vetëm për t'ia zgjatur jetën sa më shumë okupimit serb në Kosovë. Janë të njohura bëmat e tyre

prej spiunëve e tradhtarëve, për ndjekjen, zbulimin, arrestimin dhe torturimin e qindra të rinjve shqiptarë nga rajoni i Therandës, Prizrenit e Rahavecit që nga viti 1981 e këndej, vetëm pse kërkonin me rrugë paqësore Republikën e Kosovës dhe të jenë të lirë e sovranë në vendin e tyre.

Me urdhrat e këtyre kriminelëve, vetëm gjatë luftës se fundit në rajonin e Therandës, Rahavecit e Prizrenit u vranë mbi 2500 qytetarë shqiptarë, të gjithë civilë të pambrojtur, në mesin e të cilëve edhe foshnja e fëmijë të mitur, të rinj, burra, pleq e gra shtatzëna, që në asnjë formë nuk ishin pjesë e luftës. Të gjitha këto krime qenë bërë në mënyrë të programuar për të zbatuar politikën serbe të spastrimit etnik të shqiptarëve nga Kosova.

Të gjitha këto krime të kryera në këtë anë ndaj civilëve ishin fakte të pamohueshme që urdhërdhënësit e kryesit e tyre të pësonin ndëshkimin e merituar.

Në zonën tonë të luftës kishim vendosur që krimi të goditej mu në kokë. Mishki ishte ai që furnizonte me informacione ushtrinë e policinë serbe dhe rrezikonte formacionet tona në terrenet e luftimit. Paraprakisht kishim njohuri për vendndodhjen e tij. Ai banonte në një ndërtesë në qendër të qytetit të Therandës, pranë rrugës që shpinte për në ambulancën e qytetit.

Ishim vetëm pesë ushtarë: *Kaçurreli, Graniti, Emriu dhe Maku*. Siguruam armët e nevojshme dhe nga Kastra u nisëm në orët e mbrëmjes. Kur ra terri dhe nuk vëreheshim më, kaluam këmbë në drejtim të Semetishtit e Peqanit të Vogël për t'iu afruar qytetit

nga ana e vreshtave, aty ku sot kalon autostrada e kombit. Para se të hynim në qendër të qytetit, u ndalëm pak për të vëzhguar situatën dhe për të pushuar disa minuta. Ishte natë dhe nuk dëgjohej asgjë. Për çudi, atë natë nuk dëgjoheshin as të lehurat e qenve, të zakonshme kur kalohet natën nëpër oborre a rreth shtëpive. Nuk vërehej as edhe drita më e vogël. Si duket, gjithë qyteti ishte boshatisur nga popullata, që kishte ikur ditë më parë nga terrori e masakrat serbe. Vrasja masive e familjes Berisha kishte bërë të realizohej synimi i fashistëve serbë. Nga drejtimi i Duhlës, Bllacës e Biraçit vinin kolona të gjata civilësh, që po iknin në drejtim të Shqipërisë. Një kohë vëzhguam situatën me shpresë se kolona do të ndalej. Qëndronim në një kodër të vogël duke shestuar depërtimin në qendër të qytetit. Graniti ishte ulur në një batanije, që e mbante të lidhur pas shpine. Dëgjova Emriun, që zakonisht bënte humor, duke murmuritur diçka me vete ose me Makun.

- Ç'ke Emri?" – i thashë.

- Jo asgjë, vetëm thashë me vete, si është ky Graniti, që kaq gati i rri vetes. Ç'i duhej kjo që po mban kot në krah? Tani po kuptoj se e paska marrë për ta mbrojtur prapanicën! Filluam të qeshnim, por me zë të ulët, ngase mund të diktoheshim nga serbët, që zakonisht rrinin të fshehur nëpër shtëpitë përreth qytetit.

Graniti ia ktheu:

- Nuk ka nevojë t'ju përkujtoj se në aksione mund edhe të plagosemi, edhe të vritemi. E sheh, je bërë si kalë dhe ty s'të lëvizin as katër veta! Për këtë mbaj batanijen. Nëse plagosesh, për të të tërhequr zvarrë.

- Pse unë të plagosem? Përse nuk thua për vete, por bash për mua?! Emriut atë natë nuk i ndezi mahia. U vrenjt në fytyrë duke luajtur kokën.

Vazhduam drejt qytetit, nëpër rrugën përmes varrezave, ndërmjet lagjeve të Kuqëve e Gashëve, në drejtim të lumit. Njësiti u pozicionua në rrugën kryesore, në qendër të Therandës, pranë një shtëpie njëkatëshe të ndërtuar me gurë, që më herët e quanin depo e vjetërsirave. Përballë saj ishte një mur betoni për mbrojtjen e rrugës. Hyrjen e ndërtesës që synonim e kishim si në pëllëmbë të dorës dhe nuk mund të na shpëtonte asnjë lëvizje. Sipas informacioneve, Mishki zakonisht kthehej në atë kohë nga puna.

Dy-tri metra para nesh ishte rruga kryesore. Kolonat me civilë të trishtuar nga frika dhe të lodhur nga uria vazhduan pothuaj tërë natën. Ato përcilleshin edhe nga ndonjë eskortë e policisë serbe. Edhe njësiti *Syri i Shqiponjës* përcillte çdo lëvizje përmes grykës se automatikëve. Kishim mundësi të qëllonim dhe t'i vrisnim lehtë policët serbë. Pas shumë orë pritjeje, kolonat me civilë që po iknin në drejtim të Shqipërisë, nuk kishin të ndalur. Çdo veprim yni i pamatur në ato rrethana nënkuptonte vrasjen masive të civilëve. Pas pak fillonte të zbardhte dita. Njësiti u detyrua të tërhiqej në bazë, pa kryer punë. Kurrë as nuk kisha paramenduar që kriminelët serbë të viheshin para grykës se automatikëve tanë dhe të mos qëlloheshin. Në luftë ndodhin shumë të papritura.

Aksioni në Ilirion

Në prill 1999 njësiti *Syri i Shqiponjës* ndodhej në fshatin Kastër, ku ishte edhe baza e Zonës Operative të Pashtrikut. Përgjegjësi i logjistikës Ukë Morina (daja Ukë) kishte përgatitur kafjallin. Atë mëngjes dukej i disponuar:

- Merrni nga pak bukë e djathë, - na tha, kur të ktheheni nga aksioni do t'ju përgatis diçka më të mirë. Kuptohet, nëse vrisni më shumë derra! Fjalën e kishte për kriminelët serbë.

U pajtuam që pas aksionit daja Ukë të na përgatiste mish, madje edhe ndonjë gotë verë, edhe pse nuk kishim ndonjë pasion të veçantë për pije.

Disa ditë më herët i pata propozuar Kaçurrelit një aksion tjetër. Menjëherë u shpreh i gatshëm, duke pyetur për vendin. I tregova se para disa ditësh kishim vëzhguar me Xhavitin në hyrje të fshatit Ilirion. Në fund të fshatit ishte një zabel dhe dushku sapo kishte filluar të mugullonte. Prilli gati gjithmonë ka qenë në anën e shqiptarëve. Kishim kaluar një dimër të egër dhe mezi prisnim pak gjelbërim. Kjo nuk ishte mirë për serbët, sepse çdo rrugë e kaçubë dushku ishte vdekje për ta. Siguruam armatimin dhe caktuam ushtarët për aksion. Kësaj radhe patëm aq shumë kërkesa për aksion, sa një numër i ushtarëve filluan të ankoheshin, që rrallë u binte të përballeshin me armikun. Planin e operacionit e bëmë një natë më parë, që aksioni përsëri të bëhej në tri prita njëkohësisht. Përgjegjës të tri grupeve u caktuam së bashku me Kaçurrelin dhe Lumni Bugarin (Lumi).

Me të rënë nata lëvizëm drejt fshatit Gurrë. Te

mulliri, në anën lindore të Grapit, kaluam nëpër një luginë të përshtatshme për maskim dhe lëvizje të sigurt. Në shumë raste ia tërhiqja vërejtjen Kaçurrelit të lëviznim më të sigurt, ngase ai zgjidhte shtigjet më të shkurtra për në vendin e caktuar.

Rreth orës 4 të mëngjesit më 24 prill 1999 mbërritëm në fund të fshatit Ilirion. Ishte një vend i mrekullueshëm për t'i shkatërruar kriminelët serbë. Kishte pak gjelbërim dhe rruga ishte me disa kthesa të mëdha, ku serbët nuk mund të lëviznin me shpejtësi, ndërsa ne mund t'i goditnim më lehtë. Si të porositura për istikame, fshatarët kishin ngritur mure të gjera prej guri për të mbrojtur vreshtat e tyre.

Ishim gjithsej 12 ushtarë. Në pozicionin e parë u vendosa unë bashkë me ushtar Makin. Unë kisha automatik, ndërsa Maki mbante edhe mortajën e prodhimit kinez, që ma kërkoi me ngulm. Kishte dëshirë që ai të shtinte drejtpërdrejt mbi ushtarët dhe policët serbë.

Në pritën e dytë u vendos Kaçurreli, emër që ia kishte vënë Komandanti i Zonës Tahir Sinani. Kjo ishte vetëm një nofkë, ngase Neziri as ishte kaçurrel, as nuk kishte fare flokë. Ishte tullac dhe rrallëherë hiqte kapelën nga koka.

Pak më larg, rreth 30-40 metra, u vendos prita e tretë. Përgjegjës i saj u caktua Lumni Bugari (Lumi), i cili kishte përvojë të mirë në aksione. Në këtë grup ishte edhe ushtari Nebih Berisha nga Gjinoci dhe Naim Tarjani nga Pirana e Prizrenit.

Dy përgjegjësit e pritave, Kaçurreli dhe Lumi, përveç automatikut mbanin edhe nga një mortajë dore të prodhimit kinez. Kësaj radhe në aksion

kishim angazhuar për herë të parë edhe dy ushtare femra, Pranverën e Afërditën, që në rast të plagosjes së ndonjë ushtari t'i jepnin së paku ndihmën e shpejtë. Ato qenë vendosur në prapavijë, në një vend të përshtatshëm, rreth 50 metra nga vendi i pritës.

Diku rreth orës 8 të mëngjesit vëzhguesit na njoftuan për lëvizjet e forcave serbe. Ramadan Hoti dhe Shefki Hodaj kishin dëgjuar një uturimë të madhe të automjeteve që vinin nga Ilironi në drejtim të Therandës. Nga dendësia e malit nuk mund të identifikonin numrin dhe llojet e tyre. Pas disa minutash para nesh u shfaqën dy automjete: njëra ishte autoblindë që siguronte rrugën, ndërsa prapa i vinte një kamion i ngarkuar plot me miell. Banditët serbë kishin grabitur edhe rezervat e fundit në fshatin Ilirion. Thasët e miellit ishin ngarkuar kryqazi, sa tejkalonin edhe anësoret e kamionit. Kaçurrreli më thirri:

- Ilaz, lëshoma mua, mos ma prek autoblindën e parë, ti prite kamionin!

Ashtu edhe vepruam. Nga rruga ku kalonte kolona serbe ishim vetëm dy- tri metra larg. Pothuajse njëkohësisht qëlluam të dy pritat. Kaçurreli qëlloi autoblindën me mortajën e tij. Kamioni nuk kishte nevojë të qëllohej me murtajë, por Maki e qëlloi me të. Në të njëjtën kohë edhe unë zbraza një karikator automatiku mbi trupat serbe. Kamioni me policë u përplas rreth pesë metra nga rruga dhe i doli tymi i zi. Në atë moment më thërret Kaçurreli:

- Eja shpejt! Nuk dija ç'kishte ndodhur, por vrapova drejt tij.

- Shih! - më tha. Nja dy metra para këmbëve të

Kaçurrelit pashë një serb, i cili kishte humbur kontrollin nga goditja e fuqishme dhe në vend se të ikte nga ana e kundërt, ai po vinte drejt në kthetrat e shqiponjës. Ishte një trupmadh, me kokë të madhe e të rruar, ndërsa fytyrën e ngjyrosur me të zezë. Shkau mbante në dorë edhe një bombë. Porsa u afrua pranë këmbëve tona, Kaçurreli zbrazi tre- katër plumba në kokën e tij. Krimineli serb ra sa gjerë e gjatë para këmbëve tona. Porsa përfunduam me të parët, mbi kokat tona filluan të vinin breshëri plumbash. Nuk kishim vërejtur se në kolonën serbe ishte edhe një autoblindë tjetër. Rreth 40 metra larg nesh ishte ndalur një autoblindë e policisë serbe. Sipër autoblindës sillej gryka e mitralozit. Nga frika ata ishin strukur brenda autoblindës dhe jashtë mbanin vetëm duart e mitralozin, që e lëviznin pa shënjestër e kontroll.

Kaçurreli më bëri shenjë të ulja pak kokën, ngase drejtimi i gjuajtjes ishte kah pozicioni im. E mbushi për së dyti mortajën e dorës dhe qëlloi mu në ballë autoblindën, që e kaploi flaka. Serbët nuk u ndien gjallë.

Pas sulmit të rrufeshëm dhashë urdhër për tërheqje. Ushtarët e njësitit u tërhoqën jo larg nga vendi i pritës. Unë u tërhoqa i fundit, pak për shkak të rregullave, por edhe ngase këmbët m'u ngatërruan për rripin e automatikut dhe u rrëzova përtokë. Dikush nga ushtarët bërtiti:

- U plagos komandanti! Ata kishin dëgjuar breshëritë e mitralozëve serbë, që vinin prej disa shtëpive të reja në fund të fshatit Ilirion. Iu afrova ushtarëve të njësitit. Lumin e kishte mbuluar gjaku në fytyrë e trup. E pyeta në ishte i plagosur.

- Pak, - më tha. E kisha shumë afër autoblindën dhe pasi e godita, nga vala e përcëllimës së predhës copat e thërrmijat e saj më ranë në fytyrë e trup, por nuk është rrezik. Ushtarët në prapavijë u afruan dhe ia pastruan gjakun e plagët Lumit. Pastaj të sigurt e të gëzuar për suksesin e aksionit, vazhduam rrugën drejt fshatit Kastër. Ishte zakon që në raste të tilla të shkrepnim nga një batare dhe të këndonim ndonjë këngë lufte. Një grup i ushtarëve të rinj, që ishin duke pushuar në një luginë te Lipat, mes Ilirionit e Gurrës, nuk kishin besuar se ishim shqiptarë, ne që edhe po shtinim me armë, edhe po këndonim. Ata edhe kishin lënë një dele të gatshme për ta pjekur, duke u larguar në pozicione.

- Merreni këtë! - na thanë, porsa u bindën se jemi të *Syrit të Shqiponjës*. Kishim edhe rreth gjysmë ore për të mbërritur në bazën e Zonës Operative të Pashtrikut. Komandanti i Zonës Tahir Sinani kishte organizuar pritje për ne. Para Komandës kishte rreshtuar ushtarët për nderime ushtarake:

- Ju lumtë pushka, djema!

Ushtarët e tjerë na përgëzuan me fitore të reja. Për aksionin dhe sukseset e *Syrit të Shqiponjës* në fushëbetejat e luftës komandanti Tahir Sinani i raportoi përmes telefonit satelitor Radio-Televizionit të Prishtinës që vepronte në Tiranë. Aksionet e tilla të rrufeshme shtonin tek ushtarët tanë moralin për luftë, ndërsa tek forcat armike tmerr e panik. Të nesërmen e aksionit serbët u larguan nga Ilirioni të dërrmuar e turpëruar. Sipas raporteve të vetë serbëve, atë ditë ishin vrarë tre ushtarë, pa përmendur të plagosurit. Serbët pranuan se në hyrje të fshatit Ilirion kishin mbetur të vrarë dhe të

plagosur shumë ushtarë dhe oficerë serbë. Sipas raportit të njësitit *Syri i Shqiponjës*, atë ditë më 24 prill 1999 nuk kishte shpëtuar asnjë ushtar serb.

Ushtarë serbë të vrarë në rrethin e Therandës.

Shumica e tyre ishin eliminuar bashkë me tri makinat e blinduara të bëra shkrumb e hi, ku në secilën sosh mund të kishte së paku nga 5-6 ushtarë.

Përgjegjësi i logjistikës se njësitit, daja Ukë, pas kthimit në bazë, si gjithherë i qeshur, u shpreh: Tani e meritoni një drekë të mirë! Dhe vërtet atë pasdite ai kishte pjekur në furrë një tepsi me mish, që e përfshimë sa çel e mbyll sytë.

- Mos nguteni, - tha daja Ukë, tani nuk jeni në aksion, këtu jam unë. Mos më thirrni atje ku kërcet pushka, sa për bukë e për mish jam specialist!

Rënia e dëshmorëve Fetah Gega e Xhavit Bajraktari

Që në fillim të luftës kemi qenë të vetëdijshëm dhe të përgatitur se lufta jonë çlirimatare do të jetë e vështirë, se kërkon sakrifica dhe se liria fitohet vetëm me gjak. Sa herë në luftë humbnim shokët e bashkëluftëtarët, për ne ishte një goditje e rëndë, ndoshta më e madhe se humbja e ndonjë anëtari të familjes.

Lufta na lidhi edhe më shumë me shokët. Xhaviti dhe Fetahu ishin ndër ushtarët e parë që u rreshtuan në radhët e UÇK- së. Që të dytë, edhe më herët para luftës, ishin veprimtarë të Lëvizjes Popullore të Kosovës. Ishin rritur në familje dhe në një rreth, ku pushtuesi serb kundërshtohej jo vetëm me fjalë, por edhe me veprime konkrete. Familjet Bajraktari nga Vneshta dhe Gegaj nga Gurra e Therandës janë shquar gjithherë për tradita kombëtare e atdhetare. Xhavitin e kisha pranë gjatë gjithë kohës së luftës, deri në rënien e tij. Me të kisha kontakte edhe para luftës. Shtëpia e Bajraktarëve në Vneshtë ishte një nga bazat kryesore të Lëvizjes Popullore. Në atë shtëpi para lufte shpeshherë mbante takime ilegale Këshilli i rrethit të LPK- së në Therandë, veprimtar i të cilit ishte edhe Xhaviti. Ishim lidhur aq shumë shpirtërisht me Xhavitin, sepse që të dytë kishim karaktere të ngjashme dhe idealin e njëjtë kombëtar. Lufta e UÇK-së e forcoi edhe më tepër këtë lidhje mes nesh.

Nuk e dija që Xhaviti kishte prirje për muzikë dhe për artin në përgjithësi. Ai e adhuronte këngën e lehtë, në veçanti këngët me motive lufte. Një ditë

derisa po udhëtonim së bashku në drejtim të bazës së Vneshtës për në pozicionet tona në Apterrush, nuk e di si më erdhi dhe ia mora një kënge. Ende pa përfunduar mirë vargun e parë, këngës ia mori edhe Xhaviti. Për çudi, ai e dinte në tërësi këngën. Ndoshta ishte hera e parë që atë ditë kam kënduar deri në fund me Xhavitin këngën partizane *Dalëngadalë po vjen behari*.

Kur e përfunduam këngën, Xhaviti tha:

Kjo këngë është himn imi, njëra nga këngët që më së shumti e dua. Sikur ta kishim kitarën, do ta këndonim edhe më mirë!

Vazhduam rrugën së bashku me Xhavitin, një rrugë me këngë dhe zërin e bukur të shokut tim dëshmor.

Edhe Fetahun e takova në fillim të luftës. Familjen e tij e kisha njohur më herët përmes veprimtarit veteran të Lëvizjes, Sejdi Gega. Fetahun dhe familjen e tij e njoha edhe përmes Besim Baraliut, ngase Fetahu ishte nip i Besimit. Fetahu kishte lënë mërgimin, ku kishte shkuar për të mbajtur familjen, dhe kishte ardhur në luftën e UÇK-së kundër pushtuesit serb. Fetahu ishte radhitur në njësitet e para të UÇK-së në Gurrë e Ilirion.

Luftimet e para mes UÇK-së dhe forcave serbe kishin filluar në Grykën e Carralevës dhe në Qafë të Duhlës. Nga ana jonë kërkoheshin përforcime për njësitë që komandoheshin nga Ismet Jashari-Komandant Kumanova dhe nga Komandant Guri. Ishte praktikë që në këso rastesh, varësisht nga numri i ushtarëve që duhej të shkonin në përforcime, të pyeteshin ushtarët në kishte vullnetarë që do shkonin në fronte lufte. Fetah Gega ishte ndër ushtarët e

parë që u paraqit vullnetar për betejën e Carralevës dhe të Qafë së Duhlës në qershor e korrik 1998. Në këto luftime Fetahu kishte shkëlqyer, duke dhënë shembullin më të mirë të ushtarit të disiplinuar, të pakursyer dhe trim të UÇK-së. Ai në këto luftime, ballë për ballë me forcat serbe, kishte marrë përvojën më të mirë luftarake.

Për merita gjatë luftës, shkathtësi e trimëri, Xhavit Bajraktari e Fetah Gega qenë avancuar në pozita ushtarake. Xhaviti ishte emëruar zëvendëskomandant i zbulim- kundërzbulimit, ndërsa Fetahu në Komandën e policisë ushtarake të Zonës Operative të Pashtrikut.

Më 1 maj 1999 njësiti special *Syri i Shqiponjës* planifikoi një aksion kundër forcave pushtuese serbe në rrugën Therandë- Rahavec, në fshatin Gurrë, pikërisht te Burimi.

Fillimisht me Xhavitin dhe me Imri Gashin vëzhguam vendin e aksionit. Planifikuam që në fillim të përdornim eksplozivin, duke e vënë në rrugën rrëzë Grapit mbi fshatin Gurrë. Paraprakisht siguruam një akumulator dhe një kabllo të gjatë, me të cilën do të aktivizonim eksplozivin. Xhaviti kishte siguruar edhe një kamerë, që e mbante vazhdimisht me vete, për të xhiruar edhe këtë aksion. Më herët kishim informacione se eksplozivi gjendej në fshatin Krushë e Madhe. Për ta marrë këtë eksploziv dërguam Shefkat Halimin dhe Xhavit Bajraktarin, të dy ushtarë me përvojë të njësitit tonë, ngase rruga deri atje ishte e vështirë dhe plot rreziqe. Ata u vonuan gati tërë ditën, edhe pse pjesën me të madhe të rrugës e kishin bërë me një qerre kuajsh.

Megjithatë, nuk e kishin gjetur eksplozivin, ngase komandant Tahir Sinani e kishte shpenzuar për të goditur tanket serbe, që kishin mësyrë nga ana e Rahavecit. Shefkati dhe Xhaviti u kthyen vonë në mbrëmje. Ata kishin bërë përpjekje ta siguronin edhe në baza të tjera të UÇK-së.

Atë natë, me një maj, njësiti ishte vendosur në fshatin Gurrë. Ndërkohë luftime të mëdha mes UÇK-së dhe ushtrisë e policisë serbe po zhvilloheshin në Budakovë, Buzhalë, Bukosh e Arrishtë. Me Habibin e Xhavitin analizuam situatën dhe vendosëm t'i shkojmë në ndihmë me përforcime Batalionit të Budakovës. Përmes komunikimit me radiolidhje me komandant Sadik Halitjahën kishim informacione se serbët kishin ndërmarrë një ofensivë të madhe në atë zonë. Xhaviti, i cili në atë kohë ishte edhe zendëskomandant për zbulim e kundërzbulim në Zonën Operative të Pashtrikut, duhej të informohej më hollësisht edhe për rrethanat e rënies së dëshmorit Zaim Muça nga fshati Arrishtë.

Për në Budakovë u nisëm natën vonë, më 1 maj 1999. Vazhduam rrugën nëpër Shirokë, në anën e vreshtave, nëpër rrafshinën mes Shirokës, Gjinocit, Dushkajës dhe Ujëmirit, për të mbërritur para mëngjesit në pozicionet e UÇK-së mes fshatit Buzhalë e Arrishtë.

Me njësitin *Syri i Shqiponjës* dhe një numër të vogël ushtarësh të Batalionit të Budakovës arritëm nga mëngjesi deri në mbrëmje të ndalnim makinerinë serbe, kur ajo kishte thyer pozicionet e UÇK-së kah pika e antenës në Ahishtë. Kishim informacione se në grykën e Buzhalës gjendej një numër i madh fshatarësh,

gra, fëmijë, pleq, të rinj e të reja që rrezikoheshin nga hordhitë serbe. Me Habibin e Xhavitin shkuam të shohim për së afërmi gjendjen e tyre. Ata mbi dy javë po qëndronin në atë grykë dhe mbijetonin në kushte të vështira, pa bukë e strehë, të traumatizuar nga ushtima e granatimeve serbe. Ekzistonte rreziku real i ndonjë masakre të ushtrisë e policisë serbe.

Porsa mbërritëm në kampin e refugjatëve, ata tashmë përgatiteshin të iknin në kolonë në drejtim të Shqipërisë. Ne u thamë që assesi të mos shkonin në kolonë edhe djemtë e vajzat e reja. Kontaktuam drejtpërdrejt edhe me disa të rinj të moshës 15-18-vjeçare, kërkuam t'i bashkohen UÇK-së dhe të mos bien në dorë të bishave serbe. Një numër i tyre iu bashkua radhëve të UÇK-së, ndërsa një numër tjetër vazhdoi me kolonën e refugjatëve. Te shkolla fillore "Vëllezërit Frashëri" në Bukosh, 23 të rinj, edhe pse nuk ishin pjesë e luftës, ishin ndarë nga kolona dhe nga duart e nënave të tyre. Fillimisht ishin torturuar mizorisht nga bishat serbe dhe në fund ishin push-katuar me breshëri automatikësh, mbështetur për muri në hyrje të shkollës.

Atë natë në grykën e Buzhalës Xhavit Bajraktari kishte takuar edhe djalin tim Betimi, i cili atëherë kishte vetëm 16 vjet.

- Nuk të lejoj të hysh në kolonë, - i kishte thënë atij, se serbët të vrasin si qengj. Ti do të vish me ne në UÇK. Të premtoj se kur të çlirohemi, në Prizren do t'i blej një palë këpucë të reja! Djali im Betimi më tha: Edhe unë do të vij me ju!

Nëse fëmijët e mi do të identifikoheshin në kolonë, do të likuidoheshin menjëherë, sepse emri im ishte

bërë tmerr për serbët, si vetë njësiti *Syri i Shqiponjës*. Kështu i mora edhe fëmijët e mi në luftë, sepse nuk doja të keqinterpretohej se drejtuesit e UÇK-së po i strehojnë familjet e tyre në Shqipëri. Ishte kjo edhe një luftë speciale që bëhej nga serbët e shërbëtorët e tyre ndaj UÇK-së.

Atë natë erdhën te ne edhe vajza ime 14-vjeçare, djali im i vogël 10-vjeçar dhe gruaja ime. Me njësitin tonë atë natë u bashkuan edhe disa ushtarë nga njësitet e Budakovës.

Qëndruam deri vonë në fshatin Buzhalë. Analizuam situatën dhe vendosëm të tërhiqeshim në drejtim të fshatrave Gurrë e Vneshtë, që pastaj me aksione të befasishme të sulmonim forcat serbe në frontin e Budakovës. Xhaviti propozoi një sulm te varrezat mes të fshatit Sopi e Shirokë.

Lëvizëm natën nëpër shtigje që i vlerësonim më pak të rrezikshme nga pritat serbe. Udhëtuam pothuajse tërë natën. Njësitit i printe Naim Kadolli, i cili e njihte mirë terrenin, sepse kishte kaluar shumë herë gjatë luftës rrugën që lidhte fshatrat në të dy anët. Me propozimin e tij udhëtuam maleve mes fshatrave Bukosh e Budakovë, nën fshatin Dardhishtë, mbi fshatin Lumar (*Reçan*) e në drejtim të Shirokës, ku kishim për qëllim të kalonim rrugën kryesore.

Fetah Gega sqaroi se kah ndërmarrja pyjore në Therandë janë të stacionuara forcat serbe dhe është rrezik për lëvizje. Ai propozoi që njësiti të lëvizte në drejtimin e përafërt nga kishim shkuar për në Budakovë. Pasi u konsultuam edhe me ushtarët e tjerë, u pajtuam të lëviznim në drejtim të Shirokës, meqë na u duk variant më pak i rrezikshëm. Pushuam pak

në vreshtat e Shirokës, ku ishim rreth 20 ushtarë dhe vendosëm ta trupojmë rrugën kryesore Shirokë-Prizren. Kolonës i printe Fetah Gega e Naim Kadolli, që u paraqitën vullnetarë për ta kryer këtë detyrë. Në afërsi të mullirit në Shirokë atyre iu bashkuan edhe Xhavit Bajraktari e Zenun Krasniqi. Xhaviti mbante edhe një aparat radiolidhjeje, që shërbente për komunikim eventual natën, ngase një radio të ngjashme e mbaja edhe unë gjatë tërë kohës. Ora ishte rreth dy e mëngjesit. Hëna ndriçonte sikur të ishte pikë e ditës dhe lëvizjet më të vogla mund të vëreheshin nga largësia.

Ne nuk kishim paramenduar se bishat serbe mund të zinin pritë pikërisht te mulliri. Derisa ishim ndalur pak nën një pemë për të pritur sinjalin e kalimit, papritmas erdhën krisma armësh e rafale të pandërprera në drejtimin tonë. Të gjendur në një situatë tepër të rrezikshme, u dhamë urdhër ushtarëve të tërhiqeshin në drejtim të fshatit Gjinoc. Tërheqja bëhej zvarrë nëpër një vijë ujërash të zeza. Pozicioni ynë ishte shumë i rrafshët, një hapësirë e gjerë, ku si maskim kishte vetëm fije bari. Serbët na kishin si në pëllëmbë të dorës dhe rafalet e tyre vinin të pandërprera nga të gjitha llojet e armëve. Ata ishin pozicionuar në të gjitha katet e mullirit dhe në shumë shtëpi të Shirokës. Ishte e pamundur ndonjë kundërpërgjigje ndaj tyre. E vetmja zgjidhje ishte tërheqja sa më e shpejtë, sepse rrezikoheshim të vriteshim të gjithë. Edhe mund të ziheshim gjallë, ngase serbët lëviznin edhe me automjete të blinduara.

Provova të merrja Xhavitin në radiolidhje, sepse ai me Fetahun, Naimin e Zenunin ishin në pozitë më të

rrezikshme, rreth 50- 60 metra nga grykat e zjarrit të serbëve. Xhaviti nuk arriti të fliste dhe vetëm një herë aktivizoi radiolidhjen.

Siç njoftoi më vonë Naimi, pothuajse në të njëjtën kohë ishin goditur në kokë edhe Xhaviti, edhe Fetahu, ndërsa Zenun Krasniqin e Naim Kadollin vetëm fati i kishte shpëtuar nga vdekja e sigurt. Ata kishin arritur të tërhiqeshin të padëmtuar nga prita e fashistëve serbë dhe breshëria e armëve që zgjati mbi dy orë pandërprerë. Naimi kishte humbur forcën dhe nuk mund të lëvizte. Zenuni i zhdërvjellët dhe me përvojë kishte arritur ta tërhiqte zvarrë Naimin. Nga grupi i ushtarëve, që ishin rreth 70- 80 metra larg nga prita, mbetën të plagosur Shaqir Kryeziu nga Leshani dhe Vahid Jashari nga Gurra. Që të dytë ishin plagosur rëndë në të dyja këmbët. Për tërheqjen e armëve të tyre kishte ndihmuar vajza ime Fata, e cila, edhe pse e re, vetëm 14- vjeçe, nuk kishte humbur vetëdijen në atë natë të tmerrshme. As shefi operativ i njësitit, Habibi (*Graniti*), falë përvojës së tij, në asnjë moment nuk kishte humbur kontrollin gjatë gjithë kësaj përballjeje të rrezikshme. Në disa raste ai mbuloi me trupin e tij fëmijët që ishin pjesë e kolonës.

Për të marrë pak veten nga tronditja e madhe, pushuam disa orë në fshatin Gjinoc, ndërsa disa ushtarë bënë rojë, duke vëzhguar situatën në drejtim të fshatit Shirokë. Atë natë serbët kishin rrethuar me autoblinda tërë lagjen Shirokë.

Të nesërmen në mbrëmje lamë fshatin Gjinoc dhe vazhduam për në Gurrë e Vneshtë. Në orët e mëngjesit rreshtuam ushtarët e bashkëluftëtarët e

Xhavitit dhe të Fetahut për t'i njoftuar në hollësi për rënien e plagosjen e ushtarëve të njësitit *Syri i Shqiponjës*. Edhe pse të tronditur nga humbja e shokëve më të mirë, u betuam para ushtarëve se do të vazhdonim luftën dhe do të hakmerreshim shumëfish për shokët e vrarë.

Për pritën në Shirokë e njoftova edhe Nezirin, i cili atë natë nuk ishte me ne. Me gjithë dhembjen që kishte për shokët, më ngushëlloi duke thënë:

- Rëniet janë pjesë e luftës, ti e di ç'do të thotë prita. Keni mundur të vriteni të gjithë. Shokëve lavdi, por ne nuk kemi kohë për vajtim!

Gjithmonë më ka brengosur rasti i pritës së 2 majit 1999 dhe humbja e dy ushtarëve tanë më të mirë, Xhavitit e Fetahut. Në komandën e njësitit jemi munduar ta ndriçojmë rastin përse u gjendëm në një pritë të tillë dhe mu në pikë të natës. A ishte kjo pritë e organizuar pikërisht për njësitin tonë, apo e rastësishme?

Atëherë flitej se serbët ishin pozicionuar në Shirokë kinse për disa hajdutë që vidhnin natën nëpër shtëpi. Mirëpo, kjo nuk qëndronte, ngase serbët ishin vetë hajdutë e plaçkitës të shtëpive natën e ditën.

Ndriçimi i së vërtetës së 2 majit 1999 më ka shqetësuar edhe pas luftës. Një ditë, derisa po ngritnim përmendoren e dy dëshmorëve të kombit, Xhavitit e Fetahut, pranë vendit ku kishin rënë në Shirokë, papritmas më afrohet një djalë i ri, duke m'u drejtuar:

- A je ti Ilaz Kadolli?
- Po, - i them.
- Kam pasur dëshirë të të takoja më herët, tha ai.

Më tregoi se kishte parë e vëzhguar tërë ngjarjen e

natës së 2 majit 1999, duke përshkruar çdo detal që kishte ndodhur atë natë. Ai së bashku me një shok të vet, tani aktivist i LDK-së dhe punëtor në komunën e Therandës, një natë më parë kishin qëndruar në fshatin Gjinoc dhe kishin vërejtur personalisht ushtarët e njësitit tonë kur kishin mbërritur aty. Ishte biseduar shumë rreth njësitit *Syri i Shqiponjës*. Dikush kishte folur me admirim, ndërsa dikush me smirë e urrejtje, varësisht nga ata që përkrahnin luftën dhe nga ata që kundërshtonin UÇK-në.

Djali i ri vazhdoi të tregonte më tutje për ngjarjen e asaj nate. Ata dy të rinj atë natë ishin gjendur në lagjen e Shirokës për të vëzhguar situatën dhe lëvizjen e forcave serbe, edhe pse nuk i kishte autorizuar askush.

Natën e 2 majit 1999 ata kishin vërejtur hollësisht lëvizjen e kolonës sonë drejt Shirokës dhe përskaj mullirit. Ata ishin në dijeni se në mulli e në shtëpitë përreth ishin përqendruar forca ushtarake e policore serbe. Sipas tij, ata të dy, gjatë kohës sa po qëndronin në një shtëpi të Shirokës, kishin pasur edhe armë me vete.

Kur unë i thashë se përse nuk na kishin sinjalizuar, qoftë me të shtëna ose në ndonjë formë tjetër, që njësiti të mos shkonte drejt pritës, ai u përgjigj: jemi frikësuar për vete!

Në pyetjen tjetër se kur dhe si ishin larguar nga vendi i ngjarjes, pasi lagjja Shirokë atë natë ishte rrethuar nga forca serbe, ai u përgjigj se tërheqja e tyre ishte mundësuar nga një plakë, që ua kishte treguar kanalin e ujërave të zeza, nëpër të cilin ata të dy qenkan tërhequr në drejtim të fshatit Gjinoc. Nuk

kam mundur ta njoh dhe ta marr edhe variantin e dëshmitarit tjetër në ngjarjen e natës së 2 majit 1999. Kam marrë vetëm informatën se ai është një aktivist i LDK- së dhe se pas luftës punon në komunën e Therandës. Shpresoj që edhe ky të tregojë në të ardhmen sesi u gjend pikërisht atë natë në vendngjarje dhe nëse di më shumë për ngjarjen e 2 majit 1999 te mulliri në Shirokë.

Sipas vlerësimit tim, prita në Shirokë ndaj njësitit *Syri i Shqiponjës* ka qenë e planifikuar nga serbët në bashkëpunim me veglat e tyre anti- UÇK. Mirëpo, deri tani nuk kemi të dhëna të sigurta. Në variantin më pak të mundshëm, kjo mund të ketë qenë edhe ndonjë pritë e rastësishme, ngase forcat serbe shumë herë gjatë luftës, për shkaqe taktike, ndërronin pozicionet e tyre për të goditur UÇK- në, në rastin konkret njësitin special diversant *Syri i Shqiponjës*, që ishte bërë tmerr për pushtuesin serb.

Nuk ishte hera e parë që njësiti të binte në prita të tilla. Gjatë pranverës 1999 pati një pritë të ngjashme. Gjatë kthimit nga Budakova, duke kaluar në anën veriore të Therandës, mes Therandës e fshatit Peqan, njësiti *Syri i Shqiponjës* ra në një pritë tepër të rrezikshme. Aty serbët ishin pozicionuar në një shtëpi në periferi. Ishte natë dhe terr pus. Në kthesë të rrugës kryesore Therandë- Peqan, në anën e majtë kah Semetishti, serbët kishin vënë një tel me disa kanaçe bosh. Dikush nga ushtarët tanë kishte prekur me këmbë telin me kanaçe. Serbët në katin e epërm të shtëpisë, nja dhjetë metra larg nesh, u sinjalizuan për këtë. Në fillim u dëgjua vetëm një krismë dhe kujtova se dikush nga ushtarët tanë krisi pa dashje.

Pastaj nga dritaret e shtëpisë ku qëndronin serbët u dëgjua një breshëri automatikësh. Filluam të vraponim dhe vetëm prisja se cilin nga ne do ta kapte rafali mbrapa.

Për fatin tonë, jo shumë larg nga aty terreni ishte paksa i thyer, sa për të na mundësuar pozicionimin. Pyetëm njëri- tjetrin në mos ishte qëlluar ndokush. Fatmirësisht, asnjëri nga gjashtë ushtarët nuk kishte pësuar as gërvishtje.

Vëzhguam hollësisht se nga vinin të shtënat dhe zjarri i serbëve. Pasi pamë dritaret nga shtinin, iu afruam shtëpisë nja 30- 40 metra larg dhe me minahedhës dore e automatikë qëlluam banditët serbë. Ata nuk u ndien gjallë. Ose pësuan keq, ose u strukën për të shpëtuar kokën.

Jehona e krismave tona ishte dëgjuar edhe në bazën e zonës sonë. Këtë na treguan ushtarët që bënin rojë në pikën e Semetishtit e të Kastrës. Porsa na panë që ishim të *Syrit të Shqiponjës*, na thanë: A ua punuat mirë derrave!

Ishim të vetëdijshëm se në luftën për lirinë e Kosovës duheshin edhe flijime. Deri në rënien e Xhavitit e Fetahut ne ishim mësuar vetëm me fitore të njëpasnjëshme kundër okupatorit serb. Me gjithë dhimbjen e thellë për shokët, nuk ishte traditë e UÇK-së të vajtoheshin të rënët.

Dëshmorët e kombit Xhavit Bajraktari e Fetah Gega.

Gjaku i Xhavitit e Fetahut ujiti lulëkuqet e Kosovës, që po çelnin për liri.

Sapo morëm veten, në komandën e njësitit bëmë planin e sulmit të ri mbi pushtuesin serb. Në praktikën e ushtrive të rregullta e serioze hakmarrja mbi forcat armike bëhej brenda 24 orëve. Megjithatë, përgatitja e sulmit hakmarrës për shokët e rënë na mori pak më shumë kohë. Qëllimi ishte që serbët t'i godisnim sa më rëndë. Vendosëm që sulmin ta bënim në afërsi të fshatrave Vneshtë e Gurrë, pikërisht aty ku kishin lindur këta dy heronj të UÇK- së.

Hakmarrja në Vneshtë

Më 11 maj 1999, në orët e hershme të mëngjesit, me Kaçurrelin vëzhguam rrugën Therandë- Rahavec, nëpër të cilën kalonte ushtria e policia serbe pothuajse çdo ditë.

Qëllimi ishte të gjenim vendin më të përshtatshëm për sulm. Mbi fshatin Vneshtë ishim vetëm unë e Neziri. Shpëtuam për një fije, kur një kolonë prej tri automjeteve të blinduara me ushtarë e policë serbë po vinte me shpejtësi të madhe nga drejtimi i Rahavecit. Nuk kishim as kohë, as mundësi t'i kundërviheshim. U detyruam të shtriheshim përskaj rrugës, duke mbajtur në shënjestër autoblindat serbe. Ata kaluan pranë nesh pa na vërejtur fare, falë disa pjesëve të gjelbëruara. Serbët ishin me automjete të blinduara, ndërsa ne vetëm dy ushtarë. Qëllimi ynë ishte vetëm vëzhgimi dhe përgatitja e vendit të sulmit, që do te kryhej nesër nga njësiti ynë.

Njësiti Syri i Shqiponjës,Vneshtë, Therandë, 12 maj 1999: Ilaz Kadolli e Nezir Kryeziu.

Të nesërmen bëmë planin e sulmit dhe organizuam ushtarët e njësitit, që ishin në bazën e Vneshtës. Herët në mëngjesin e 12 majit 1999, njësiti u pozicionua në të njëjtin vend ku kishim vëzhguar një ditë më parë.

Ishim gjithsej 11 ushtarë të ndarë në tri prita. Paraprakisht bëmë maskimin, duke shfrytëzuar gjelbërimin përreth. Thyem disa degë dushku dhe i vumë në vendet e përshtatshme përskaj rrugës.

Elmaz Papaj (*Maku*) kishte marrë edhe kamerën, që deri në rënien e tij e kishte përdorur dëshmori Xhavit Bajraktari. Ishte vështirë të gjendej kamerë në atë kohë lufte, por edhe më vështirë të sigurohej mbushja e baterive të saj, sepse fshatrat ishin të shkrumbuara dhe nuk kishte as rrymë elektrike.

Njësiti kishte angazhuar edhe dy ushtarë vëzhgues, Ramadan Hotin dhe Shefki Hodajn, që kishin detyrë të na njoftonin për drejtimin e lëvizjes dhe numrin e forcave armike.

Komunikimi bëhej përmes radiolidhjes. Me vëzhguesit u morëm vesh edhe për kodet e komunikimit, sepse kishte rrezik nga mundësia e përgjimit nga serbët. Kodet e komunikimit ishin të thjeshta. Për mjetet e blinduara përdornim kodin *breshkë*, për automjetet e pablinduara kodin *sorrë*, ndërsa ushtarëve e policëve serbë më së miri u rrinte kodi *derr*.

Ndërkohë vëzhguesit kishin vërejtur me dylbi si ushtarët e policët serbë po ngarkonin një kamion me armë e municione në bazën e tyre afër fshatit Gurrë. Gjithashtu kishin vërejtur se në atë kamion ishin edhe së paku dhjetë ushtarë serbë. Këta derra qenë nisur në drejtimin Therandë – Rahavec, siguruisht për t'i furnizuar vijat e frontit afër Zoqishtës e

Apterrushit.

Nuk vonoi shumë dhe para nesh u shfaq autotransportuesi i ushtrisë serbe. Nga të tri pritat shkrepëm përnjëherësh rafale automatikësh e mortaja dore. Transportuesi me ushtarë e municion u përplas në anën e djathtë të rrugës, nga ku mund të goditej më lehtë.

Transportuesi serb digjet bashkë me ushtarët përbrenda, Vneshtë, 12 maj 1999.

- Mos harxhoni plumba, - tha Kaçurreli, - ju mbajeni në shënjestër e unë do ta godas mbrapa! Ai u pozicionua mu në mes të rrugës, në një largësi rreth 20-30 metra. Predha e mortajës goditi në mes kamionin, mu në pjesën e mbushur me municion. Kamioni u hodh në erë duke qitur tym e flakë. Edhe pse nga një largësi e madhe, pamjen spektakulare të sulmit e kishin parë mirë edhe ushtarët e UÇK-së në bjeshkën e Kabashit. Ata kishin kujtuar se ishte ndonjë bombardim i NATO- s mbi pozicionet serbe dhe nuk dinin fare se aty vepronte njësiti special *Syri i Shqiponjës*, që e kishte bërë për turp ushtrinë pushtuese.

Maku kishte kapur me kamerën e tij amatore vetëm disa inserte të këtij sulmi, sepse ai ishte aq i fuqishëm, sa Maku ishte tronditur bashkë me kamerën.

Pas sulmit u tërhoqëm të sigurt drejt bazës sonë në fshatinVneshtë. Ushtarët u pozicionuan në pikat kryesore të fshatit për t'iu përgjigjur ndonjë kundërsulmi të papritur. Në disa shtëpi nga vërehej mirë vendi i ngjarjes u vendosën snajperistët për të vëzhguar situatën.

Përmes radiolidhjes depërtuam në frekuencat e serbëve, ku kapëm tërë komunikimin e tyre. Ata provonin të lidheshin me ushtarët e tyre që ishin bërë shkrumb e hi. Të kota ishin thirrjet e bazës serbe: *Javite se, javite se!* (Paraqituni!)

Ata më pas erdhën për t'i tërhequr të vrarët. Nga Theranda e Rahaveci vinin kolona të blinduara, që shkrepnin në mënyrë të pakontrolluar, më shumë nga frika se edhe ata mund të pësonin të njëjtin fat. Me të mbërritur në vendngjarje, serbët i raportuan bazës së tyre në Prizren: *Sve je uništeno, nijedan nije ostao živ!* (Gjithçka është shkatërruar, asnjë s'ka mbetur gjallë!). Asnjë ushtar serb nuk shpëtoi atë ditë, u karbonizuan me gjithçka patën me vete.

Nezir Kryeziu (Kaçurreli) dhe Bardhyl Gega gjatë aksionit, 12 maj 1999.

Informacionet tona tregonin se forcat armike atë ditë humbën dhjetë ushtarë, ndërsa vetë serbët raportuan se ishin vrarë tetë veta. Njësiti *Syri i Shqiponjës* nuk pati as dëmin më të vogël.

Mirëpo, kjo nuk mjaftonte për ne dhe hakmarrja për shokët tanë, Xhavitin e Fetahun, do të vazhdojë me aksione të tjera kundër pushtuesit serb deri në çlirimin e plotë të vendit.

Lumi i *Syrit të Shqiponjës*

Lumni Haxhiu (*Lumi*) ishte njëri ndër ushtarët më të mirë të njësitit *Syri i Shqiponjës*. Ai bashkë me ushtarët e tjerë nga Vneshta kaherë vëzhgonin forcat serbe në fshatrat Zoqishtë e Apterrush.

Ushtarët serbë ishin akomoduar aq mirë aty, sa shpeshherë harronin se ishin në luftë dhe në tokë të

huaj. Transportin për furnizimet e bazave të tyre e bënin edhe me automjete të lehta a me traktorë të zbuluar. Kishin harruar që djemtë e *Syrit të Shqiponjës* i vëzhgonin dhe mbanin në shënjestër ditë e natë.

Më 24 maj 1999, rreth orës 10, Lumi me Arton e Fejzë Kabashin bëjnë një sulm të befasishëm, kur katër ushtarë serbë po kalonin me një traktor të vogël rrugës Zoqishtë- Apterrush. Papritmas dalin nga çubat dhe iu bëjnë thirrje të dorëzoheshin. Në fillim ushtarët serbë, sipas stilit të tyre, tentojnë të mashtrojnë, duke bërë lajka: *Nemoj bre da igraš sa oružjem!* (Mos luaj me armë, or ti!). Lumi e kupton lojën e tyre dhelparake. Kur serbët fillojnë t'i lëvizin armët, Lumi i korr me automatik, duke i shtrirë përtokë. Njëri nga ushtarët kap me dorë grykën e mitralozit për ta rrëmbyer, por ai ishte i salduar në traktor. Lumi me ushtarët e tij marrin trofe katër automatikë dhe një revole TT të prodhimit jugosllav.

Aksione të ngjashme Lumi me shokë bëri edhe shumë herë të tjera në tërë zonën e veprimit, në Vneshtë, Apterrush, Zoqishtë deri në Krushë të Madhe e Piranë.

- Ç'është me këta shkitë? Këta u vritkan me lehtë se derrat, madje nuk u ndihet as zëri, e lëre me pushka!- kështu përshkroi Lumi aksionin pranë Apterrushit.

Kur bëri raportimin në bazën e njësitit *Syri i Shqiponjës*, Lumi solli si trofe armët e municionin e rrëmbyer.

Pjesëtarë të njësitit special Syri i Shqiponjës,
Lumni Haxhiu (Lumi) dhe Ilmaz Papaj, më 1999.

Lumi gjatë tërë luftës u shqua për trimëri e guxim të pashoq. Për këto virtyte ai u emërua komandant skuadre i njësitit *Syri i Shqiponjës*. Me skuadrën e tij ai kreu sulme të njëpasnjëshme kundër forcave serbe në zonat e veprimit të njësitit. Sulmet më të suksesshme i kreu në fshatrat Piranë, Zojz, Hoçë e Madhe, Zoqishtë e Apterrush të Rahavecit.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, Lumi me skuadrën e njësitit *Syri i Shqiponjës* vazhdoi luftën në pjesën tjetër të pushtuar, në Kosovën Lindore, duke iu bashkuar radhëve të UÇPMB- së.

Gjatë luftimeve në këtë pjesë të atdheut bien heroikisht tre ushtarë të njësitit special *Syri i Shqiponjës*: Betim Berisha e Eqerem Hoxha nga Lagjja e Trimave në Prizren dhe Shkëlzen Krasniqi nga fshati Apterrush i Rahavecit.

Pas luftës Lumit të UÇK- së i lindi fëmija i parë (djalë), të cilin e pagëzoi me emrin *Syri i Shqiponjës*.

Lepujt e trembur në Grap

Syrit të Shqiponjës nuk i shpëtonin as lëvizjet më të vogla të bishave serbe. Rruga Therandë- Rahavec, përgjatë fshatrave Rreshtan, Gurrë, Vneshtë etj., ishte bërë rrugë e vdekjes, ku kishin lënë kokat shumë kriminelë serbë.

Në maj 1999 njësiti qe përqendruar përkohësisht në fshatin Gurrë, në pjesën perëndimore kah fshati fqinj Vneshtë. Shtëpitë e familjes Shemsedin Gashi (Çuni) prej kohësh ishin shndërruar në baza të forta të ushtrisë sonë. Shtëpitë e kësaj familjeje, përveçse të përshtatshme për strehim, kishin edhe një pozitë të mirë strategjike për mbrojtje e vëzhgim të forcave armike. Nga aty shihej si në pëllëmbë të dorës rruga e Grapit, që lidhte Therandën me Rahavecin.

Kishim informacione se forcat serbe do të lëviznin nga drejtimi Rahavec- Therandë. Me Kaçurrelin u vendosëm në shtëpitë më të larta: unë në katin e sipërm, ndërsa Kaçurreli zuri një pozicion mbi pllakën e shtëpisë pa kulm, ku vendosi disa blloqe betoni dhe u shtri mbi pllakë. Derisa kisha puthitur syrin në objektivin e snajperit, u shfaq një lëvizje e lehtë e dy lepujve. Ngjyra gri e lepujve nuk dallohej shumë nga ngjyra e Grapit të zhveshur guror. Dy lepuj luanin e kërcenin si qengja të vegjël. Me gjasë edha ata i kishte harlisur moti i bukur me diell atë ditë maji. Kaçurrelit i thashë të shikonte rreth 100 metra nga e djathta. Atij nuk i shpëtonte as lëvizja më e vogël. Filloi të qeshë, i habitur se diçka të tillë nuk kishte parë asnjëherë në jetën e tij.

- Sa mirë po luajnë!, - qeshi ai.

Ende pa përfunduar biseda, nga ana e majtë erdhi një uturimë e autoblindës. Nga Rahaveci po vinte me shpejtësi një autoblindë dhe një automjet me ngjyrë të kuqe. Nga shpejtësia e lëvizjes ngrihej mbrapa pluhuri i xhadesë. Për çudi, si me porosi, tamam kur ishin përballë nesh, ngadalësuan shpejtësinë dhe autoblinda e automjeti u ndalën një çast në rrugën e Grapit. Ne ishim në gatishmëri dhe prisnim me syrin në shënjestër. Tre policë serbë zbritën nga autoblinda dhe u lëshuan tatëpjetës. Si duket kishin për qëllim të furnizonin me armë një pozicion të tyre. Serbët ishin të vendosur në disa shtëpi në anën e epërme të Gurrës. Sa me poshtë lëshoheshin ata, aq me shumë u afroheshin snajperëve tanë. Në momentin kur ishin larguar mjaft nga autoblinda, ne qëlluam njëkohësisht me të dy snajperët. Njëri nga serbët u përplas përtokë, ndërsa dy të tjerët nuk mund ktheheshin mbrapa dhe ranë edhe më poshtë, duke lënë të vrarin në rrëpirë. Ne vazhduam me të shtëna edhe mbi automjetin me ngjyre të kuqe, që filloi të tërhiqej me lëvizje të shpejtë mbrapa. Autoblinda serbe u zdorgj pas të vrarit, por serbët nuk dolën fare nga autoblinda. Të vrarin e tërhoqën zvarrë me një kërrabë deri në rrugë dhe e futën brenda në autoblindë. Me shpejtësi edhe më të madhe kriminelët u kthyen mbrapa në drejtim të Rahavecit, duke lënë mbrapa pluhurin e turpin.

Ishte kënaqësi t'i shihje serbët duke ikur si lepujt. Krismat tona kishin trembur edhe lepujt që luanin më parë në Grap.

Sulmi spektakular në Peqan

Në maj 1999 ushtarët e njësitit tonë ndodheshin në fshatin Kastër (*Kastërc*), ku kishin nevojë të pushonin pak dhe të përgatiteshin për sulme e pusi të reja. Pas një ofensive të ashpër, që zgjati mbi një javë, forcat serbe kishin marrë nën kontroll një nga pikat tona strategjike, fshatin Peqan. Aty dogjën çdo gjë, plaçkitën ushqimet dhe vranë bagëtinë e disa civilë të pafajshëm, që po iknin me traktor nga fshati në drejtim të Therandës. Tani ky fshat ishte i rrethuar e kontrolluar nga forcat serbe.

Në komandën e njësitit vendosëm të hakmerreshim për krimin ndaj civilëv dhe t'i largojmë nga fshati forcat serbe, që ishin bërë pengesë edhe për lëvizjen e ushtarëve tanë në atë zonë. Fillimisht bëmë planin e aksionit, caktuam ushtarët më të mirë dhe siguruam armatimin. Një mortajë dore me predha huazuam nga logjistika e paktë e Brigadës 123. Gjithashtu siguruam edhe dy mina antitank, pothuajse të vetmet në gjithë brigadën. Minat rrumbullake dhe me ngjyrë të gjelbër ishin rrëmbyer në Aeroportin ushtarak të Sllatinës kur NATO-ja po bombardonte. Ushtarët e UÇK- së kishin shfrytëzuar rastin duke depërtuar në depot e ushtrisë serbe. Ato mina të rrëmbyera ishin shpërdarë pastaj nëpër zonat e UÇK-së.

Njësiti *Syri i Shqiponjës* nuk kishte shumë pjesëtarë, por ishte mjaft efektiv. Armët i siguronte pa vështirësi, sepse me aksione të suksesshme kishte krijuar simpati e autoritet. Shpesh thoshin: Këta të *Syrit të Shqiponjës* armët nuk i harxhojnë kot. Kishte edhe të atillë që bënin shaka:

Jepjuani armët se ndoshta vriten. Nuk po na lënë as të pushojmë. Kah po shkojnë, po e kallin flakë!

Ne aksionin e Peqanit vendosëm të shkojmë nëntë ushtarë të njësitit.Përgjegjës të tri pritave ishim unë, Neziri dhe Habibi. Kishim marrë me vete edhe dy ushtarë nga i njëjti fshat, Ylmet Fondën dhe Adem Bytyçin, edhe pse e njihnim mirë terrenin.

Natën njësiti kaloi nga Kastra në fshatin Semetisht, ku qëndroi deri në orën 24. Për të mos rrezikuar asgjë , i ramë nga fundi i fshatit, nëpër shtigje të sigurta, për të arritur në afërsi të pozicionit serb në qendër të fshatit, në shtëpinë e Durak Fondës.

Edhe pse nuk ishte rrugë e gjatë, për shkak të natës dhe shiut që binte pandërprerë, bëmë nja dy orë rrugë deri aty.

Më 24 maj 1999, rreth orës 2 të natës, ushtarët zunë pikat më të përshtatshme për sulm dhe përgatitën pozicionet secili për vete. Ishim shumë të sigurt se serbët lëvizin së paku një herë në ditë në drejtimin Peqan- Therandë, por nuk e dinim kohën e saktë. Kështu u desh të prisnim rreth gjashtë orë. Ushtarët patën mjaft kohë të pozicionohen e maskohen mirë. Njëri prej tyre, Nevzati, shënonte diçka në bllokun e tij, sigurisht ndonjë ditar lufte a ndonjë porosi.

Nevzat Kryeziu para sulmit më 24.5.1999;
shënime nga ditari i luftës.

Unë u pozicionova vetëm në të majtë kah qendra e fshatit. Këtë pozicion e kishte përgatitur Neziri për vete. Ai ishte më i sigurt, sepse kishte hapur një birë në mur nga mund të qëllohej.

- Zëre këtë pozicion! - më tha Kaçurreli. Ti nuk bën të vritesh. Unë po dal në mes të rrugës. Edhe nëse vritem, nuk bëhet nami! E shikova edhe një herë Nezirin. Ai veç ishte plagosur në një aksion të mëhershëm. Gatishmëria e tij për t'u sakrifikuar nuk më habiti shumë. Ai e kishte dëshmuar këtë edhe më herët. Ishte një trim i rrallë dhe luftëtar i pakursyer.

Para sulmit Neziri më tha:

Nëse serbët vijnë pa mjete të blinduara, t'i zëmë gjallë. Unë dal në rrugë t'i çarmatos e ju mbani në shënjestër. Nëse nuk dorëzohen, ju qëlloni dhe vrisni.

Kështu edhe vepruam: unë u vendosa në pozicionin e parë, Neziri 15 m më larg midis rrugës, ndërsa Habibi me dy ushtarë në pritën e tretë në të djathtë të fshatit, 40 metra më larg.

Paraprakisht kishim minuar rrugët nga mund t'u

vinin përfocime ushtarëve serbë. Habibi kishte minuar rrugën tek ura në hyrje të fshatit, që vinte nga Theranda, ndërsa Ylmeti atë në drejtim të fshatit Dardhë. Në shtëpitë skaj rrugës vendosëm një snajperist dhe një ushtar të ri me kamerë për të filmuar ndonjë pjesë të aksionit. U mundova t'i jepja zemër ushtarit me kamerë, që të mos frikohej nga krismat dhe të kapte sa më shumë storje. Ai ishte fare i ri dhe në aksion po merrte pjesë për herë të parë.

Tanimë ora kishte kaluar 8 të mëngjesit. Fillimishte dëgjuam vetëm uturimën e një autoblinde serbe, që po vinte në drejtimin tonë. Pas disa sekondash autoblinda u shfaq në mes të rrugës si një përbindësh i madh. M'u afrua aq shumë, sa nuk më hyri në grykë të minahedhësit. Nuk pata nevojë as ta merrja në shënjestër, sepse e kisha përballë. Mënjëherë e godita në pjesën e shoferit, në mënyrë që të paralizohej autoblinda dhe vetë shoferi. Njëkohësisht autoblinda u godit edhe nga Neziri, i cili ishte në skaj të rrugës. Autoblinda u përplas te shkallët e një dyqani, aty ku ishte prita e tretë me Habibin. Autoblinda e armikut u asgjësua bashkë me ushtarët që ishin në të. Ushtarët serbë nuk kishin pritur një sulm aq të rrufeshëm, sepse nuk arritën të shkrepin as edhe një predhë në drejtimin tonë.

Më pas pjesëtarëve të njësitit u dhamë urdhër të tërhiqeshin në drejtim të bazës sonë. Unë e Neziri, si zakonisht, u tërhoqëm të fundit, pasi morëm me vete pak ushqime e karburant në një shtëpi të braktisur. Pastaj u zdorgjëm ngadalë e sigurt lugut të fshatit. Serbët e pozicionuar në kalldrëm filluan të shtinin në mënyrë të pakontrolluar. Ne vëzhgonim nga një

pozicion i sigurt si serbët vinin të tmerruar për t'i tërhequr të vrarët.

Atë ditë kriminelët serbë i priti edhe një befasi tjetër tmerruese. Pas rreth gjysmë ore, tek ura në hyrje të fshatit shpërtheu edhe mina, që e kishte vënë me mjeshtëri komandanti i operativës Habib Elshani. Asnjë ushtar serb nuk shpëtoi dhe autoblinda e dytë u hodh tërësisht në erë.

Gjëmimi i *Syrit të Shqiponjës* u dëgjua shumë larg, sa u dridh e tërë Theranda.

Ishte obligim që pas çdo sulmi të informohej Komanda e zonës, në kuadër të së cilës vepronte njësiti ynë. Porsa mori sinjalin, në radiolidhje u paraqit Komandant Tahir Sinani, i cili veç kishte dëgjuar gjëmimin:

- *Ju lumtë djema, si kaluat në aksion?*

Ylmeti i gëzuar m'u lut t'ia jepja radiolidhjen, që ai të raportonte me mburrje:

- *Kaluam si shqiponjat që dinë të godasin armikun mu në krye!*

Në operacionin e Peqanit mbetën të vrarë shumë ushtarë serbë.

Makineria ushtarake serbe e shkatërruar nga Syri i Shqiponjës, Peqan, 24 maj 1999.

Ushtarit të ri dhe të papërvojë të *Syrit të Shqiponjës*, Blerim Gashit, nga tronditja e madhe e gjëmimit të mortajave edhe kamera i kishte rënë në tokë. Do të ishte një mrekulli e vërtetë sikur ta xhironte gjithë këtë aksion. Mjerisht, ai kishte kapur vetëm një insert të këtij aksioni të guximshëm.

A thua ku ishin atëherë reporterët dhe gazetarët tanë profesionistë? Ishin mësuar të filmonin vetëm dasma, koncerte e lojëra sportive. Ata edhe pas luftës nuk trajtuan si duhet heroizmin e luftëtarëve të UÇK- së. Përkundrazi, një numër i madh i tyre gjurmojnë vetëm njolla të luftës çlirimtare, duke shpifur e akuzuar UÇK-në dhe eprorët e saj.

A thua nuk mjafton rënia heroike e mbi 2400 djemve dhe vajzave të UÇK-së për t'u mburrur çdo shqiptar me këtë luftë të shenjtë kundër pushtuesit serb?

Si zakonisht, pas çdo sulmi të suksesshëm njësiti kthehej në bazën tonë, me plot shpresë për fitoren përfundimtare. Në fshatin Kastër na pritnin shokët e logjistikës dhe personeli tjetër i zonës. Në këso rastesh nuk mungonte as kënga. Atë natë maji 1999 na argëtoi Besim Baraliu me çifteli dhe këngën e tij të preferuar "*Moj Shqipni mos thuaj mbarova*". Këndohej me ëndje edhe kënga partizane "*Dalëngadalë po vjen behari*", që pas rënies heroike të dy dëshmorëve të kombit, Xhavitit e Fetahut, u përshtat dhe pothuajse u bë himn i njësitit tonë. Të përkujtoj vetëm disa vargje të kësaj kënge, që shkojnë mirë kur përcillen me kitarë dhe që me ëndje i këndonte dëshmori Xhavit Bajraktari:

Dalëngadalë po vjen behari,
dalëngadalë po na vjen,
nëpër fusha rritet bari.
Dalëngadalë po na vjen,
Po na vjen, po na vjen
bota zjen, bota zjen,
shokët tanë lufta rrëmben...

Vargjet e kësaj kënge paralajmëronin beharin e shumëpritur të lirisë së Kosovës.

Çlirimi i Therandës

Komanda e Zonës së Pashtrikut ditë më parë kishte bërë planin dhe përgatitjet për hyrje në qytetet Prizren, Therandë, Rahavec e Sharr. U takuam me komandant Tahir Sinanin dhe zëvendësin e tij Sadik Halitjaha. Më propozuan që unë me njësitin tim të futesha në Prizren dhe të merrja nën kontroll objektet e rendit e të drejtësisë. E pranova me kënaqësi propozimin e tyre, por i njoftova se me njësitin tim fillimisht do të hyj në Therandë, se sot është Dita jonë e madhe.

Kisha ëndërruar gjatë të vinte kjo ditë e bekuar. Pas shumë përpjekjeve e shumë viteve të përkushtimit konkret, ndjeja se kishte ardhur dita e fitores përfundimtare. Kisha dëshirë që në Therandë të hynim në mënyre triumfale, të hakmerreshim për shokët e vrarë para lufte e në luftë, për krimet mizore që bënë serbët në Therandë dhe më gjerë në gjithë Kosovën. Në Therandë do të vendosnim flamurin tonë kombëtar.

Me komandantin e operativës, Habibin, bëmë planin e sulmit. Ishte mëngjesi i 13 qershorit 1999. Tërë natën nuk bëmë as një sy gjumë.

Serbët e mbanin ende nën kontroll Therandën. Ata ishin vendosur në pikat strategjike të qytetit. Ne përgatitëm ushtarët, armët dhe pak municion që na kishte mbetur. Nga fshati Kastër u nisëm herët në mëngjes në drejtim të Therandës. Një pjesë të rrugës e kaluam me një traktor të markës "Ferguson", e vetmja teknikë që kishte mbetur për transport të ushtarëve. Ishte mot i bukur. Dielli sapo kishte lindur dhe shndriste si asnjëherë më parë majat e Sharrit dhe të Pashtrikut.Ai sikur paralajmëronte kështu lirinë e pritur me shekuj në Kosovë. Gjatë rrugës ushtarët ia morën një kënge, sikur të shkonin në dasmë e jo në luftë. Disa ushtarë të brigadës, që po bënin rojë në hyrje të Semetishtit, na vështruan me kureshtje.

Në dalje të Peqanit të Vogël lamë traktorin dhe ngadalë e të sigurt iu afruam pozicioneve serbe mes Therandës e Peqanit.

Beteja për Therandën, 13 qershor 1999:
Ilaz Kadolli, Habib Elshani dhe Safet Sylaj.

Nga një pozicion në thellësi të vreshtave të Therandës vëzhguam pozicionet serbe. Fillimisht i befasuam ata me gjuajtje të snajperëve. Serbët nuk dinin që ishim vetëm pesë ushtarë. I kishim shumë afër dhe ata filloi t'i kapte paniku. Edhe një herë qëlluam me snajperë unë e Habibi. Serbët na kthyen me breshëri armësh dhe filluan të iknin. Të kota ishin urdhrat e komandantit të tyre, i cili u bërtiste: "*Stanite bre*!" (Ndaluni!) Serbët bënë disa përpjekje për të na zmbrapsur. Gjashtë orë të tëra shkëmbyem zjarr të pandërprerë dhe në fund serbët u detyruan të ikin, duke u futur nëpër disa kamionë, që ikën me shpejtësi në drejtim të qendrës së qytetit.

Krismat kishte dëgjuar edhe Kaçurreli, i cili me disa ushtarë të njësitit tonë sulmoi pozicionet serbe nga drejtimi i Peqanit. Në afërsi të varrezave të Therandës, tek bodrumi i verës, u bashkuam me

ushtarët e tjerë të njësitit. Ndër ushtarët e njësitit që komandonte Kaçurreli, vërejta një ushtar të panjohur. Ai me përshëndeti me respekt e ngrohtësi:

- Si je komandant, të lutem ruaju të mos vritemi ditën e fundit!

Nuk e njoha,edhe pse fytyra i bënte dritë.

- Më fal që po të pyes, kush je ti, ngase të kam harruar?

- Si nuk më njeh? Jam Kenani, Kenan Halimi nga Vitia. S'të kujtohet kur erdha nga Zvicra në luftë dhe më urove mirëseardhje?! U përqafuam me Kenanin si të ishim vëllezër dhe vazhduam drejt qendrës së qytetit.

Edhe një herë e shikova me mall Kenanin. Fytyra e tij bënte dritë. Nuk pritja se ai do të binte dëshmor pikërisht në ditën e çlirimit, mu në qendër të Therandës, aty ku sot qëndron lapidari krenar në parkun e qytetit. Kenanin e rënë dëshmor e putha mu në ballë, aty ku e kishte marrë plumbi, duke i dhënë lamtumirën e fundit.

Ushtarët e njësitit i urdhëruam të zënë pozicionet në pikat kyçe të qytetit. Paraprakisht ushtarët e njësitit tonë shkulën me mllef të madh simbolet serbe dhe llamarinat e fundit të një shteti fantazmë në ndërtesën e komunës së Therandës dhe të gjykatës komunale. Safetit iu deshën vetëm pak sekonda për të hequr me bajonetë mbishkrimet e urryera cirilike në llamarinat e ndryshkura dhe për t'i përplasur përtokë. Ushtarët e njësitit tonë i shkelën ato me këmbë dhe përbuzje.

Kaçurreli me pak ushtarë u vendos afër stacionit policor, ndërsa unë me shtatë ushtarë mu në qendër

të qytetit, afër urës kryesore te parku i qytetit.

Me Kaçurrelin komunikonim vazhdimisht në radiolidhje për të mbajtur nën kontroll situatën, ngase serbët ende nuk ishin tërhequr tërësisht nga qyteti i Therandës.

Qyteti ishte rrënuar e djegur pothuajse tërësisht nga armiku, ishte i zbrazët dhe nuk dëgjohej zë njeriu. Nga terrori serb ishin larguar edhe zogjtë, lëre më njerëzit. Dëgjohej vetëm krrokama e korbave, si një iso e krimeve fashiste serbe, duke u ushqyer me kufoma të civilëve e kërma të bagëtive kudo nëpër oborre, kopshte e nëpër rrugët e qytetit.

Çlirimi i Therandës, 13 qershor 1999.

Një kolonë e ushtrisë serbe po vinte nga Duhla për në Therandë. Siç duket, ishin nga pozicionet e fundit serbe në Biraç dhe tani po tërhiqeshin në drejtim të

Prizrenit. Për këtë më njoftoi me radiolidhje Kaçurreli, i cili ndodhej në anën veriore të qytetit. Një pjesë të tyre ai kishte ndalur në rrugën afër stacionit policor. Tre kamionë të mbushur përplot me ushtarë serbë nuk kishin përfillur urdhrin për ndalesë dhe po vinin me shpejtësi në drejtim të urës kryesore në qendër të qytetit. Sapo mora informacionin për lëvizjen e ushtrisë serbe, vendosa ushtarët në një pozicion luftimi. Buzë parkut të qytetit ishte një pozicion i përshtatshëm, ku ushtarët e njësitit nuk vëreheshin fare. Unë dhe Safet Syla nga Dardha i dolëm përpara kolonës serbe, mu në mes të rrugës. Me gjasë ata patën përshtypjen se ishim vetëm dy kokëkrisur. U bëra me dorën e majtë shenjën stop! Ushtarët serbë nuk përfillën urdhrin. Atëherë ua drejtuam armët dhe me tytën e automatikut drejt ballit u dhashë urdhër në gjuhën serbe për të dytën herë që të ndalonin dhe të dorëzoheshin: *Stoj! Predajte se!*" Ushtarët serbë përsëri nuk përfillën urdhrin, edhe pse dëgjuan qartë britmën time.

Duke na parë vetëm dy ushtarë të UÇK-së përballë tyre dhe në mes të rrugës, serbët tentuan të na vrisnin. Njëri nga ushtarët serbë kishte hapur xhamin e dritares së kamionit dhe po nxirrte ngadalë tytën e automatikut për të na qëlluar. Këtë e vërejtëm mirë edhe unë, edhe Safeti në anën e djathtë, i cili bërtiti : Na vranë! Për të qindtën e sekondës kam dhënë urdhër: Zjarrr! Nga pozicionet e njësitit *Syri i Shqiponjës* ranë rafale të pandërprera të automatikëve mbi tre kamionët e mbushur me ushtarë serbë, të cilët ranë përtokë. Trupat e tyre mbetën në rrugën e Therandës dhe tokën e Kosovës, mbi të cilën kishin

bërë aq shumë krime, masakra e përdhunime më se dy vjet luftë e gati një shekull pushtim. Disa prej tyre kërcyen nga kamionët dhe ikën.

Ilaz Kadolli e Safet Sylaj në Therandën e çliruar, më 13 qershor 1999.

Pas gjysmë ore paraqitet përsëri në radiolidhje Kaçurrreli, i cili ishte rreth 500 metra larg nesh. Ai njoftonte se një kolonë tjetër me ushtarë serbë po vinte në drejtim të qendrës së qytetit. Ata po vinin me një shpejtësi të madhe, mbi 100 km në orë. Ishte rrezik të na shkelnin. Nuk na mbeti tjetër, pos të qëllonim gomat e kamionëve. Serbët kaluan urën kryesore duke humbur drejtimin dhe duke u përplasur jashtë rrugës. Shumica e tyre ranë të vdekur përtokë, ndërsa dy- tre prej tyre arritën të ikin në drejtim të ambulancës së qytetit, ndërmarrjes pyjore

dhe kah fshati Sopi. Në përleshje me ta mbeti i vrarë ushtari Fadil Elshani nga fshati Sopi. Në këto luftime mbetën të vrarë edhe shumë ushtarë të armikut dhe u shkatërrua makineria e tij luftarake.

Beteja e 13 qershorit 1999 kundër forcave pushtuese serbe zgjati mbi 12 orë, nga ora 6 e mëngjesit deri ne orët e mbrëmjes. Më 13 qershor Theranda u çlirua përfundimisht nga pushtimi shekullor serb, falë gjakut të mbi 100 dëshmorëve të saj, që do të prehen përjetësisht në Parkun e dëshmorëve në Therandën e lirë.

Për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin kombëtar janë flijuar shumë breza shqiptarë. Mirëpo, brezi im, brezi i artë i UÇK-së, pati fatin ta çlirojë Kosovën nga pushtimi serb. Për lirinë është nder të vdesësh, por është fat i madh ta përjetosh edhe dritën e saj.

LUFTA NË KOSOVË

Gjenocidi serb dhe konventat ndërkombëtare

Të dëshpëruar nga humbjet e njëpasnjëshme, serbët filluan të hakmerreshin mbi popullatën civile, veprim që ishte në kundërshtim me çdo normë morale dhe me konventat ndërkombëtare të luftës.

Popullsia civile, objektet e kultit, monumentet e kulturës, shkollat dhe spitalet në kohë lufte kanë trajtim të veçantë. Ato mbrohen edhe me konventat ndërkombëtare, siç është Konventa e Gjenevës e gushtit 1949.

Të theksojmë vetëm disa pjesë të kësaj konvente:

Neni 3 i Konventës se Gjenevës:

Në rast të konfliktit të armatosur që nuk është i karakterit ndërkombëtar e që ndodh në territorin e njërës nga palët, secila nga palët në konflikt duhet të zbatojë të paktën dispozitat në vijim:

1. Personat që nuk marrin pjesë aktive në armiqësi, përfshirë pjesëtarët e forcave të armatosura që janë dorëzuar dhe personat që janë nxjerrë jashtë luftimit për shkak të sëmundjes, plagosjes, mbajtjes në burg, ose për ndonjë shkak tjetër, do të trajtohen në të gjitha rrethanat në mënyrë të njerëzishme, pa asnjë dallim për shkak race, ngjyre, feje ose besimi, seksi, origjine a pasurie ose të çfarëdo kriteri tjetër të këtij lloji.

Për këtë qëllim janë të ndaluara dhe mbeten të ndaluara në çdo kohë dhe në çdo vend ndaj personave

të sipërpërmendur:

a) dhuna ndaj jetës ose integritetit fizik, sidomos vrasja në të gjitha format e saj, gjymtimet, trajtimi i vrazhdë dhe tortura, marrja e pengjeve, dhuna kundër dinjitetit personal, dënimet dhe ekzekutimet e bëra pa aktgjykim të një gjykate të formuar në mënyrë të rregullt, që ofron të gjitha garancitë gjyqësore të njohura si të domosdoshme nga popujt e qytetëruar.

Pjesa e dytë e Konventës bën fjalë për mbrojtjen e përgjithshme të popullatave nga pasojat e caktuara të luftës. Nene të veçanta i dedikohen popullatës civile në konflikt, pa dallim race, kombësie, feje a opinioni politik dhe synojnë pakësimin e vuajtjeve nga lufta.

Të plagosurit, gratë shtatzëna dhe të gjymtuarit gëzojnë një mbrojtje dhe trajtim të veçantë.

Thuhet se nuk ka armik e pushtues të mirë, por serbët ishin me të vërtetë pushtues barbarë e qyqarë. Ata sa herë humbnin betejat me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, shfryheshin duke vrarë civilë të pafajshëm dhe të pambrojtur. Ata vranë në mënyrë sistematike civilë, gra e burra, pleq e të rinj, gra shtatzëna, foshnja në djep e fëmijë të pafajshëm, me qëllim spastrimi etnik të Kosovës.

Janë të njohura për opinionin vendës e ndërkombëtar masakrat ndaj civilëve shqiptarë në Drenicë e Dukagjin, në Rahavec, Prizren e Therandë, në Raçak e në të gjitha anët e Kosovës.

Në komunat Rahavec, Malishevë, Therandë, Prizren e Sharr forcat serbe vranë e masakruan mbi 3000 civilë të pambrojtur.

Vetëm në komunën e Rahavecit ushtria e policia serbe vranë, masakruan e dhunuan mbi 1700 civilë të pafajshëm: femijë, gra, pleq dhe të rinj të pambrojtur. Krimi më i rëndë serb u bë në Krushë të Madhe, kur më 25- 27 mars 1999 u vranë e masakruan 241 banorë të Krushës së Madhe dhe 116 të tjerë të Krushës së Vogël.

Në Therandë me rrethinë u vranë mbi 700 qytetarë të pafajshëm dhe të pambrojtur. Krimin më të rëndë serbët e bënë ndaj familjes Berisha në qendër të Therandës. Pasi më parë ua kishin plaçkitur të gjitha paratë e gjësendet e vlefshme, rreth 50 pjesëtarë të kësaj familjeje i futën në një lokal në qendrën zejtare dhe i kositën mizorisht me rafale automatikësh. Trupat e tyre të vrarë u hodhën në deponinë e fshatit Lubishtë të Prizrenit, ndërsa me vonë, për t'i fshehur gjurmët e krimit, ato kufoma u dërguan me një autofrigorifer në Serbi, për t'i hedhur më në fund në lumin Danub.

Një krim të ngjashëm forcat serbe kryen më 25 mars 1999 edhe në fshatin Taraxhë të Therandës. Fashistët serbë vranë në shtëpitë e tyre 42 civilë të pambrojtur: gra, fëmijë e pleq. Trupat e të vrarëve serbët i hodhën në një gropë shpelle në vendin Lugu i Gjeraqinave pranë fshatit Breznë të Sharrit (*Dragash*)

Në fshatin Bukosh të Therandës, më 3 maj 1999, policia e ushtria serbe kishin ndalur kolonën me civilë shqiptarë, që po iknin nga terrori serb.

Njëzet e tre të rinj të moshës 18-30-vjeçare i ndajnë nga kolona, i ngujojnë në Shkollën fillore të Bukoshit, ku i torturojnë dhe në fund i korrin me automatikë.

Kur vizituam shkollën më 14 qershor 1999, oborri dhe korridoret e saj ishin plot gjak, ndërsa nëpër mure vëreheshin tru të të masakruarve. Aty gjetëm edhe mjetet e torturës mizore: thika, sëpata, kazma dhe një cung me tel, ku ishin masakruar ata.

Për t'i humbur gjurmët e këtij krimi dhe për të shfryrë urrejtjen antishqiptare, fashistët serbë ia kishin vënë flakën shkollës, ndërsa kufomat e gjymtuara ishin fshehur në një gropë në varrezat e Therandës.

Nga gjithë ajo që kishte shpëtuar pa djegur, ishin fotografitë e rilindësve tanë, Abdylit, Naimit e Samiut, emrat e të cilëve mban me krenari shkolla fillore e Bukoshit.

Sipas informacioneve që kishte siguruar UÇK-ja, urdhrin për ekzekutimin e këtyre 23 të rinjve më 3 maj 1999 në oborrin e shkollës së Bukoshit e kishte dhënë vetë kryeudbashi serb Milorad Nisheviç-Mishki me komandantët e policisë serbe në Prizren, Miroslav Petroviç, Gradimir Zekavica dhe Milan Shipka.

Gjurmët e masakrimit serb të 23 të rinjve shqiptarë në Bukosh të Therandës, më 3 maj 1999.

Pas luftës shkolla u rindërtua sërish. Abetarja e parë u shkrua me gjakun e martirëve rrëzë mureve të saj. Gjurmët e gjakut dhe të plumbave të këtij krimi barbar serb janë ende në muret e shkollës, bashkë me pllakën përkujtimore me emrat e martirëve. Ato ia përkujtojnë brezit të ri çmimin e shtrenjtë të lirisë.

Më 26 maj 1999 forcat policore të Prizrenit rrethojnë në orët e hershme të mëngjesit lagjen Tusus, ku masakrojnë e ekzekutojne 27 civilë shqiptarë.

Të gjitha këto krime serbe ndaj civilëve shqiptarë në rajonin e Therandës, Prizrenit, Rahavecit e Sharrit u kryen në mënyrë të organizuar nga policia e ushtria serbe, me urdhër e pjesëmarrje të eprorëve policorë: Milorad Nisheviç (Mishki), shef i Sigurimit serb për rajonin e Prizrenit, Radojko Repanoviç, komandant i Stacionit policor serb në Therandë, kolonel Gradimir Zekavica, komandanti i Stacionit policor në Priz-

ren dhe nënkolonel Milan Gjurishiç, kolonel Milosh Vojinoviç, kolonel Bozhidar Deliç, me pjesëmarrjen edhe të policëve të tjerë të stacioneve policore në rajonin e Prizrenit.

Gradimir Zekavica urdhëroi e udhëhoqi personalisht operacionin e masakrës në lagjenTusus të Prizrenit më 26 maj 1999, kur u ekzekutuan 27 civilë të pafajshëm shqiptarë.

Të citojmë edhe disa pjesë nga konventa e mësipërme:

Spitalet civile të ngritura për mjekimin e të plagosurve, të të sëmurëve, të të gjymtuarve dhe të grave shtatzëna nuk mund të sulmohen në asnjë rast, por duhet të respektohen dhe të mbrohen.

Gratë të mbrohen në mënyrë të veçantë kundër çdo shkeljeje të nderit të tyre, sidomos kundër dhunimit, detyrimit për prostitucion dhe kundër çdo akti tjetër fyes.

Ushtria dhe policia serbe në luftën e Kosovës, duke shkelur të gjitha normat dhe ligjet e luftës, dhunuan në mënyrë sistematike gra e vajza shqiptare të Kosovës, madje edhe vajza të mitura të moshës 12, 13 e 14-vjeçare. Në shumë raste këto dhunime u bënë edhe në prani të prindërve dhe të familjarëve të tyre, duke cenuar rëndë nderin e dinjitetin e tyre familjar. Në tërë Kosovën u dhunuan nga ushtarët e policët serbë mijëra vajza dhe gra shqiptare. Fatkeqësisht, numri i saktë i tyre nuk do të dihet kurrë, për shkak të ndjeshmërisë morale e psikike të viktimave dhe familjarëve të tyre.

Prania e personave të mbrojtur nuk mund të përdoret për të fituar pikë ose zona imune ndaj opera-

cioneve ushtarake.

Serbët edhe në këso rastesh keqpërdorën në mënyrë perfide turmat civile për të fshehur veten dhe makinerinë e tyre luftarake. Në mesin e kolonave të civilëve dhe të automjeteve që largoheshin me dhunë në drejtim të Shqipërisë, ata kamuflonin tanket e autoblindat e tyre për t'iu shmangur goditjeve të UÇK- së dhe bombardimeve të NATO- s. Një rast konkret i këtij abuzimi kriminal është bombardimi nga NATO- ja i civilëve në fshatin Korishë të Prizrenit, në maj 1999, kur serbët kishin futur në mesin e civilëve tanket e tyre.

Kishte raste të shumta kur serbët, për t'iu shmangur goditjeve, bënin transportimin e ushtarëve dhe të personelit tjetër me autobusë të përzier me udhëtarë civilë.

Neni 32 i Konventës:

Palët nuk guxojnë të shkaktojnë vuajtje fizike, ose shfarosjen e personave të mbrojtur, që ndodhen nën pushtetin e tyre.

Në shumë raste në luftën e Kosovës pushtuesi serb, edhe pse burgjet ishin nën kontrollin shtetëror, vriste e torturonte të burgosurit dhe robërit e luftës. Rasti me flagrant është vrasja masive në burgun e Drejanës (*Dubravë)* të Burimit (*Istog)*. Ky krim njihet me emrin Masakra e burgut të Drejanës, në të cilën me urdhër të autoriteteve serbe dhe nga vetë gardianët e burgut u vranë mbi 120 të burgosur shqiptarë, ndërsa u gjymtuan e torturuan qindra të tjerë.

Me Konventën e Gjenevës ndalohej edhe grabitja.

Serbët kanë në gjak dhe traditë nacionale grabitjen e plaçkitjen. Para se t'u vinin flakën shtëpive shqip-

tare, ata plaçkisnin gjithçka që gjenin aty: stolitë e arit, teknikën e bardhë dhe televizorët. Grabitja e stolive të arit dhe e parave ishte një dukuri për të gjithë refugjatët, që largoheshin në kolona në drejtim të Shqipërisë e të Maqedonisë.

Kishte raste kur barbarët serbë ua shkulnin nga veshët e gjoksi ato pak stoli që mbanin femrat shqiptare.

Në shumë raste këto grabitje të shtëpive e fshatrave shqiptare, serbët i paguan edhe me lëkurën e tyre.

Me Konventën e Gjenevës ndalohej edhe marrja peng e personave.

Shumë shqiptarë gjatë luftës u morën peng dhe edhe sot nuk dihet gjë për fatin e tyre.

Edhe 17 vjet pas përfundimit të luftës, mijëra kufoma të shqiptarëve të vrarë po mbahen peng nga qeveritë serbe. Serbët po nxjerrin me kufoma përfitime politike nga koncesionet ndërkombëtare.

Gjatë luftës serbët dogjën e shkatërruan me qindra objekte të kulturës, shkolla, spitale e objekte fetare. As sot e kësaj dite Muzeut të Kosovës nuk i janë kthyer eksponantet e grabitura me vlerë arkeologjike e historike.

Ishte ky një gjenocid i paparë ndaj një populli të pambrojtur: mbi 13.000 civilë të vrarë, mijëra të plagosur, mijëra gra e vajza të dhunuara, mijëra objekte e shtëpi të shkatërruara dhe shumë dëme të tjera materiale. Përkundër gjithë këtyre krimeve gjenocidale, edhe 17 vjet pas përfundimit të luftës qeveritë e Kosovës dhe organet përkatëse të ndjekjes nuk janë në gjendje t'i denoncojnë shkaktarët e këtyre krimeve para organeve të drejtësisë vendore e ndërkombëtare.

Pa vendosjen e drejtësisë në vend dhe pa dënimin e krimeve të luftës, gjaku e eshtrat e dëshmorëve dhe martirëve nuk do të prehen të qetë.

Sprovat diversive

Pastërtia e luftës së UÇK-së, sidomos në Zonën Operative të Pashtrikut, bëri që lufta në këtë zonë të fitojë përkrahjen më të madhe nga të gjitha shtresat e qytetarëve të Therandës dhe të gjitha subjektet politike në këtë anë. Falë këtij përkushtimi e mobilizimi lufta në këtë anë kishte marrë karakter gjithëpopullor. Vetëm në Brigadën 123 numri i ushtarëve kishte kaluar shifrën mbi 1400. Ishin konsoliduar radhët dhe ishte fituar përvojë në luftimet me armikun serb.

Të kota ishin përpjekjet e shërbimeve sekrete serbe dhe shërbëtorëve të tyre që luftës së shenjtë të UÇK-së t'i jepnin ngjyrime ekstremiste fetare e terroriste.

Të kota ishin përpjekjet e të ashtuquajturve xhihadistë, farkistë e disfatistë, që në këtë zonë të luftës të fusin farën e përçarjes brenda UÇK-së.

Ndaj infiltrimit të individëve e grupeve të tyre në radhët e UÇK- së, gjithnje kërkohej intervenim i shpejtë, sepse situata mund të dilte jashtë kontrollit.

Me një intervenim të shpejtë e të vendosur, së bashku me Muharrem Dinën (*Mixhën*), Halil Çadrakun (*Fatosin*) dhe Xhavit Bajraktarin arritëm të bindnim një grup ushtarësh 30- 40 veta nga rrethi i Prizrenit, që vepronte mes fshatrave Apterrush e Zoqishtë. Ky grup ushtarësh në shkurt 1999 kishte siguruar një bazë në disa shtëpi të Apterrushit dhe kishte filluar disa stërvitje ushtarake. Ata mbanin uniforma të zeza

me simbole fetare e mbishkrime arabe dhe shami të zeza në kokë. Pas një bisede të shtruar me ta, duke ua sqaruar rrezikun e përçarjes dhe pasojat që mund të kishte lufta jonë, ata pranuan më në fund t'i hiqnin simbolet fetare e të rreshtohen në formacionet nën komandën e UÇK-së.

Një përpjekje të rrezikshme bënë edhe disa elementë disfatistë e burracakë gjate fillimgushtit 1998 në fshatin Nepërbisht të Therandës. Aty disa individë që nuk besonin në luftën dhe në fitorën e saj kishin përpiluar një peticion me nënshkrime të mbi 20 pleqve të manipuluar të fshatit, ku kërkohej nga UÇK-ja t'i tërhiqte pozicionet e ushtarët nga ky fshat.

Ky veprim i organizuar i disfatistëve e të manipuluarve kishte shkaktuar një shqetësim të madh në komandën e Brigadës 123 dhe të Zonës Operative të Pashtrikut.

Si ishte e mundur që fshatarët të kërkonin një gjë të tillë? Mos vallë robëria serbe u dukej më e ëmbël se lufta për liri?! Tërheqja e forcave tona nga ky fshat nënkuptonte që një skenar i tillë mund të përsëritej edhe në fshatrat e tjera. Edhe në këtë rast vepruam shpejt dhe me vendosmëri. Arrestuam organizatorin e këtij peticioni dhe pas trajtimit me urti të këtij rasti, të gjithë nënshkruesit e peticionit dhe vetë organizatori kërkuan falje, ngase një gjë të tillë e kishin bërë pa parashikuar pasojat dhe nga frika e mosbesimi në fitoren e përgjithshme.

Të kota e të dështuara ishin edhe disa përpjekje të të ashtuquajturit formacion FARK, që tentoi pikërisht në Zonën Operative të Pashtrikut të fuste përçarje e huti brenda radhëve të UÇK-së.

Në janar e shkurt 1999 një përpjekje të tillë në këtë drejtim bëri një ish- oficer i armatës jugosllave, i ashtuquajturi Sylë Kollçaku. Ai, si një mercenar i qeverisë në eksil, gjatë tërë kohës sa qëndroi në Breshanc nuk bëri gjë të mirë për luftën, veçse zhvilloi një propagandë e luftë speciale kundër UÇK-së. Në një takim gjatë janarit 1999 në Komandën e Brigadës 123, ai shpërtheu me urrejtjen më të madhe:

- Ç'është kjo ushtri me bolla e gjarpërinj? Dikush duhet të mbështetet për muri për këtë luftë të nisur!

Në shënjestër kishte liderët e UÇK- së, që kishin filluar luftën kundër një force të madhe ushtarake. Për një moment humba fare, nuk dija në isha në Komandën e brigadës apo në ndonjë zyrë të UDB- së! I revoltuar i thashë:

Kështu si ti mendojnë edhe serbët, të mbështesin për muri e të qesin para togës jo vetëm liderët e UÇK-së, por tërë popullin tonë!

Në këtë situatë të tendosur ndërhyri një epror tjetër, duke e arsyetuar se është nervoz dhe nuk di ç'flet.

Ish-oficeri jugosllav Sylë Kollçaku kishte provokuar disa herë gjatë shkurtit e marsit 1999, duke vendosur në zyrën e tij në Breshanc simbole e flamuj të të ashtuquajturit formacion FARK, që deri atëherë ishte dëshmuar sabotues i luftës për liri. Pas intervenimit nga Shtabi i Përgjithshëm ai ishte penguar në realizimin e qëllimeve të tij.

Disa ditë pa filluar ofensiva serbe e marsit 1999, ai Syla, bashkë me një mercenar turk, kishin dezertuar e ikur natën në drejtim të lumit Drin dhe kufirit me Shqipërinë, për të mos u kthyer kurrë më.

Kështu dështuan edhe përpjekjet e xhihadistëve, farkistëve e shërbimeve të tjera armike për ta shndërruar luftën e pastër të UÇK- së në një luftë fetare e civile. Qëllimi i serbëve ishte që skenari i Bosnjës dhe i luftës vëllavrasëse të përsëritej edhe në Luftën çlirimtare të Kosovës 1998- 1999.

Situata të ndjeshme krijoheshin kur ushtria e policia serbe ndërmerrnin ofensiva ushtarake, kur ato zgjatnin me ditë e javë të tëra dhe kur harxhohej municioni. Atëherë kishte rrezik që në mesin e ushtarëve të rinj e pa pervojë të binte edhe morali luftarak.

Në këto situata kërkohej t'u jepnim kurajë ushtarëve të dërrmuar nga lodhja, pagjumësia dhe mungesa e ushqimeve. Inspektonim vijat e frontit dhe bisedonim pothuajse me të gjithë ushtarët, duke u dhënë zemër:

- Do të kalojë shpejt edhe kjo furtunë dhe do të dalë dielli. Kjo është toka jonë dhe serbët do t'i shporrim nga këtu. Së shpejti do të pimë kafe në Shadërvan të Prizrenit...

Asnjëherë nuk më shqiten nga mendja ato fytyra të zbehta të ushtarëve të rinj, të cilët, kur u jepnim zemër, na shikonin në dritë të syrit dhe mbusheshin me frymëzim për të vazhduar luftën çlirimtare.

Politikuajt

Shumë herë gjatë luftës ushtarët e rinj bënin vërejtje se përse në luftën çlirimtare nuk angazhoheshin edhe intelektualët e Kosovës? Kjo ishte përsëritur disa herë edhe nga fshatarët, që frikoheshin ose i përtonin luftës. Mirëpo, intelektualët e vërtetë ishin angazhuar me kohë në përgatitjen dhe zhvillimin e

luftës. Fjalën e kishin pikërisht për të ashtuquajturit intelektualë, që jo vetëm nuk kontribuonin asgjë për luftën çlirimtare, por në forma ndryshme e penguan dhe sabotuan atë. Këtu prinin liderthit partiakë me politikën e tyre kapitulluese. Vështruar në një restrospektivë, del se kuajt e luftës kishin kontribuar më shumë se politikuajt tanë.

Që pa filluar lufta, një veteran i Lëvizjes na pati këshilluar se në luftë do të na duhen të gjithë, që nga fshatari i varfër dhe kuajt e tyre të lodhur. Me kuaj do të bartni armë e ushqime, por edhe të plagosurit.

Mirëpo, çfarë bënin liderthit politikë të Kosovës gjatë luftës, kur kuajt gjysmë të uritur të zonës së Hasit e të Veriut bënin shumë për lirinë tonë? Një numër i politikuajve tanë ia ndien që herët erën luftës dhe ia mbathën në Perëndim. Shumë intelektualë tanë ia mësynë kufirit me Maqedoninë, duke mallkuar Bllacën. Të tjerët bënë propagandë me shumë zell kundër luftës. Shumë prej tyre zunë qafën në plazhet e Adriatikut e të Jonit, ku u rrezitën si derrat në diell derisa përfundoi lufta. Disa të tjerë morën guxim të depërtojnë edhe në zonat e luftës dhe t'u bëjnë thirrje ushtarëve për dorëzimin e armëve. Lideri i mjerë i Kosovës (i ashtuquajturi president historik), në momentin më të vështirë për vendin, përfundoi në shtrofkën e kryekasapit Milosheviç, mu në kohën kur në përkrahje të luftës sonë çlirimtare ishte rreshtuar edhe faktori ndërkombëtar me Aleancën e NATO-s. Presidenti i mjerë bënte thirrje në Beograd të ndaleshin sulmet e NATO-s dhe UÇK-së ndaj ushtrisë okupuese serbe, sepse ai do të bënte mrekulli me Milosheviçin!

Mirëpo, thirrjet e tij të burracakut nuk i përfilli as NATO- ja, as UÇK-ja, sepse ndryshe Kosova do të fshihej nga harta e dheut dhe do të harrohej emri i saj.

Përkrahësit e Rugovës, pikërisht ata që sabotuan luftën, i ngritën liderit të tyre në qendër të Prishtinës një përmendore të lartë, që nuk e meritonte dhe ku nuk e kishte vendin.

Ndoshta aty do të qëndronte më bukur monumenti i Kalit të luftës!

Gjithnjë në emër të luftës në Kosovë, e ashtuquajtura qeveri në eksil grumbulloi e zhvati nga mërgimtarët tanë miliona marka, franga e dollarë, duke abuzuar në mënyrën më të paskrupull djersën e gjakun e popullit. A nuk ishte abuzim kur me paratë e mbledhura në emër të luftës e pavarësisë, paguheshin si mercenarë njerëz që nuk kishin të bënin fare me luftën?

Në Tiranë dhe qendra të tjera të Europës mbahej një administratë e tërë, nëpunësit e së cilës sorollateshin nëpër hotelet më luksoze dhe rreziteshin si derra plazheve të detit.

E ashtuquajtura ministri e financave e qeverisë në eksil hapi edhe institucione bankare, kinse për të ruajtur ndihmesën e mërgimtarëve. Të autorizuarit për këto mjete, në vend se t'i dërgonin ato për nevoja lufte, i keqpërdorën në mënyrën me të paskrupull pas përfundimit të luftës, duke bërë fushatë kundër luftës dhe duke ngritur biznese vetëm për përkrahësit e tyre partiakë. Dhe në fund, për të fshehur krimin, falimentuan "Dardania-Bankën", që nuk ishte tjetër veçse një formë perfide për të sabotuar luftën kundër pushtuesit shekullor.

Të gjitha këto marifete i bënë, ngase nuk kishin besim në forcën e popullit të tyre. Çdo gjë matnin me kutin e tyre prej burracakësh, kur frika e tepruar rrëshqet në tradhti. Mirëpo, kjo herët a vonë do të sqarohet dhe sabotatorët e luftës do të përgjigjen para drejtësisë.

Lufta e pastër e UÇK-së

Përgjithësisht Lufta jonë çlirimtare ishte e drejtë dhe e pastër, duke respektuar konventat ndërkombëtare të luftës për civilët dhe robërit e luftës. Kjo bëri që lufta e UÇK- së të fitonte përkrahjen e opinionit demokratik dhe të faktorit ndërkombëtar me aleancën më të madhe ushtarake, Paktin NATO në krye.

UÇK-ja ruajti me fanatizëm pastërtinë e luftës çlirimtare nga etiketimet e jashtme, që kërkonin t'i jepnin asaj karakter fetar e terrorist.

Vlen të përmenden vetëm disa raste gjatë luftës sonë, që e dëshmojnë këtë. Policia serbe gjatë luftës kishte mobilizuar e armatosur gjithë civilët serbë, duke keqpërdorur madje edhe objektet fetare serbe.

Gjatë korrikut e gushtit 1998 lufta kishte përfshirë pjesën më të madhe të Zonës Operative të Pashtrikut. Luftime përmasash të mëdha zhvilloheshin në rrethinat e Rahavecit dhe të Therandës.

Nga Shtabi i Përgjithshëm kërkohej që Brigada 123 të ndi+qishtë e Apterrush. Nga kisha e Zoqishtës pati të shtëna me armë në drejtim të ushtarëve tanë. Nuk dihej a kishte në atë objekt ushtarë e policë serbë, apo vetë personeli i kishës po qëllonte në drejtimin tonë.

Kisha e Zoqishtës ishte ndër monumentet e vjetra të ritit ortodoks, për të cilën thuhej se para ardhjes së sllavëve kishte qenë iliro- shqiptare. Ajo ishte në zonën tonë të veprimit dhe nën kontrollin tonë.

Nuk e kishim vështirë të dëmtonim edhe kishën, edhe njerëzit që rrezikonin me armë ushtarët tanë. Pas një rrethimi të kujdesshëm, serbët i pushuan gjuajtjet. Iu bë thirrje të dorëzoheshin të gjithë ata që gjendeshin në kishë.

Nga dera kryesore e kishës doli një njeri me të zeza. Në dorën e ngritur mbante një karton të bardhë me mbishkrimin *dorëzohemi* në gjuhën serbe. Prapa tij fillojnë të dalin ngadalë e në radhë nga kisha njerëz të veshur me të zeza, të gjithë klerikë e personel kishe, që në popull njihen si popa. Në kishë kishte edhe disa femra që shërbenin si personel ose ishin gra fshati. Ushtarët tanë u futën ngadalë dhe të sigurt brenda kishës. Duhej kontrolluar çdo skutë për gjetjen e armëve, që disa orë rresht kishin rrezikuar ushtarët tanë.

Klerikët, të gjithë sa ishin, qëndronin në këmbë në oborr para hyrjes së kishës, të frikësuar dhe me duar të ngritura lart. Pas 10-15 minutash ushtarët tanë dolën nga kisha të ngarkuar me plot armë të të gjithë kalibrave. Kishte pushkë 20-she, automatikë kallashë të prodhimit jugosllav, një mitraloz i ri dhe shumë municion. Ushtarët i pyeta a kishin kontrolluar çdo gjë dhe në mos kishin mbetur pjesë të pakontrolluara. Ata thanë se kontrolli ishte bërë edhe në trupat e klerikëve.

Atë që doli i pari dhe nga veshja dukej se ishte kryepop i kishës e urdhërova të shikonte armët që u nxorën nga kisha dhe ishin vendosur në një qoshe të

oborrit. Pasi i shikoi mirë, e pyeta në gjuhën serbe: *Pope, da li imaš još oružja?* (Pop, a ke edhe armë të tjera?) Për një moment ai u zbeh edhe më tepër dhe nuk foli. Nga vonesa në përgjigje dhe nga fytyra e zverdhur, vërejta se ai po fshihte diçka. Iu drejtova edhe një herë:

- Pop, për herë të fundit po të pyes, a ke edhe armë të tjera?" Ai ngriti kokën ngadalë dhe me shikim prej dhelpre u përgjigj:

- Po, kam edhe një, – tha duke çuar ngadalë dorën nga pjesa e përparme e rripit. E urdhërova të mos bënte asnjë lëvizje as me duar, as me këmbë. Një ushtar yni futi dorën nën rripin e përparmë të pantallonave të popit. Gati nga fundi i brekëve të tij nxori një revole të vogël. Ishte e kalibrit të vogël të prodhimit "Crvena zastava", shumë e bukur, si e porositur për trofe lufte. Xhavit Bajraktari, tani dëshmor i kombit, me qetësinë e një profesionisti bëri incizimin e ngjarjes së popave, personelit të kishës dhe të armëve të konfiskuara. Pavarësisht se i paralajmëruam të ndiheshin të sigurt se nuk do të pësonin asgjë, shihej qartë se ata dridheshin nga frika. Në mesin e tyre ishin edhe dy burra nga qyteti i Nishit. Nga biseda me ta kuptuam që aty kishte njerëz që nuk ishin personel kishe. Kjo u provua lehtë, sepse dy prej tyre nuk kishin haber për historikun e kishës. Madje ata lehtë identifikoheshin edhe nga veshja, sepse mbanin xhinse dhe këpucë terreni. Pelerina e tyre e zezë shërbente vetëm për maskim. Dukej qartë se ata nuk qëndronin rastësisht në kohë lufte në atë kishë.

Edhe pse ishin nga qyteti i Nishit, ata nuk kishin as njohuri për origjinën e lashtë të emrit të qytetit të tyre. Madje dy të ardhurit nga Nishi nuk kishin as njohuri elementare për kryeqendrën e kishës ortodokse. Herë thoshin se ajo është në Moskë, herë në Beograd. Pavarësisht kësaj, ne u treguam klerikëve se UÇK-ja nuk është ushtri banditësh, si ajo e tyre që vret klerikë, gra e fëmijë. I strehuam, u dhamë bukë e ujë dhe të nesërmen, të gjithë sa ishin, ua dorëzuam me protokoll zyrtar Kryqit të Kuq Ndërkombëtar.

Popat rrëfyen në hollësi se armët që u konfiskuan në kishë ishin futur pa dëshirën e tyre nga policia serbe. Megjithatë, ne ishim të vetëdijshëm që kisha serbe dhe klerikët e saj kanë qenë gjithmonë në shërbim të politikës gjenocidale serbe. Në shumë raste kisha serbe u ka paraprirë autoriteteve pushtuese serbe për shkombëtarizimin dhe zhdukjen e elementit shqiptar në troje tona. Ata ndoshta edhe e meritonin plumbin kokës, mirëpo me këtë do të përfitonte propaganda serbe. Kisha do t'i shpallte shenjtorë, ndërsa qeveria serbe do ta përdorte këtë rast për të goditur e kompromet uar luftën e pastër të UÇK- së para faktorit ndërkombëtar.

Ishim të sigurt se gazetarë nga e gjithë bota do të interesoheshin për fatin e klerikëve serbë. Me vëmendje përcollëm edhe deklarimet e tyre para mjeteve të informimit. Për çudi, kryepopi serb nuk pranoi të binte në provokimet e gazetarëve serbë dhe të huaj. Ai në të gjitha intervistat që dha në Prishtinë, Graçanicë dhe në Beograd, u shpreh: *UÇK-ja nuk është një organizatë a grup terrorist, siç etiketohet, por një ushtri e rregullt që zbaton me përpikëri rregullat e luftës*.

Për rastin e kishës dhe të klerikëve serbë, shtëpitë e filmit në Rusinë e Putinit bënë pas luftës edhe një film horror, duke shtrembëruar ngjarjen në tërësi, për qëllime propagandistike raciste e fashistoide, kinse klerikët serbë ishin kidnapuar nga UÇK-ja dhe ishin liruar me forcë nga njësitë speciale ruse, që në atë kohë luftonin në anën e serbëve kundër UÇK-së.

Pothuajse në të njëjtën ditë kur u liruan klerikët e Zoqishtës, policët dhe ushtarët serbë në qytetin e Rahavecit kishin masakruar shumë qytetarë civilë, madje edhe ata që ishin strehuar në teqenë e qytetit. Nga barbarët serbë ishte ekzekutuar edhe vetë shehu i teqesë së Rahavecit.

Gjykata ushtarake

Në fillim të marsit 1999 baza e njësitit *Syri i Shqiponjës* ishte zhvendosur nga shtëpia e Ilmaz Papajt nga Vneshta në fshatin Kastër të Therandës, rreth 100 metra pranë Shtabit të Zonës Operative të Pashtrikut. Njëri nga ushtarët në rojë më njoftoi se më kërkonte një epror nga Shtabi i Përgjithshëm. E pyeta kush ishte? Më tha se ishte një burrë i moshuar dhe quhej baca Kolë. Baca Kolë e quanim Sokol Dobrunën nga Gjakova. Me të ishim njohur vite më parë gjatë veprimtarisë së Lëvizjes Popullore të Kosovës, por sidomos gjatë vuajtjes se dënimit në burgun e Drejanës në vitet 1993- 1995. Një kohë të gjatë patëm qëndruar në të njëjtën dhomë burgu. Më erdhi mirë kur e pashë pas kaq vitesh, edhe pse kisha informacione se ai kishte hyrë me kohë në radhet e ushtrisë sonë dhe shërbente në Shtabin e Përgjithshëm.

U ulëm në një dhomë të vogël në Shtabin e Zonës së Pashtrikut. Fillimisht përkujtuam kohën e burgut dhe shkëmbyem informacione për gjendjen organizative e rrjedhën e luftës.

Kola më njoftoi arsyen e ardhjes në Zonën Operative të Pashtrikut, përkatësisht takimin me mua. Më njoftoi se Shtabi i Përgjithshëm kishte marrë vendim për themelimin e Gjykatës ushtarake të UÇK-së, ndërsa ai ishte ngarkuar të shtrinte degët e kësaj gjykate në të gjitha zonat ushtarake. Në fillim ato do të vepronin si shërbime juridike, ndërsa aty ku kishte kushte edhe si gjykatë, që do të ishin të lidhura me qendrën në Shtabin e Përgjithshëm. Kola më bëri të ditur se unë isha caktuar të organizoja Gjykatën ushtarake në Zonën Operative të Pashtrikut, ndërsa urdhëresa do të më vinte më vonë përmes korrierëve. Baca Kolë më kishte pasur parasysh për shkak të njohjes së mëhershme dhe të profesionit tim jurist. Biseduam edhe për ushtarë të tjerë, që mund të shërbenin në gjykatën ushtarake. U përmendën emrat e juristëve, si Nuredin Abazi, Emri Gashi dhe të tjerë, me të cilët në fillim do të formohej shërbimi juridik në kuadër të zonës, ndërsa më vonë edhe vetë gjykata ushtarake. Me bacën Kolë u pajtuam që gjykata ushtarake në fillim të trajtonte raste të veçanta, ndonjë shkelje disiplinore nga ushtarët e zonës. Unë do të kryja detyrën e prokurorit a hetuesit të zonës, ndërsa rastet e rënda do të dërgoheshin në Shtabin e Përgjithshëm. Megjithëse kjo ishte një ngarkesë shtesë për mua, unë pranova detyrën, i bindur se themelimi i Gjykatës ushtarake si mekanizëm i domosdoshëm i ushtrisë do të rriste disiplinën së pari në vetë radhët

e ushtrisë sonë, si dhe autoritetin e ushtrisë në popull dhe tek faktori ndërkombëtar. Vetëgjyqësia ndëshkohet me ligj në drejtësi dhe kjo nuk duhet të ndodhë në asnjë rrethanë, as në kohë lufte.

Zona e veprimit dhe territori që kontrollohej nga Zona Operative e Pashtrikut ishte shumë e gjerë. Kjo zonë përfshinte komunat Prizren, Sharr, Therandë, Rahavec e Malishevë. Edhe në këtë rajon të gjerë kishte probleme të ndryshme në kohë lufte. Kishte qytetarë që kryenin vepra të ndryshme penale kundër jetës e trupit, si vrasje, tentimvrasje dhe lëndime trupore. Një rast i vrasjes gjatë luftës kishte ndodhur për motive të ulëta të hakmarrjes në fshatin Dushkajë (*Dubravë*) të Therandës. Edhe sot e kësaj ditë kryesi i veprës nuk është marrë asnjëherë në përgjegjësi penale. Kishte vepra penale të dëmtimit të pasurisë, si vjedhje e grabitje. Nuk mungonin as raste kur edhe ndonjë ushtar kryente veprime ndesh me ligjin dhe rregulloret e brendshme të ushtrisë. Ndaj tyre shqiptoheshin masat e parapara, si vërejtje e punë e detyrueshme, por edhe çarmatosje e arrestim në raste të veçanta.

Në një rast, në mbarim të luftës, në fshatin Kastër disa ushtarë të entuziazmuar nga nënshkrimi i marrëveshjes se Kumanovës mes NATO-s dhe ushtrisë serbe, shtinë me rafale armësh. Ndaj tyre u shqiptua masa disiplinore për abuzim me armë dhe shkaktim rreziku. Ata u vendosën në izolim 24 orë dhe iu morën armët.

Mjerisht, edhe gjatë luftës ka pasur raste të veçanta të keqpërdorimit të pozitës dhe veprime të kundërligjshme e të vetëgjyqësisë.

Për fat të mirë, në Zonën Operative të Pashtrikut të gjitha rastet ishin të lehta dhe u trajtuan në mënyrë profesionale e korrekte, duke përfunduar me efekte të duhura për të dyshuarit dhe rrethin.

Trajtimi i rasteve

Roja e objektit ku mbaheshin të ndaluarit më njoftoi se kishin sjellë një person të dyshuar për propagandë kundër UÇK- së dhe për dyshim se kishte kontaktuar me forcat serbe. Më sqaroi se ai ishte edhe veprimtar i një partie politike, duke përmendur mbiemrin Rudi. M'u duk si mbiemër i njohur, por nuk e dija se a ishte ai, që kishim takuar në fillim të shtatorit 1998 në fshatrat Rud e Grap, atëherë kur Rudi na pati ndihmuar për strehimin e të plagosurve të luftës. Dhoma në të cilën ishte vendosur i dyshuari ishte një përdhese me beton dhe dyer e dritare të hekurta, që më parë kishte qenë servis i makinave. Në rrethana lufte objekti i plotësonte kushtet e një vendndalimi të përkohshëm. I dyshuari ishte pikërisht ai, Fetah Rudi, që e kisha takuar edhe më herët. Ishte i zbehtë në fytyrë dhe i frikësuar. Ndoshta gjatë arrestimit kishte pësuar edhe ndonjë goditje. E përshëndeta duke u prezantuar e shtrirë dorën, ndërsa ai u prezantua me gjysmë zëri. E pyeta se a dinte arsyen përse ishte këtu.

- Po, - tha Rudi, i dyshuar për propagandë e kontakt me serbët.

E bëra me dije të thoshte të vërtetën, pavarësisht a kishte gabuar, sepse do të merreshin shumë parasysh e vërteta dhe korrektësia. Paraprakisht i dyshuari u

sigurua se nuk do të kishte asnjë presion e kërcënim. Fetahu tani e ndieu veten më të sigurt e më të lirë dhe filloi t'i rrëfejë të gjitha për çfarë dyshohej. Ai deklaroi:

- Nuk kisha besuar se me luftë do të çlirohej vendi dhe kisha dyshuar në mundësitë e forcën e popullit tim. I kam besuar kryetarit të partisë, i cili ka qenë dhe është kundër luftës. Kjo mund të jetë kuptuar edhe si propagandë a qëndrim kundër luftës. Në të vërtetë, luftën e kam ndihmuar sipas takatit tim, si strukturë civile.

Edhe për kontaktet me serbët pranoi një pjesë të përgjegjësisë, që mund të ishte keqkuptuar lehtë.

- Është e vërtetë se gjatë muajve të parë të luftës a derisa nuk kishte ikur Rugova nga Kosova, për çdo të premte kisha marrë pjesë në mbledhjet e partisë, që mbaheshin edhe në kohë lufte në qendër të Prishtinës. Rrugën për në Prishtinë e kisha bërë duke kaluar përmes postblloqeve serbe në udhëkryqin e Komaranit. Shpeshherë isha ndalur nga policët serbë, por nuk kisha dhënë asnjë informacion për UÇK-në. Edhe pse ishte rrezikuar edhe personalisht, udhëtimin përmes Komaranit në kohë lufte e pranonte si një budallallëk të tij. Për Rudin nuk u ofruan prova konkrete të dyshimit. Nga biseda që zhvilluam, nuk u vërejt se ai kishte kryer ndonjë vepër penale. Gjatë dhënies së deklaratës ishte i sinqertë dhe i qartë në sqarime. Nuk kishte arsye të ndëshkohej dhe as të dërgohej në Shtabin e Përgjithshëm.

E pyeta se a ishte i gatshëm të shërbente në ushtri apo të shkonte në shtëpi. Ai shprehu dëshirën të shkonte në shtëpi, ngase familja e tij ishte bërë

merak, por nuk ishte i sigurt të shkonte vetë. Ia siguruam dy ushtarë ta përcillnin deri në fshatin e tij Rud. Disa ushtarëve nuk u pëlqeu vendimi im. Ata nuk dinin se të dyshuarit nuk janë gjithherë edhe të fajshëm, andaj quhen të dyshuar derisa të akuzohen a të shpallen fajtorë.

Menjëherë pas luftës kam mësuar se Rudi, në një pritë qyqare, kishte pësuar keq, duke mbetur i palëvizshëm në karrocë invalidi. Ndoshta atij i është dhënë së paku ndonjë pension lufte.

*

Naimi Tarjani ishte nga fshati Piranë i Prizrenit. Shtabi lokal dyshonte për kontakte të tij me serbët. Ai ishte edhe i rrezikshëm për rrethin dhe për lëvizjet e ushtrisë sonë në atë zonë. Dyshohej me arsye se kishte edhe armë, që i duheshin ushtrisë sonë. Policia ushtarake ishte urdhëruar që ai të arrestohej kur ndodhej në shtëpinë e tij në Piranë. Gjatë tentimit për arrestim, Naimi kishte rezistuar me armë, madje kishte plagosur në dorë një ushtar tonë. Më në fund, Naimi i rrezikshëm ishte prangosur dhe sjellë në Komandën e Zonës së Pashtrikut, së bashku me tre djem të familjes Tarjani. Naimi ishte marrë në pyetje paraprakisht në komandën e brigadës, por ende nuk kishin marrë ndonjë qëndrim për të. Dikush nga komanda kishte propozuar që ai bashkë me tre djemtë e tjerë të dërgohej për trajtim në Shtabin e Përgjithshëm. Në fund kishin vendosur që rasti i tij të trajtohej nga shërbimi juridik i komandës së zonës.

Me Naimin biseduam së bashku me Kaçurrelin. Ai na rrëfeu në tërësi rastin e arrestimit. Plagosjen e ushtarit gjatë arrestimit e kishte bërë pa dashje, nga

frika se mund të vritej. Në pyetjen tonë se përse nuk ishte radhitur deri tash në UÇK, ai ishte përgjigjur se kishte qenë i frikësuar dhe i pasigurt se mund të vritej nga vetë ushtarët tanë. Në pyetjen tjetër se a ishte i gatshëm të qëndronte me ne në shërbim të çlirimit, ai pranoi pa u hamendur, madje tha se në shtëpi kishte një kallash të prodhimit jugosllav dhe se mund ta sillte personalisht në komandën e zonës. Urdhëruam ata tre djem ta sillnin automatikun. Pas një ore arma u soll në dorën tonë, që e mbajta personalisht deri në mbarim të luftës. Naimi u rreshtua në njësitin *Syri i Shqiponjës* dhe shërbeu me përkushtim deri në mbarim të luftës, ndërsa automatiku i tij vazhdoi edhe në luftën e UÇK-së në Maqedoni.

Ushtari i plagosur gjatë arrestimit mbeti i pakënaqur me vendimin tonë, ndërsa disa kërkonin edhe ndëshkim të rëndë për Naimin. Ata reagonin kështu nga ndikimi i rastit e gjendja momentale dhe nga mungesa e përvojës profesionale, pa llogaritur pasojat e përgjegjësitë për të ardhmen.

*

Nuk më kujtohet se në çfarë rrethanash është sjellë Huli nga Zhuri në Komandën e zonës dhe në sektorin ZKZ. Sigurisht edhe ky si i dyshuar për bashkëpunim me serbët. Rastësisht u gjenda në një nga dhomat e ZKZ dhe vërejta një person të panjohur në rroba civile e të zbehtë në fytyrë. Qëndronte në këmbë dhe herë pas here, pa e pyetur, murmuriste diçka ndër hundë. Ai arsyetohej se nuk kishte bërë asgjë kundër ushtrisë sonë. Duke shikuar herë Fatosin, herë Xhavitin, sikur thoshte se këtu jam kot së koti.

Vendosëm që Hulin ta trajtonim së bashku me

Xhavitin. Kishim informacione se më herët persona të panjohur kishin shtënë mbi Hulin rafale automatiku në një rrugë të Zhurit, por kishte shpëtuar. Kishte informacione e dyshime se Huli kontaktonte edhe me policët serbë në stacionin e Zhurit. Huli i rrëfeu të gjitha. Familja e tij kishin ngritur para lufte një kafene në hyrje të Zhurit, në pronë shoqërore të fshatit. Mirëpo, ai nuk ishte penguar as nga autoritetet e atëhershme komunale, as nga policia serbe aty pranë. Sipas tij, ai kishte korruptuar policët me ndonjë para ose kafe, në mënyrë që të heshtnin dhe të mos pengonin ndërtimin e lokalit. Herë pas here Huli betohej se nuk kishte spiunuar askënd dhe se këtë nuk e kishte kërkuar as ndonjë polic serb.

Huli na tregoi se vëllai i tij në Zvicër ishte edhe veprimtar i Lëvizjes Popullore të Kosovës. Natyrisht, me Hulin nuk kishim as kohë, as arsye ta zgjatnim më tepër. E liruam të ikte në shtëpi, por atij nuk ia mbante të shkonte, e lëre me të qëndronte në luftë. Nga zori u desh të bëheshim shokë me Hulin e gjorë. Ai nuk na u nda nga frika. Një ditë, derisa po qëndronim me Xhavit Bajraktarin pranë fshatit Ilirion, pamë dy aeroplanë luftarakë duke ardhur nga drejtimi i fshatrave Zoqishtë e Apterrush. Ata fluturonin aq ulët, sa shihej qartë flamuri trengjyrësh. Një herë kujtuam se ishin fluturake franceze, por kur kaluan shumë ulët mbi ne, lëshuan një breshëri bombash. U shtrimë përdhe në pritje të kalimit të rrezikut. Huli i gjorë nuk kuptonte asgjë se ç'po ndodhte. Vetëm kur kuptoi se ishin aeroplanë serbë dhe kishte kaluar rreziku, ai ua lëshoi një të sharë mbrapa: Ah nanën e shkive!

*

Disa familjarë nga fshati Nishor u paraqitën një ditë në komandën e Zonës Operative të Pashtrikut në Kastër të Therandës. Ata kërkonin ndihmë për dy vëllezër të familjes Bytyçi, që ishin zënë keq mes tyre. Ata kishin ndarë pasurinë e paluajtshme, por jo edhe bagëtinë. Për një kishk buallice pretendonin të dy vëllezërit. Në vendngjarje doli policia ushtarake, por për kureshtje dola edhe unë. Ishte një lagje në anën e epërme të fshatit, me disa shtëpi të dendura në një gropë. Fqinjët nuk kishin arritur ta qetësonin situatën. Gra e fëmijë kishin dalë nga shtëpitë, duke vëzhguar të dy vëllezërit, që ishin lodhur duke qëlluar njëri- tjetrin. Në përleshje kishin përdorur edhe sfurqe të hekurit. Familjarët na lutën t'i arrestonim që të dytë. Policët ushtarakë i sollën të dytë në dhomën e ndalimit. Ata ishin acaruar aq shumë, sa kërkonin edhe dhoma ndaras, ngase nuk mund ta duronin njëri- tjetrin.

Iu thamë se nuk kemi mundësi të tilla dhe nëse doni dorëzohuni në policinë serbe. Aty kanë dhoma të veçanta dhe ndoshta ju trajtojnë më mirë. Të dy vëllezërit u adaptuan për tri ditë dhe nisën të ndanin ushqimin, krevatin e vetëm, madje edhe cigaret. Ata rrinin bashkë, pastronin ambientin dhe shkurtonin dru për ushtrinë. Me ta u bëmë edhe shokë të mirë. Pas luftës ata dy vëllezër kërkuan falje edhe një herë për çoroditjen e tyre.

Kështu, u munduam të trajtonim çdo gjë në mënyrë profesionale e korrekte, edhe pse gjykata ushtarake në nivel të zonave nuk arriti të bëhej funksionale deri në mbarim të luftës.

Likuidimi pa gjyq i Behajdin Allaçit

Ishte fundi i qershorit 1998, kur porsa kishim përfunduar një takim të Brigadës 123, në të cilin ishte analizuar gjendja në terrenin e veprimit. Në të dalë nga komanda takuam Muharrem Dinën- Mixhën. Rrallëherë ai shihej i ngrysur e i shqetësuar aq shumë si atë ditë. I thamë të hynte brenda, por nuk pranoi. Shihej nga fytyra që kishte një shqetësim të thellë.

U larguam paksa nga hyrja e objektit të brigadës për të biseduar më lirshëm. Mixha tregoi në tërësi për rastin e Behajdin Allaçit. Më 12 qershor 1998 ai kishte dalë në luftën e UÇK-së. Atë ditë qershori, në shoqëri edhe me vëllanë e Mixhës, Rifat Dinën, ishin paraqitur në zonën e Rahavecit, përkatësisht në Shtabin e fshatit Drenaj. Me të mbërritur aty, Behajdinit ia kishin vënë prangat, me urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Nuk dihej me saktësi nëse një natë ishte mbajtur i lidhur në Drenaj, por dihet me siguri që Behajdini i prangosur ishte dorëzuar në Shtabin e Përgjithshëm në Altar dhe që nga ai moment nuk dihet asgjë për fatin e tij. Nga dita e arrestimit kishin kaluar rreth njëzet ditë dhe Mixha dyshonte se Behajdinin mund ta kishin vrarë. Dyshimin për mundësinë e vrasjes së tij e përforconte më tepër fakti se familja e të afërmit e Behajdinit, menjëherë pas arrestimit ishin alarmuar e interesuar për fatin e tij në Shtabin e Drenajt, ku kishin marrë garanci se Behajdini ishte dërguar në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së.

Ishte kohë lufte dhe ngjarjet mbulonin njëratjetrën, ndërsa rasti i zhdukjes pa gjurmë të Behajdinit sa vinte e rritej dhe bëhej misterioz.

Tani për fatin e tij interesoheshin edhe shumë veprimtarë të Lëvizjes në Tiranë e diasporë. Behajdini gjatë 10-vjetëshit të fundit ishte ndër udhëheqësit kryesorë të LPK-së, i burgosur politik dhe profesor i filozofisë.

I gjendur përballë një interesimi dhe presioni që po shtohej për fatin e Behajdinit, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së kishte dalë me një komunikatë të ngutshme, në të cilën thuhej se Behajdin Allaçi kishte rënë në krye të detyrës, pa përmendur asnjë detal për rrethanat dhe vendin e rënies. Me këtë komunikatë gjatë tërë kohës së luftës u pushua përkohësisht rasti i zhdukjes pa gjurmë të Behajdinit, edhe pse fjalët për ekzekutimin e tij shtoheshin përditë.

Çështja e zhdukjes se Behajdinit u bë objekt interesimi dhe i bisedave, sidomos menjëherë pas përfundimit të luftës. Rasti i tij nisi të diskutohej në mesin e bashkëveprimtarëve nga të gjitha anët e vendit. Familja dhe bashkëshortja e tij Nazmije Allaçi, të shqetësuara për fatin e tij, disa herë trokitën në zyrat e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, që pas përfundimit të luftës kishte kaluar nga Altari në Prishtinë. Pasi nuk kishte lënë vend pa kërkuar shpjegim, një ditë bashkëshortja e Behajdinit paraqitet edhe në zyrën e LPK-së në Prishtinë. Ajo kërkonte me ngulm të informohej për fatin e burrit të saj, qoftë edhe i hidhur:

- Dua ta di të vërtetën për bashkëshortin tim. Unë e kam njohur e ndier si një veprimtar të pakursyer

të Lëvizjes. Edhe nëse ka gabuar, e dua të vërtetën. Por nëse është vrarë i pafajshëm, i dua së paku eshtrat e tij!

Gjatë vitit 2002 isha me detyrë në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, Zona II mbrojtëse në Prizren. Në atë kohë komandant i zonës ishte Selim Krasniqi. Kur isha me detyrë në zyrën e tij, ai më pyeti për Behajdinin. Selimi tha se kam dëgjuar që ke qenë i burgosur politik me të dhe unë kam dëgjuar fjalë të mira për të. I tregova se Behajdini ka qenë njëri ndër udhëheqësit kryesorë të Lëvizjes. Pastaj e pyeta nga vinte ky interesim për të, ndërsa Selimi më tregoi se kishte qenë i pranishëm kur Behajdini ishte arrestuar në Shtabin e Drenajt në qershor 1998. Kishte ndier keqardhje për arrestimin e tij, por ishte i pafuqishëm për ta kundërshtuar urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm. Madje atij i kishin sugjeruar ta dërgonte personalisht Behajdinin të lidhur në Altar, mirëpo ai nuk kishte pranuar, nga frika se edhe ai mund të pësonte. Një deklaratë me shkrim për rastin e Behajdinit Selimi ia kishte dhënë edhe familjes së tij.

Familjarët e bashkëveprimtarët e Behajdinit dyshojnë me të drejtë se Allaçi është vrarë në mënyrë tinëzare prapa shpinës, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm.

Ndërkaq, pas lufte Behajdini shpallet dëshmor i kombit po nga Shtabi i Përgjithshëm, sigurisht për të mbuluar gjurmët e vrasjes pa gjyq. Edhe 17 vjet pas përfundimit të luftës, Behajdin Allaçit nuk i dihen as varri, as eshtrat e tij. Për likuidimin pa gjyq të veprimtarit dhe atëdhetarit Behajdin Allaçi, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së mban përgjegjësi politike, morale dhe ligjore.

Duket qartë se likuidimi i tij është një akt i dyshimtë.

Gjatë luftës ndodhin edhe gabime dhe kur ato vërtetohen, drejtuesit korrektë pranojnë edhe gabimin, duke kërkuar falje publike për të mos dëmtuar etikën e luftës për liri. Me gjasë, për të pranuar gabimin sot duhet më shumë guxim se për të shkuar në front!

Veprimtarit Behajdin Allaçi as eshtrat nuk i dihen.

PASLUFTA

Monumentet e dëshmorëve

Përfundimi i luftës e gjeti Kosovën të shkatërruar në pjesën më të madhe nga hordhitë barbare serbe. Përparësi jona kryesore tani ishte strehimi dhe ushqimi i popullatës. Njerëzit po ktheheshin me shpejtësi në shtëpitë e tyre të djegura e të rrënuara.

Detyrë e ngutshme ishte gjetja e dëshmorëve e martirëve dhe sistemimi i tyre në vendet e merituara. Caktimi i vendeve për varrezat e dëshmorëve kishte rëndësi të veçantë historike e kulturore. Dëshmorët e heronjtë e luftës duhej të vendoseshin në vendet sa më të bukura, të përshtatshme për familjarët e tyre dhe vizitorët. Për dëshmorët nuk duhej kursyer toka për të cilin kishin rënë. Për këtë u bë një punë e mirë pothuajse në të gjitha zonat e luftës. Për një kohë të shkurtër dëshmorët e rënë në të gjitha zonat e luftës u sistemuan nëpër varreza e parqe të përbashkëta, ku tani prehen të qetë.

Ishte e natyrshme që pas fazës fillestare emergjente të përjetësoheshin në vepra arti gjithë ato sakrifica të mëdha dhe vetë lufta heroike e UÇK-së. Ishte momenti historik që rrugëve, shesheve dhe toponimeve të tjera t'u kthehej identiteti e dinjiteti i tyre iliroshqiptar. Mendova që një ndihmesë të vogël mund ta jepja edhe vetë në Prizren, ku ishte përqendrimi im kryesor. Çdo pushtues që kishte shkelur këtë qytet të bukur shqiptar, kishte lënë gjurmët e tij. Prizreni në të katër anët është i mbushur me objekte të kulturës sllave, turke, ortodokse, sunite e bektashiane.

Kriminelët serbë kishin minuar e shkatërruar me themel Shtëpinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, me qëllim që në këtë qytet të fshinin çdo gjurmë të historisë shqiptare. Menjëherë pas luftës objekti historik i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u ringrit si feniks, edhe më i fortë e më i bukur, si një kopje besnike e objektit të vjetër. Themelet e Shtëpisë historike të Lidhjes ishin çelikosur me gjakun e pastër të burrave më të mirë të kombit që nga Abdyl Frashëri e Ymer Prizreni deri te Xhemajli Berisha, Remzi Ademi e Ismet Jashari. Vetë Lufta çlirimtare në Kosovë kishte karakter gjithëkombëtar, ku ranë djemtë e vajzat më të mira nga të katër anët e atdheut shqiptar. Lufta heroike e UÇK-së ishte vazhdimësi e programit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Pas luftës më lindi ideja dhe ndërmora iniciativën që në këtë qytet të ngrihej një monument për heronjtë e UÇK- së. Pata vlerësuar se një nga figurat kryesore të luftës dhe një hero i përmasës kombëtar ishte Ismet Jashari (*Komandant Kumanova*). Arsyeja që monumenti i Komandant Kumanovës duhej të vendosej në Prizren ishte se ai ndër të parët kishte hapur frontin e luftës çlirimtare dhe vinte nga një skaj i kufirit të atdheut, nga fshati Orizare i Kumanovës. Kështu, ai ishte bërë edhe simbol i hartës së atdheut dhe i qëndresës së përbashkët gjithëkombëtare. Sheshi i Dëshmorëve pranë Lidhjes ishte vendi më simbolik për monumentin e tij. Propozimin për ngritjen e monumentit të Komandant Kumanovës e paraqita në një takim të LPK- së në Prishtinë dhe ai u miratua njëzëri. I vetmi shqetësim ishte financimi, ngaqë monumenti mund të kushtonte shtrenjtë. Që

iniciativa të shkonte mbarë, vendosëm që këtë projekt ta merrte përsipër ndonjë institucion, siç ishte Ushtria e Kosovës ose edhe shoqatat e veteranëve a familjeve të dëshmorëve. Për këtë qëllim njoftova edhe komandantin e Zonës Operative të Pashtrikut, tani Hero i kombit, Tahir Sinani. Me komandantin tim udhëtuam për në Tiranë, ku duhej gjetur ndonjë skulptor të mirë. Me porosinë e miqve të Tahirit, në Tiranë kontaktuam skulptorin Vasilev Nini, të cilit ia dhamë disa foto të dëshmorit Ismet Jashari dhe u dakorduam të fillonte punimin e maketit të monumentit.

Komandanti im Tahir Sinani shpesh më thoshte:

- Ne shqiptarët i kemi të gjitha të mirat, por kur të bëhemi më të mençur, atëherë do të jemi vërtet zot të vendit tonë.

Ngritja e monumenteve të kulturës shqiptare pas luftës duhej t'u takonte institucioneve komunale të Prizrenit. Ndërmorëm gjithë procedurën ligjore për realizimin e projektit të monumentit. Formuam një komision të posaçëm dhe paraqitëm kërkesën me arsyetim në organet komunale të Prizrenit. Pashai i ri i Prizrenit, Eqrem Kryeziu, nuk la gur pa lëvizur për ta penguar vendosjen e këtij monumenti në qytetin historik. Ai thoshte se në Prizren nuk lejohen monumente të UÇK-së, ngase planifikohej kthimi i serbëve dhe se ato mund t'i shqetësonin ata. Kryetari i komunës shfrytëzoi forcën e UNMIK-ut dhe policinë vendore për ta penguar këtë monument.

Projekti assesi nuk guxonte të dështonte. Natën hapëm themelet dhe mbushëm bazamentin me hekur e beton. Monumentet e heronjve Ismet Jashari dhe

Xhevat Berisha u vendosën në Prizren nga vetë popullulli në 10-vjetorin e rënies dhe në jubileun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, më 10 qershor 2010.

Monumenti i Ismet Jasharit - Komandant Kumanovës, Sheshi i Dëshmorëve, Prizren.

Shkëmbi shqiponjë

Monumenti "Syri i Shqiponjës" për dëshmorët Fetah Gega e Xhavit Bajraktari, Shirokë, Therandë.

Pas përfundimit të luftës Komanda e njësitit diversant sulmues *Syri i Shqiponjës* kishte një nga synimet kryesore edhe ngritjen e një monumenti për dy dësh-

morët e kombit Xhavit Bajraktari e Fetah Gega. Nuk lamë vend pa kërkuar një shkëmb natyror në formë shqiponje, ashtu siç ishin edhe dy dëshmorët e kombit dhe ushtarët më të mirë të njësitit tonë. Kishim ndër mend ta realizonim këtë monument të përjetësisë në 10-vjetorin e rënies. Një ditë, derisa po udhëtoja për në Prishtinë, më thërret në telefon bashkëluftëtari Hysen Gega. A më njoftoi se pranë qytezës së Shtimes kishte parë një shkëmb në formë shqiponje. U gëzova shumë kur e pashë atë shkëmb të bukur, tamam siç e kërkonim, një monument i gjallë i natyrës.

Pronari e kishte ekspozuar për shitje shkëmbin shqiponjë në oborrin e shtëpisë. Pa u hamendur shumë u pajtuam për çmimin. Frikohesha se dikush tjetër mund ta blinte. I zoti i shtëpisë vërejti gëzimin në fytyrën time dhe më pyeti se ku planifikoja ta vendosja këtë shkëmb, në ndonjë kopsht shtëpie, para restorantit apo gjetkë? I thashë se shkëmbi shqiponjë do të vendoset në vendin e vet, aty ku kanë rënë dy dëshmorët e Syrit të Shqiponjës, në Shirokë të Therandës. Plaku u gëzua shumë:

- Edhe unë do të jap diçka për këtë monument dhe nxori 100 euro nga të hollat që ia kisha dhënë.

Me shokët e luftës: Hysen Gega, Safet Syla, Shasivar Bajraktari, Hajdar Shala dhe të tjerë gjetëm një kamion të përshtatshëm për bartjen e shkëmbit nga Shtimja për në vendin e rënies.

Monumenti shqiponjë u ngrit nga bashkëluftëtarët e dëshmorëve në afërsi të vendit të rënies, në Shirokë të Therandës. Strukturave drejtuese të Therandës u është propozuar, që për nder të këtyre dëshmorëve

edhe lagjja Shirokë të pagëzohet me emrin e njësitit *Syri i Shqiponjës*.

Vrasja e Komandant Drinit

Gjatë tërë luftës një nga objektivat kryesorë të udhëheqësve të luftës në Zonën Operative të Pashtrik ka qenë uniteti politik. Duke ruajtur me fanatizëm këtë vlerë, ne pengonim armikun të fuste përçarje në radhët tona. Njëkohësisht, uniteti ynë ndikonte në mobilizimin masiv për luftë kundër pushtuesit. Kjo ka bërë që Zona Operative e Pashtrikut të jetë një ndër zonat më kompakte, me numrin më të madh të ushtarëve të mobilizuar dhe me disiplinë e suksese në terrenet e luftimeve.

Askujt nuk i ka shkuar ndër mend që pikërisht pas luftës, ata që kontribuan aq shumë për luftën e lirinë, do të jenë në shënjestër të njerëzve të ligj, kriminelëve e tradhtarëve.

Një vit pas luftës, në fillim të majit 2000, atëherë kur më së shumti i duhej vendit e familjes, u vra në rrethana të pasqaruara njëri ndër komandantët e shquar të luftës në Zonën e Pashtrikut, Ekrem Rexha (*Komandant Drini*).

Gjatë dimrit të egër të janarit 1999 Komandant Drini me një numër të madh bashkëluftëtarësh ishte futur në Kosovë përmes bjeshkës së Pashtrikut. Kolona e ushtarëve të ngarkuar me armë e municione, e dërrmuar nga lodhja dhe e ngrirë nga acari, bie në pritën e organizuar të kriminelëve serbë, ku u vranë e plagosën mbi 35 ushtarë. Falë edhe kundërpërgjigjes së armatosur, arrin të shpëtojë një numër i

ushtarëve tanë. Në mesin e të shpëtuarve ishte edhe Komandant Drini.

Pas kësaj ngjarjeje Drini emërohet një kohë edhe komandant i Zonës Operative të Pashtrikut. Kam pasur rastin të bisedoj disa herë me Drinin për rrjedhën e luftës. Ishte modest dhe kishte njohuri të ekspertit për teoritë e praktikat e luftërave në ish-Jugosllavi, në rajon dhe më gjerë. Kishte respekt e simpati të veçante për njësitet speciale, për të cilat thoshte se janë gjaku e zemra e luftës.

Pas përfundimit të luftës Drini një kohë shërbeu në uniformë, ndërsa më pas u sistemua në sektorët e veçantë për siguri e emergjenca të komunës së Prizrenit. Në atë kohë edhe unë isha i sistemuar përkohësisht si jurist në hotel- Theranda.

Në orët e mëngjesit më **8 maj 2000** mjetet e informimit publik njoftuan për vrasjen e Ekrem Rexhës- Komandant Drinit. Qytetin, njerëzit, rrugët e gurët dhe çdo gjë që frymonte i pllakosi një heshtje varri.

Askush nuk dinte se çka po ndodhte dhe çka do të ndodhte. Isha bashkë me një shok lufte, Bekimin, i cili më rrinte pranë gjatë tërë kohës. Shpeshherë i thosha:

- Ik, pusho, je lodhur!

- Jo, - më thoshte, - nuk të lë vetëm, njerëzit janë me të egër se bishat!

Përse të vritej Komandant Drini? Kujt ia kishte zënë rrugën, kujt ia paska prishur hesapet? Thashë me vete: ndonjë psikopat, ndonjë kriminel shqiptar edhe për çështje karriere! Thonë se vrasjet më të njohura të njerëzve të mëdhenj janë bërë për pushtet.

Flitej se Drini atë kohë kishte ndërmarrë një iniciativë për themelimin e një partie të re politike dhe për këtë qëllim kishte biseduar edhe me disa komandantë të tjerë të luftës. Drini mund të ishte një nga konkurrentët e padiskutueshëm jo vetëm në nivel lokal, por edhe më gjerë. Ndoshta ky ishte motivi kryesor për vrasjen e tij, sepse askush nuk dinte që kishte bërë ndonjë dëm tjetër. I druhesha shumë ndonjë përçarjeje të madhe në mesin e vetë ushtarëve të zonës, madje edhe vrasjeve zinxhirore.

Mjetet e informimit njoftonin se vrasja kishte ndodhur në orët e hershme të mëngjesit, në çastin kur Drini ishte nisur për në punë. Flitej se vrasësit kishin qëlluar me rafal automatiku dhe me silenciator (shurdhues). Vrasësit ishin larguar me shpejtësi me një makinë të kuqe. Dyshohej e flitej se vrasësit kishin ikur në drejtim të Therandës e Rahavecit.

Pas disa ditësh një makinë e ngjashme ishte gjetur e djegur diku mes rrugës Therandë- Rahavec. Megjithatë, të gjitha këto mbetën vetëm thashetheme, sepse policia nuk arriti t'i kapte vrasësit.

Varrimi i Drinit i përngjante një deti të qetë. Rrugët e sheshet e qytetit ishin mbushur me njerëz të të gjitha moshave, që kishin dalë ta nderonin komandantin e tyre në Varrezat e dëshmorëve në Landovicë.

*

Në Zonën Operative të Pashtrikut pas luftës kishte ndodhur edhe një vrasje e rëndë. Ishte vrarë Ukë Bytyçi, i burgosur politik, veprimtar i LDK-së për Therandë dhe një nga eprorët e UÇK-së. Me Ukën ishim shokë burgu, qëndruam disa muaj në burgun e Prizrenit dhe një vit në të njëjtën dhomë në burgun famëkeq të Drejanës. Pas përfundimit të bur-

gut vazhduam kontaktet familjare. Ndikimi i tij për mobilizimin e qytetarëve në luftë kundër pushtuesit serb ka qenë i pazëvendësueshëm. Vrasja e tij kishte ndodhur në rrethana aksidentale, por edhe propaganda e individëve politikë dhe e karrieristëve të sëmurë ka pasur reflektim në vrasjen e tij.

Kurdisja e vrasjes sime

Asnjëherë nuk më ka shkuar mendja se pikërisht pas përfundimit të luftës dhe çlirimit të vendit mund të ndodhnin vrasje të ish- komandantëve më të mirë të UÇK-së. Vetëm një muaj e gjysmë pas vrasjes së Drinit, një atentat i ngjashëm ishte kurdisur edhe ndaj meje. Në qershor 2000 unë banoja në Prizren, bashkë me familjen time, gruan e tre fëmijët, pranë objektit të zonës, në një banesë në katin e dytë.

Dy vjet pata shërbyer në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, në Shërbimin informativ G-2. Për shkaqe shëndetësore dhe obligime familjare më 2003 u detyrova të kaloja në profesionin tim të avokatit.

Zyra ime e avokaturës ishte në një shtëpi pranë Gjykatës së qarkut në Prizren. Për çdo ditë prisja klientë për raste e halle të ndryshme. Një mëngjes maji të vitit 2005, në zyrën time hyjnë tre burra. I njihja mirë që të tre, ishin nga fshati Taraxhë i Therandës: Agush Gashi me dy djemtë e tij, Sinanin e Bashkimin. Bashkimin e kisha edhe bashkëluftëtar.

U dëshirova mirëseardhje, duke i përshëndetur me dorë dhe iu thashë të ulen. Djalin tim Betimi, që punonte së bashku me mua, e porosita te sillte kafet. Prisja që klientët e njohur të hapnin bisedën për

hallin që kishin. Ata më thanë se kishin një bisedë të veçantë dhe kërkuan që në zyrë të ishim vetëm. Plaku dhe dy djemtë e tij ishin zverdhur në fytyrë dhe dukeshin shumë të shqetësuar.

- Çfarë ju ka ndodhur, flisni shlirë? - i pyeta. Prisja me të drejtë që ata kishin ndonjë hall familjar. Plaku tha se sot kishin ardhur për një hall të veçantë.

- Qe sa kohë zihemi ndër vete dhe na vret ndërgjegjja. Nuk mund të prisnim më gjatë. Erdhëm t'ju tregojmë, zoti Ilaz, se jua kemi borxh një gjak. Ne të kemi vrarë ty, por Zoti të ka shpëtuar! - kështu kumtuan mysafirët në zyrën time.

Për një çast mbeta i habitur. Nuk dija se për çka e kishin fjalën dhe ku do të dilnin. Plakut i rrodhën lotët. Po i shikoja me kureshtje.

Që të tretë filluan të tregojnë sesi në qershor 2000 tre persona kishin përgatitur vrasjen time: Isuf Krasniqi (*Mësuesi*) nga Gurra, Rexhep Krasniqi (*Morali*) nga rrethi i Rahavecit dhe një i tretë me inicialet S.G. nga komuna e Therandës, për të cilin m'u luten të mos i përmendet emri për shkak të raporteve familjare.

Një kohë pas luftës familja Gashi nga Taraxha kishte banuar në Prizren, në lagjen Ortakoll, ku banonte edhe Isufi, i ashtuqujturi *Mësues*. Ditë me radhë ky tresh kishte bërë presion, duke bindur familjen, Sinanin, se kinse është e rrezikuar me likuidim nga Ilaz Kadolli. Ilazi i paska futur në një listë si të dyshimtë e bashkëpunëtorë me serbët dhe likuidimi i tyre qenka planifikuar të kryhej brenda dhjetë ditësh. Sipas tyre, për t'u penguar likuidimi, duhej të veprohej me shpejtësi dhe në afat 10- ditësh të vritej Ilaz Kadolli.

Për këtë qëllim organizatorët e vrasjes iu kishin siguruar edhe një armë me silenciator (shurdhues). Për ta bindur atë që arma është efiktive dhe pa zhurmë, e kishin provuar atë së pari Isufi, pastaj Rexhepi dhe në fund edhe vrasësi i porositur. Prova me armën ishte bërë në bodrumin e një shtëpie të braktisur në lagjen Ortakoll. Sipas Sinanit, revolja gjatë shkrepjes thuajse nuk ishte dëgjuar fare.

Për këtë qëllim organizatorët kishin marrë edhe të gjitha masat që ky plan assesi të mos dështonte. Vrasësit të porositur ia kishin treguar edhe hyrjen e ndërtesës e banesën ku banoja me familje, pranë Komandës së TMK-së në Prizren.

Tani unë isha ballë për ballë me vrasësin e porositur. Ai rrëfente ngjarjen dhe rrëqethej, ndërsa unë nuk i besoja vetes: jam në ëndërr apo zhgjëndërr?

Sinani vazhdoi të rrëfente:

- Një mbrëmje të prita disa orë në hyrje të banesës. Nuk kishte drita në korridor dhe për pak e mora më qafë një fqinj tënd. Ishte i gjatë me trup dhe të përngjante shumë ty. Porsa më vërejti me revole në dorë, ai iku me shpejtësi dhe u fut brenda në banesë. E kisha ngatërruar hyrjen e banesën dhe nuk e njoha në terr, - kështu rrëfente Sinan Gashi.

Disa ditë me radhë të kam përcjellë në mbrëmje kur dilje e kthesheshe nga qyteti. Gjithherë ishe me familje, gruan e vajzën, dhe kishe të veshur një këmishë me krahë të shkurtër. Sa herë më ke takuar në korzon e qytetit, ti më ke përshëndetur. Isha i habitur: ç'është ky njeri? Unë e përcjell këmba- këmbës për ta vrarë, e ai më përshëndet kaq butësisht! Një natë madje na pyete edhe si ishim e si po kalonim, madje

na pyete edhe për familjen. Kjo më bëri të dyshoj se diçka nuk ishte në rregull me Isuf Krasniqin dhe Rexhep Krasniqin. Kaluan më shumë se dhjetë ditë dhe asgjë e dyshimtë nuk po ndodhte. Më në fund u bindëm se gjithë ky ishte një kurth i kurdisur nga ata pisa! - ashtu i quajti vrasësi i porositur.

E analizuam edhe një herë çështjen me babanë e vëllanë dhe erdhëm në përfundim se ishim futur në një kurth të rrezikshëm, me pasoja për dy familjet tona. E ftuam personin e njohur dhe ia kthyem armën e silenciatorit, duke i thënë: Le ta vrasin veten ata kriminelë!

Qe të tre burrat nga Taraxha, babai me dy bijtë, edhe një herë u shprehën se ishin të gatshëm të jepnin llogari në çdo kohë dhe në çdo formë për krimin e planifikuar, duke qenë të nxitur e të mashtruar. Ata thanë se janë të gatshëm të dëshmonin në çdo kohë edhe para organeve të drejtësisë. Kishin vetëm një kërkesë, që emri i personit të tretë të mos përmendej, sepse me të kishin lidhje familjare dhe se ai gjatë gjithë ngjarjes kishte heshtur.

Për gjithë këtë skenar, që rrëfyen tre burrat nga fshati Taraxhë, njoftova familjen e ngushtë dhe një rreth të ngushtë shokësh. Pavarësisht tronditjes në familje, vlerësuam që një herë ta heshtim rastin. Të gjithë ishim të mendimit se organizatorët e krimit ishin njerëz me të kaluar kriminale. Ata planifikonin që me vrasjen time të mbyllnin ndonjë krim të mëparshëm, si rastin Drini ose edhe të Behajdin Allaçit. Është një rregull i pashkruar për ata që kryejnë krime: për t'iu shmangur kapjes nga policia, kriminelët largohen dhe fshihen në vendin prejardhjes,

ku më mirë e njohin terrenin.

Flitej se edhe vrasësit e Drinit, menjëherë pas vrasjes, ishin larguar në drejtim të Therandës e Rahavecit.

Shumë ditë mbeta i tronditur dhe nuk futa gjumë në sy.

Si kishin pasur guxim këta horra të sulmonin *Syrin e Shqiponjës*?!

Si është e mundur që shokët e luftës të të vrasin pas shpinës?!

Asnjëherë gjatë gjithë luftës dhe përpjekjeve të pareshtura për liri nuk më ka shkuar mendja se ku dhe çka do të jem pas përfundimit të luftës, në cilin vend a në cilën pozitë.

Këtë mund ta bënin vetëm kriminelët, tradhtarët e karrieristët e paskrupull. Ata të vrasin natën prapa shpinës dhe të qajnë ditën.

Për ta vërtetuar pohimin e vrasësit të porositur, pyeta edhe fqinjin në hyrjen e banesës sime. Ai me tregoi të njëjtën gjë, sikurse vrasësi i porositur. Rreth 15 qershorit 2000, një mbrëmje duke dalë nga banesa, kur drita e banesës kishte ndriçuar korridorin, ai kishte vërejtur një njeri që po i afrohej me revole në dorë. Ishte kthyer shpejt duke u futur brenda, pa kuptuar se ç'po ndodhte. Nehatin nga Leshani, i cili ishte edhe truprojë e Drinit, e bëra me dije se në shënjestër nuk ishte ai, por *Syri i Shqiponjës*. I gjori Nehat ishte frikësuar shumë, duke kujtuar se pas Komandant Drinit e kërkonin edhe atë për ta vrarë!

Disa muaj më vonë atë vit pati edhe një tentim vrasjeje ndaj Muharrem Dinës-Mixhës. Vrasës të panjohur vunë eksploziv në makinën e Mixhës, mu

përpara shtëpisë së tij në Ortakoll. Për fat, makina hidhet në erë e shkatërrohet tërësisht, por jo edhe Mixha me familje. Përsëri automjeti me të cilin ishin larguar kriminelët ishte me ngjyrë të kuqe. As ky rast nuk u ndriçua asnjëherë. Atëherë shërbenim me Mixhën në TMK dhe u munduam të zbulonim e ndëshkonim atentatorët, por më kot.

Gjatë kësaj kohe kishte ndodhur edhe një tentim likuidimi ndaj veprimtarit e luftëtarit Gafurr Elshani. Në grykë të Carralevës persona të porositur i kishin zënë pusi derisa vetura e tij po kthehej nga Prishtina në Therandë. Mirëpo, për fat, atë ditë Gafurri nuk ishte kthyer nga Prishtina dhe në veturë ndodhej vetëm shoferi i tij Bekim Hajdari. Atij ia bllokojnë veturën, duke e kërcënuar me revole dhe duke e pyetur se a ishte ai Gafurr Elshani? Shoferi iu thotë se nuk është ai, por Bekim Hajdari nga Theranda.

Në mos, vallë, ish-drejtuesi i UDB-së serbe në Therandë, Mishki dinak, kishte filluar t'i lëvizte fijet e tij në Kosovë? Kujt tjetër mund t'i interesonte likuidimi i kundërshtarëve më të rreptë të regjimit të tij? Këtë duhet ta tregojnë hetimet profesionale, që ende nuk kanë filluar në Kosovë. Deri atëherë ish-udbashët shqiptarë do të vazhdojnë të livadhisin të lirë në Kosovë, duke u dirigjuar edhe më tej nga ish-shefat e tyre në Beograd.

Pjesëtarët e njësitit *Syri i Shqiponjës*

Njësiti elit *Syri i Shqiponjës* i Zonës Operative të Pashtrikut përbëhej nga këta ushtarë trima:

Xhavit Bajraktari, Vneshtë, Therandë, zëvendëskomandant për zbulim e kundërzbulim (ZKZ), Zona Operative e Pashtrikut, dëshmor i kombit.

Fetah Gega, Gurrë, Therandë, kuadër udhëheqës i policisë ushtarake, Zona Operative e Pashtrikut, dëshmor i kombit.

Nezir Kryeziu (Kaçurreli), Therandë, komandant i njësitit *Syri i Shqiponjës*.

Ilaz Kadolli, Bukosh, Therandë, zëvendëskomandant i njësitit *Syri i Shqiponjës*.

Habib Elshani, Therandë, shef i operativës së njësitit *Syri i Shqiponjës*.

Lumni Haxhiu, Vneshtë, Therandë.

Nevzat Kryeziu, Therandë.

Zenun Krasniqi, Gurkuq, Therandë.

Feride Zenelaj, Gjinoc, Therandë.

Safet Sylaj, Dardhë, Therandë.

Rexhep Gashi, Therandë.

Elmaz Papaj, Vneshtë, Therandë.

Nebih Berisha, Gjinoc, Therandë.

Muharrem Dina, Celinë, Rahavec.

Fevzi Gashi, Gurrë, Therandë.

Bardhyl Gegaj, Gurrë, Therandë.

Mehmet Gashi, Therandë.

Ramadan Hoti, Vneshtë, Therandë.

Shefki Hodaj, Vneshtë, Therandë.

Nehat Musa, Vneshtë, Therandë.

Bekim Kryeziu, Therandë.

Urim Dakaj, Korishë, Prizren.
Naim Kadolli, Bukosh, Therandë.
Pranvera Balaj, Ilirion, Therandë.
Vlora Gashi, Therandë.
Qazim Musa, Vneshtë, Therandë.
Bekim Bytyçi, Gurrë, Therandë.
Xhavit Kicaj, Grykos, Therandë.
Naim Tarjani, Piranë, Prizren.
Blerim Gashi, Therandë.
Emri Gashi, Gurrë, Therandë.
Vahid Jashari, Gurrë, Therandë.
(Në këtë përbërje të njësitit është përfshirë edhe personeli mjekësor dhe i logjistikës.)

Si një njësit elitar i UÇK-së, edhe pse në numër të vogël ushtarësh, duke kombinuar format luftarake dhe me aksione të shpejta e të befasishme, arriti t'i shkaktojë armikut qindra të vrarë, të plagosur e të zënë robër, si dhe dëme të konsiderueshme të makinerisë luftarake.

Pas përfundimit të luftës, të gjithë ushtarëve të njësitit *Syri i Shqiponjës*, në shenjë mirënjohjeje, u është dhënë nga një emblemë e njësitit punuar në bronz.

Veprimtaria luftarake e njësitit elit Syri i Shqiponjës të UÇK-së është trajtuar edhe në filmin dokumentar po me këtë emër të autorit Ilaz Kadolli dhe regjisorit Petrit Ruka nga Tirana.

Emblema e njësitit special Syri i Shqiponjës.

Përvoja e luftës

Ky libër është vetëm një rrëfim, me përjetime e kujtime , nga lufta e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër pushtuesit shekullor serb. Falë gjakut të 2400 dëshmorëve, mbi 13.000 martirëve civilë dhe mbështetjes ndërkombëtare, kjo luftë e shenjtë u kurorëzua me fitoren tonë historike.

Shpresoj që ky rrëfim historik do t'u shërbejë brezave të ardhshëm për ta njohur një pjesë të lavdishme të luftës sonë për çlirim e ribashkim kombëtar.

Nga përvoja e luftës dhe përjetimi i drejtpërdrejtë i saj kam ardhur në disa përfundime:

Në situatat kur raporti mes palëve ndërluftuese është shumë i pabarabartë, mundësia e vetme e përballimit të armikut janë njësitet speciale, me një numër të vogël ushtarësh dhe me sulme të befasishme mbi radhët armike. Sulmet e rrufeshme dhe të befasishme shkaktojnë konfuzion, frikë e panik tek armiku, si dhe dëme në efektivin e tij luftarak. Ato shkaktojnë edhe humbje të moralit luftarak, që është pika më e ndjeshme e luftës. Kjo formë veprimi në prapavijën e armikut kërkon gatishmëri të lartë për sakrificë, që te ne nuk ka munguar kurrë. Gatishmëria për sakrificë është një ndjenjë e natyrshme dhe virtyt moral i popujve të robëruar. Nga gjiri i popullit tonë gjithherë kanë dalë prijës, komandantë e gjeneralë të shquar që nga lashtësia deri në ditët tona.

Gjatë Luftës çlirimtare në Kosovë eprorët e komandantët e UÇK-së dhanë shembullin më të mirë, duke i prirë çdo beteje dhe duke flijuar edhe jetën. Rënia

e komandantëve tanë nuk e ka dobësuar forcën e moralin luftarak, përkundrazi ka rritur vendosmërinë për luftë deri në fitore. Kështu është mbajtur betimi i dhënë si akt më solemn dhe më fisnik për çdo ushtar të UÇK-së.

Rreshtimi i drejtë dhe bashkëpunimi me aleatët tanë të natyrshëm ishte ndër faktorët kryesorë për kurorëzimin e fitores dhe ngadhënjimin mbi armikun shekullor.

Mirënjohje

Me rastin e botimit të këtij libri shpreh mirënjohje e falënderim së pari për nënën, gjyshin e gjyshen time që më rritën e edukuan me dashurinë prindore.

Falënderoj bacin Mustafë Kadolli për mbështetje gjatë gjithë jetës sime, veçanërisht gjatë veprimtarisë sime ilegale, burgosjes dhe luftës, që ishte mbështetës i vetëm nga kurbeti i logjistikës sime për LPK-në e UÇK-në.

Falënderoj familjen time, bashkëshorten Xhevahire me vajzën Fatë dhe djemtë Betimi e Iliri, që më përkrahën shpirtërisht e moralisht edhe atëherë kur atyre u duhej mbështetja ime familjare.

Falënderoj veçanërisht të gjithë bashkëveprimtarët, me të cilët kaluam çastet më të lumtura dhe më të vështira gjatë 30 vjetëve të veprimtarisë ilegale dhe gjatë Luftës çlirimtare në Kosovë.

Një mirënjohje e veçantë iu përket bashkëluftëtarëve të mi të njësitit Syri i Shqiponjës për respektin ndaj eprorëve dhe përkushtimin e flijimin ndaj lirisë së atdheut.

Nderi dhe lavdia u takon dëshmorëve dhe heronjve të kombit të të gjitha kohëve në gjithë Shqipërinë etnike.

Me këtë rast falënderoj regjisorin Petrit Ruka për filmin dokumentar "Syri i Shqiponjës", si dhe donatorët për këtë film dhe botimin e këtij libri: Hajdar Shala, Therandë; Nezir Kryeziu, Therandë; Izet Baraliu, Bukosh; Safet Sylaj, Dardhë; Blerim Kuqi, Therandë; Skënder Kala, Prizren; Blerim Bajraktari,Vneshtë; Abdullah Abdullahu, Prizren; Gani

Balaj, Ilirion dhe firmën ¨Hyska¨, Prizren; familjarët Vesel, Brahim, Ylli, Arben, Fadil, Tafil dhe Bardhosh Kadolli.

Dhe, më në fund, i shpreh mirënjohje nderimi Prof. Abdyl Kadollit për redaktimin e këtij botimi.

Autori
Prizren, qershor 2017

PËRMBAJTJA

Hyrje.....5

FËMIJËRIA E RINIA.....8

Gjyshi im 8
Bjeshka e Bukoshit 10
Guri i Brumullakët.....13
Jeta shkollore.....15

PRANVERA STUDENTORE '81.....19

Demonstratat e marsit.....20
Demonstratat e prillit.....23

LËVIZJA POPULLORE E KOSOVËS.....27

Njohja me Nuhi Berishën.....27
Rënia heroike e Rexhep Malës
e Nuhi Berishës.....33
Me Fadil Vatën e Afrim Zhitinë.....38
Mbledhja e Dyflakës.....41
Rënia heroike e Afrim Zhitisë
e Fahri Fazliut.....45
Mbledhja e Ujëmirit.....48
Mbledhja e Kollares.....51
Organizimi i LPK-së.....56
Arrestimet e gushtit '93.....61
Torturat mizore.....63

USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS

Themelimi i UÇK-së.....69
Gazeta "Zëri i Kosovës".....76
Kushtrimi i lirisë.....78
Brigada 123.....81
Dëshmori i parë.....88
Gjetja e dy ushtarëve të humbur.....91
Evakuimi i të plagosurve.....93
Kuajt e luftës.....101
Beteja e ashpër në Pagarushë.....106

NJËSITI *SYRI I SHQIPONJËS*.....109

Baza në Ilirion.....112
Snajperët efektivë.....114
Me Mixhën nëpër Dukagjin.....117
Takimi me oficerët amerikanë.....121
Sulmi pranë Therandës.....125
Si na shpëtoi kriminel Mishki?.....128
Aksioni në Ilirion.....131
Rënia e dëshmorëve Fetah Gega
e Xhavit Bajraktari.....138
Hakmarrja në Vneshtë.....151
Lumi i *Syrit të Shqiponjës*.....*155*
Lepujt e trembur në Grap.....158
Sulmi spektakular në Peqan.....160
Çlirimi i Therandës.....167

LUFTA NË KOSOVË.....175

Gjenocidi serb dhe konventat ndërkombëtare.....175
Sprovat diversive.....183
Politikuajt.....186
Lufta e pastër e UÇK-së.....189
Gjykata ushtarake.....193
Trajtimi i rasteve.....196
Likuidimi pa gjyq i Behajdin Allaçit.....202

PASLUFTA.....206

Monumentet e dëshmorëve.....206
Shkëmbi shqiponjë.....210
Vrasja e Komandant Drinit.....212
Kurdisja e vrasjes sime.....215
Pjesëtarët e njësitit *Syri i Shqiponjës*.....221
Përvoja e luftës.....224
Mirënjohje.....226
Përmbajtja.....228

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

821.18-92

Kadolli, Ilaz
Syri i shqiponjës, kujtime e përjetime / Ilaz Kadolli.
Prishtinë : Shoqëria Lëvizja, 2017. – 231 f. : ilustr.
;21 cm.

ISBN 978-9951-8953-0-9